

## ABC – ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian

*Profesor Klaus-Diter Borçard*



**Klaus-Diter Borçard** është zyrtar i Bashkimit Evropian që nga viti 1987. Ai ishte Zëvendës Shef i Kabinetit dhe pastaj Shef i Kabinetit për Komisionerin e Bujqësisë në periudhën prej 2004 deri në 2010. Ai është poashtu Profesor Nderi në Universitetin e Vurzburgut (Würzburg), ku ka ligjëruar të drejtën evropiane që nga viti 2001.



# ABC – ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian

*Profesor Klaus-Diter Borçard*

Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron domosdo qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian. Informatat dhe opinionet e këtij publikimi janë vetëm përgjegjësi e autorit.

### **Falenderimet për fotografitë**

Më poshtë janë shënuar vendet ku janë ruajtur ilustrimet e reprodukuara dhe/ose burimi i përdorur, së bashku me pronarët e të drejtave autoriale.

Janë bërë përpjekje maksimale për të gjetur autorët e të drejtave autoriale për ilustrimet dhe fotografitë e ndryshme të reprodukuara. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi kontaktoni botuesin:

Publications Office of the European Union  
2, rue Mercier  
2985 Luxembourg  
LUXEMBOURG

Faqet 8, 23, 35, 56, 67, 84, 94, 116 dhe 124: Biblioteka Mediatike e Komisionit Evropian, Bruksel  
© Bashkimi Evropian, 2010

***Europe Direct është shërbim që ju ndihmon të merrni përgjigje në pyetjet tuaja mbi Bashkimin Evropian.***

**Numri i telefonit pa pagesë (\*)**

**00 800 6 7 8 9 10 11**

(\*) Disa operatorë të telefonisë mobile nuk lejojnë qasjen në numrat 00 800, ose mund të dërgojnë llogari për këto numra

Më tepër informata mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në Internet (<http://europa.eu>).

Të dhënat e katalogizimit mund t'i gjeni në fund të këtij botimi.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2010

ISBN 978-92-9238-041-0

doi:10.2871/36508

© Bashkimi Evropian, 2010

Reprodukimi është i autorizuar me kusht që burimi të jetë i njohur.

*Shtypur në ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*

## SHËNIM PËR LEXUESIN

*ABC-ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian* merr parasysh modifikimet e inkuadruara në Traktatet e Evropës nga Traktati i Lisbonës. Përderisa nuk ka citim direkt, apo kërkesa në kontekst historik, artikujt e cituar i referohen ekskluzivisht verzioneve të konsoliduara të Traktateve Evropiane (*Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian* C 83, e datës 30 mars 2010). Informatat e përfshira në këtë edicion janë të sakta ashtu si në mars 2010.

# Përmbajtja

- 007 PARATHËNIE**
- 009 NGA PARISI DERI NË LISBONË, PËRMES ROMËS, MASTRIHTIT, AMSTERDAMIT DHE NICËS**
- 019 VLERAT FUNDAMENTALE TË BASHKIMIT EVROPIAN**
- 021 BE-ja si garantuese e paqes**
- 021 Uniteti dhe barazia si tema të përhershme**
- 022 Liritë fundamentale**
- 022 Parimi i solidaritetit**
- 024 Respektimi i identitetit nacional**
- 024 Nevoja për siguri**
- 024 Të drejtat fundamentale**
- 029 ‘KUSHTETUTA’ E BASHKIMIT EVROPIAN**
- 029 Natyra ligjore e BE-së**
- 033 Detyrat e BE-së**
- 038 Fuqitë e BE-së**
- 042 Institucionet e BE-së**
- 045** Institucionet: Parlamenti Evropian — Këshilli Evropian — Këshilli — Komisioni Evropian — Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian — Banka Qendrore e Evropës — Gjykata e Revizorëve
- 075** Organet këshilldhënës: Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social — Komiteti i Rajoneve
- 078** Banka Evropiane e Investimeve
- 079 RENDI LIGJOR I BE-së**
- 079 BE-ja si krijesë e ligjit dhe Komunitet i bazuar në ligj**
- 080 Burimet ligjore të të drejtës së Unionit**
- 081** Traktatet themeluese të BE-së si burim primar i të drejtës së Unionit — Instrumentet ligjore të BE-së si burimi sekondar i të drejtës së Unionit — Marrëveshjet ndërkombëtare të BE-së — Parimet e përgjithshme të ligjit — Përvoja ligjore — Marrëveshjet midis Shteteve Anëtare

- 087 Mjetet vepruese të BE-së**
- 089** Rregullativat — Direktivat — Vendimet — Rekomandimet dhe opinionet — Rezolutat, deklaratat dhe programet e veprimit
- 098 Procesi legjislativ në BE**
- 102** Procedura rregullative — Procedura e miratimit — Procedura e thjeshtësuar
- 104 Sistemi i BE-së për mbrojtje ligjore**
- 104** Proceset gjyqësore për shkeljen e traktateve — Veprimet e anulimit — Ankesat për dështim të veprimit — Veprimet në raste të dëmeve — Veprimet e personelit të Komunitetit — Konfliktet lidhur me patentet e Unionit — Procedurat e ankesës — Mbrojtja e përkohshme juridike — Vendimet preliminare
- 112 Përgjegjësia e Shteteve Anëtare për shkeljen e ligjit të Unionit**
- 112** Përgjegjësia e Shteteve Anëtare për aktet ligjore ose dështimin e veprimit — Përgjegjësia për shkelje të ligjit të Unionit nga Gjykatat
- 115 POZITA E TË DREJTËS SË BASHKIMIT EVROPIAN NË RAPORT ME RENDIN LIGJOR NË TËRËSI**
- 115 Autonomia e rendit ligjor të BE-së**
- 116 Interakcioni midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale**
- 119 Konflikti midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale**
- 119** Zbatueshmëria direkte e të drejtës së Unionit mbi të drejtën nacionale — Dominimi i të drejtës së Unionit mbi të drejtën nacionale — Interpretimi i të drejtës nacionale në pajtim me të drejtën e Unionit
- 127 KONKLUZAT**
- 129 SHTOJCË**



# Parathënie

Rendi ligjor i krijuar nga Bashkimi Evropian (BE) tanimë është bërë përbërës i rrënjosur në jetën tonë politike dhe në shoqëri. Çdo vjet, në bazë të Traktateve të Unionit, merren mijëra vendime që ndikojnë vendosmërisht në Shtetet Anëtare të BE-së dhe në jetën e qytetarëve të tyre. Ka kohë që individët më nuk janë thjesht qytetarë të shtetit të vet, qytetit apo rrethit; ata janë edhe qytetarë të Unionit. Vetëm për këtë arsye, është jashtëzakonisht me rëndësi që ata të jenë të informuar mbi rendin ligjor, i cili ndikon në jetën e tyre të përditshme. Megjithatë, ndërlikueshmëria e strukturës së Unionit dhe rendi i tij ligjor nuk kuptohen aq lehtë. Kjo është pjesërisht për shkak të gjuhës së vetë Traktateve, e cila shpesh është disi e paqartë, me aludime që nuk kuptohen lehtë. Faktor plotësues është edhe mosnjohja e koncepteve të shumta, me të cilat Traktatet mundohen të zotërojnë situatën. Faqet në vijim janë përpjekje për të qartësuar strukturën e Unionit dhe shtyllat mbajtëse të rendit ligjor evropian, dhe kështu të ndihmohet redukimi i mungesës së njohurisë midis qytetarëve të BE-së.





7 maj 1948, Hagë.

Uinston Çërçill pritet ngrohtësisht nga Kongresi i Evropës. Ish Kryeministri i Britanisë së Madhe, dhe atëbotë lider i opozitës, kryesoi seancën inauguruese të Kongresit. Më 19 shtator 1946, në fjalimin e tij në Cyrih, ai apeloi për unitet evropian.

# Nga Parisi në Lisbonë, përmes Romës, Mاستrihtit, Amsterdemit dhe Nicës

Pak kohë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore koncepti ynë për shtetin dhe jeta jonë politike ishte zhvilluar kryesisht në bazë të kushtetutave dhe ligjeve nacionale. Pikërisht kjo ishte baza mbi të cilën u krijuan rregullat e sjelljes detyruese jo vetëm për qytetarët dhe partitë në vendet tona demokratike, por gjithashtu edhe për shtetin dhe organet e veta. Duhej të vinte deri te shembja e plotë e Evropës dhe tatëpjeta e saj politike dhe ekonomike për t'u krijuar kushtet për një fillim të ri dhe për t'i dhënë një impuls të freskët idesë për një rend të ri evropian.

Në përgjithësi, lëvizjet drejt unifikimit të Evropës nga Lufta e Dytë Botërore, kanë krijuar përzierje konfuze të organizatave të shumta dhe të ndërlikuara, të cilave vështirë mund t'u gjindet filli. Për shembull, OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), WEU (Bashkimi Evropian Perëndimor), NATO (Organizata e Traktatit Veri Atlantik), Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian bashkëjetojnë pa ndonjë lidhje reale midis tyre. Numri i shteteve në këto organizata të ndryshme shtrihet nga 10 (në WEU) deri në 47 (në Këshillin e Evropës). Kjo llojllojshmëri organizatash merr strukturë logjike vetëm nëse shohim qëllimet e tyre specifike. Ato mund të ndahen në tre grupe kryesore.

## **GRUPI I PARË: ORGANIZATAT EURO-ATLANTIKE**

Organizatat Euro-Atlantike u krijuan si rezultat i aleancës midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës pas Luftës së Dytë Botërore. Nuk ishte ko incidencë që organizata e parë evropiane e pas luftës, OEEC (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik Evropian), që u themelua në 1948, u krijuar me iniciativën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sekretari i atëhershëm Shtetëror i SHBA-ve, Xhorxh Marshall, në vitin 1947 apeloj që shtetet e Evropës të bashkojnë fuqitë për rindërtimin e ekonomive të tyre dhe premt

indihmën amerikane. Kjo ndihmë u quajt Plani Marshall, i cili mundësoi bazën për rindërtim të shpejtë të Evropës Perëndimore. Në fillim, qëllimi kryesor i OEEC-së ishte të liberalizojë tregtinë midis shteteve. Në vitin 1960, kur u anëtarësuan SHBA-të dhe Kanadaja, u shtua edhe një synim, dhe ai ishte nxitja e progresit ekonomik në vendet në zhvillim, me anë të ndihmës për zhvillim. OEEC-ja atëherë u shndërrua në OECD.

Në vitin 1949, NATO u themelua si aleancë ushtarake me Shtetet e Bashkuara dhe Kanadanë. Në 1954, u krijua Bashkimi Evropian Perëndimor (WEU), me qëllim të forcimit të bashkëpunimit në fushën e politikës të sigurisë midis vendeve të Evropës. NATO bashkoi shtetet që kishin nënshkruar Traktatin e Brukselit (Belgjika, Franca, Luksemburgu, Holanda dhe Britania e Madhe) si dhe Republika Federale e Gjermanisë dhe Italia. Greqia, Spanja dhe Portugalia poashtu u bënë anëtare. Bashkimi Evropian Perëndimor, në vitin 1954 shënoi fillimin e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes në Evropë. Mirëpo, roli i tij nuk u zhvillua më shumë, pasi që pjesa më e madhe e fuqisë së tij u transferua në institucione të tjera ndërkombëtare, sidomos në NATO, Këshillin e Evropës dhe në BE. Bashkimi Evropian Perëndimor ka ruajtur përgjegjësinë për mbrojtje kolektive, rol që akoma nuk i është transferuar BE-së.

## **GRUPI I DYTË: KËSHILLI I EVROPËS DHE OSBE-JA**

Karakteristika e përbashkët për grupin e dytë të organizatave evropiane është se ato janë strukturuar ashtu që të mundësojnë pjesëmarrjen e sa më shumë shteteve. Njëkohësisht, kishte një vetëdije se këto organizata nuk do të tejkalonë bashkëpunimin e zakonshëm ndërkombëtar.

Këto organizata përfshijnë Këshillin e Evropës, i cili u themelua si institucion politik më 5 maj 1949. Statuti i tij nuk jep asnjë referencë për lëvizje drejt një federate apo unioni, dhe as nuk mundëson transferimin ose shkrirjen e të drejtave sovrane. Vendimet lidhur me të gjitha çështjet e rëndësishme kërkojnë njëzëshmëri, që do të thotë se çdo shtet ka fuqinë e vetos; struktura e njëjtë ekziston edhe në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Prandaj, Këshilli i Evropës është dizajnuar vetëm duke pasur parasysh bashkëpunimin ndërkombëtar. Këshilli ka mbajtur një varg konventash në fushën e ekonomisë, kulturës, politikës sociale dhe ligjit. Ndër më të rëndësishmet — dhe më të njohurat — nga këto, është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e

të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose ECHR), 4 nëntor 1950. Konventa jo vetëm që mundësoi përcaktimin e standardeve minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare; por gjithashtu themeloi një sistem të mbrojtjes ligjore, i cili u mundëson trupave të themeluar në Strazburg (Komisioni Evropian për të Drejta të Njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut) të denoncojnë shkeljen e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare.

Ky grup i organizatave gjithashtu përfshin edhe Organizatën e Sigurisë dhe Zhvillimit në Evropë (OSBE), themeluar në 1994, si pasues i Konferencës për Siguri dhe Zhvillim në Evropë. OSBE-ja u përmbahet parimeve dhe qëllimeve të përcaktuara në Aktin Final të Helsinkit 1975 dhe në Kartën e Parisit 1990. Krahas masave për ndërtimin e besimit midis shteteve të Evropës, këto synime përfshijnë edhe themelimin e ‘rrjetit të sigurtë’ për të mundësuar zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore. Siç kanë treguar ngjarjet e të kaluarës së afërt, Evropa ka një rrugë të gjatë në këtë aspekt.

## GRUPI I TRETË: BASHKIMI EVROPIAN

Grupi i tretë i organizatave evropiane përbëhet nga Bashkimi Evropian. Karakteristika më e re në BE, e cila e dallon BE-në nga llojet e zakonshme të asocimit ndërkombëtar të shteteve është se Shtetet Anëtare kanë hequr dorë nga disa të drejta të tyre sovraane në favor të BE-së dhe i kanë dorëzuar BE-së fuqinë për veprim të pavarur. Në ushtrimin e kësaj fuqie, BE-ja ka aftësi të nxjerrë akte sovraane që kanë fuqinë e njëjtë si ligjet në shtetet individuale.

Gurthemelin e Bashkimit Evropian e vuri Ministri i atëhershëm francez i Punëve të Jashtme, Robert Shuman, në deklaratën e tij më 9 maj 1950, në të cilën ai prezantoi planin që e kishte përpunuar bashkë me Zhan Monenë, për bashkimin e industrive të Evropës për thëngjill dhe çelik në Komunitetin Evropian për Thëngjill dhe Çelik. Ai deklaroi se kjo do të përbënte një iniciativë historike për një ‘Evropë të organizuar dhe vitale’, gjë që ishte e ‘domosdoshme për civilizimin’ dhe pa të cilën ‘nuk do të mund të ruhej paqja në botë’. ‘Plani i Shumanit’ përfundimisht u bë realitet me nënshkrimin e Traktatit të Komunitetit Evropian për Thëngjill dhe Çelik (ECSC) nga gjashtë shtetet themeluese (Belgjika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda) më 18 prill 1951 në Paris (Traktati i Parisit) dhe hyrja e tij në fuqi më 23 korrik 1952. Ky Komunitet u themelua për një periudhë

50 vjeçare, dhe u 'integrua' në Komunitetin Evropian, atëherë kur Traktati themelues skadonte më 23 korrik 2002. Zhvillim i mëtejshëm u realizua me Traktatin e Romës, më 25 mars 1957, i cili themeloi Komunitetin Evropian Ekonomik (EEC) dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike (Euratom); këto filluan punën e tyre kur Traktati hyri në fuqi më 1 janar 1958.

Themelimi i Bashkimit Evropian me Traktatin e Mاستrihtit shënoi një hap përpara në rrugën drejt unifikimit të Evropës. Edhe pse Traktati u nënshkrua në Mاستriht, më 7 shkurt 1992, një varg pengesash në procesin e ratifikimit (miratimi i popullit të Danimarkës vetëm pas referendumit të dytë; aktet ligjore në Gjermani që duhej të merrnin miratimin e Parlamentit për Traktatin u vërtetuan si jokushtetuese) nënkuptonin se i njëjti nuk hyri në fuqi deri më 1 nëntor 1993. Traktati i referohej vetvetes si 'një etapë e re në procesin e krijimit të një unioni më të afërt se kurrë më parë për popujt e Evropës'. Ai përmbante instrumentin themelues të Bashkimit Evropian, edhe pse nuk e përfundoi këtë proces. Ky ishte hapi në rrugën përfundimtare drejt sistemit kushtetues evropian.

Zhvillim i mëtejshëm u shënuar në formë të Traktateve të Amsterdimit dhe Nicës, të cilat hynë në fuqi më 1 maj 1999, respektivisht më 1 shkurt 2003. Qëllimi i këtyre reformave është të ruajnë kapacitetin e BE-së për veprim në një Union të zgjeruar nga 15 në 27 ose më tepër anëtarë. Prandaj, dy Traktatet ishin të fokusuar në reformat institucionale dhe, në krahasim me reformat paraprake, vullneti politik për thellimin e integritetit evropian në Nicë ishte relativisht i dobët.

Rrjedhimisht, kritika rezultoi në fillim të debatit lidhur me ardhmërinë e BE-së dhe strukturën e vet institucionale. Si rezultat i kësaj, më 5 dhjetor 2001 në Laeken (Belgjikë), Shefat e Shteteve ose Qeverive, miratuan një Deklaratë mbi të Ardhmen e Bashkimit Evropian, në të cilën BE-ja pranoi të bëhej më demokratike, transparente dhe efektive dhe të trasonte rrugën për një kushtetutë. Hapi i parë për arritjen e këtij qëllimi ishte themelimi i konventës evropiane, kryesuar nga ish Presidenti francez, Valeri Zhiskar d'Esten, me detyrën për të hartuar kushtetutën Evropiane. Më 18 korrik 2003, kryesuesi, në emër të konventës, zyrtarisht ia dorëzoi Presidentit të Këshillit Evropian propozim Traktatin e hartuar nga konventa. Ky propozim u miratua, me disa ndryshime të caktuara, nga Shefat e Shteteve ose Qeverive më 17 dhe 18

korrik në Bruksel, pas anëtarësimit të 10 Shteteve të reja Anëtare më 1 maj 2004 dhe zgjedhjeve për Parlamentin Evropian në mes të qershorit 2004.

Kushtetuta kishte për qëllim të kthente Bashkimin Evropian dhe Komunitetin Evropian (të cilët deri atëherë i kishim të njohur), në një Bashkim Evropian të vetëm, të bazuar në një Traktat Kushtetues. Vetëm Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike do të vazhdonte të ekzistojë si komunitet i veçantë — edhe pse do të vazhdonte të asocohet me Bashkimin Evropian Union.

Mirëpo, kjo përpjekje për kushtetutë dështoi në procesin e ratifikimit. Pas votimit pozitiv fillestar në 13 nga 25 Shtete Anëtare, Traktati u refuzua në referendumet në Francë (54.68% kundër, nga gjithsej 69.34% votues) dhe në Hollandë (61.7% kundër, nga gjithsej 63%).

Pas periudhës dyvjeçare të reflektimit, një pako e re e reformave u inicua në gjysmën e parë të vitit 2007. Kjo pako reformash përfaqësonte një hap më larg nga ideja e kushtetutës evropiane, nën të cilën të gjitha Traktatet ekzistuese do të revokoheshin dhe do të zëvendësoheshin me një tekst të vetëm të quajtur 'Traktati i themelimit të Kushtetutës për Evropë'. Mirëpo, Traktati Reformues u hartua ashtu si Traktatet e Mastrohit, Amsterdami dhe Nicës, të cilat u bënë ndryshime fundamentale Traktateve ekzistuese të Bashkimit Evropian, që forconte kapacitetin e BE-së për të vepruar përbrenda ose jashtë Unionit, për të shtuar legjitimitetin e vet demokratik dhe për të shtuar përgjithësisht efikasitetin e veprimit të BE-së. Në pajtim me traditën, Traktati Reformues u quajt Traktati i Lisbonës.

Traktati u hartua jashtëzakonisht shpejt, kryesisht për shkak të faktit se gjatë konkluzave të takimit të Këshillit Evropian më 21 dhe 22 qershor 2007 në Bruksel, Shefat e Shteteve ose Qeverive përcaktuan hollësisht si dhe në çfarë mase duhet të inkorporohen ndryshimet e biseduara gjatë Konferencës Ndërqeveritare 2004, në Traktatet ekzistuese. Qasja e tyre ishte e pazakontë pasi që ata nuk u kufizuan në implementimin e udhëzimeve të përgjithshme nga një Konferencë Ndërqeveritare, por hartuan strukturën dhe përmbajtjen e ndryshimeve që duhej të bëhen, dhe shpesh hartuan terminologjinë e saktë të një dispozite. Pikat kryesore të mosmarrëveshjes ishin ndarja e kompetencave midis Unionit dhe Shteteve Anëtare, ardhmëria e politikës së përbashkët për siguri dhe punë të jashtme, roli i ri i parlamenteve nacionale në procesin e integritimit, përfshirja e Kartës për të Drejta Fundamentale në

të drejtën e Unionit dhe progresi i mundshëm në fushën e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor lidhur me veprat penale.

Si rezultat i kësaj, Konferenca Ndërqeveritare e mbajtur në 2007 nuk kishte shumë mundësi manovrimi dhe ishte e autorizuar vetëm për të implementuar teknikisht ndryshimet e nevojshme. Puna e Konferencës Ndërqeveritare përfundoi më 18 dhe 19 tetor 2007, dhe fitoi miratimin politik të Këshillit Evropian, i cili njëkohësisht kishte takim jozyrtar në Lisbonë. Së fundi, Traktati zyrtarisht u nënshkrua nga Shefat e Shteteve apo Qeverive të 27 Shteteve Anëtare të BE-së, më 13 dhjetor 2007, në Lisbonë.

Mirëpo, procesi i ratifikimit për këtë Traktat ishte jashtëzakonisht i vështirë. Edhe pse Traktati i Lisbonës, ndryshe nga Traktati që themelon Kushtetutën për Evropë, u ratifikua me sukses në Francë dhe në Hollandë, në fillim u ballafaqua me pengesën e referendumit të parë në Irlandë, më 12 qershor 2008 (53.4% kundër, nga gjithsej 53.1% votues). Vetëm pas një varg garancash ligjore mbi fushëveprimin (e kufizuar) të Traktatit të ri, qytetarët e Irlandës votuan në referendumin e dytë për Traktatin e Lisbonës, në tetor 2009. Këtë herë Traktati fitoi mbështetjen e gjerë të popullatës irlandeze (67.1% për, nga gjithsej 59% votues). Suksesi i referendumit në Irlandë gjithashtu traso i rrugën për ratifikimin e Traktatit të Lisbonës në Poloni dhe në Republikën Çeke. Në Poloni, Presidenti Kacinski nënshkruajti instrumentin për ratifikim, i kushtëzuar nga rezultati i favorshëm në referendumin e Irlandës. Presidenti çek, Vaclav Klaus, poashtu në fillim dëshoi të priste referendumin irlandez, por pastaj nënshkruajti instrumentin e ratifikimit, të kushtëzuar nga garanca se 'Dekretet Beneš' të vitit 1945, të cilat ndalonin zbritjen në zonat e Republikës Çeke që më parë i takonin Gjermanisë, do të mbeten të paprekura nga Traktati i Lisbonës, dhe sidomos nga Karta e të Drejtave Fundamentale, e përfshirë në Traktatin e BE-së. Pas gjetjes së zgjidhjes për këtë kërkesë, Presidenti çek nënshkruajti instrumentin e ratifikimit, më 3 nëntor 2009. Kështu, procesi i ratifikimit përfundoi në të gjitha Shtetet Anëtare 27, dhe Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009.

Traktati i Lisbonës shkriu Bashkimin Evropian dhe Komunitetin Evropian në një Union Evropian të vetëm. Fjala 'Komunitet' zëvendësohet kudo me fjalën 'Union'. Unioni zëvendëson dhe trashëgon Komunitetin Evropian. Megjithatë, e drejta e Unionit edhe më tej është e formuluar sipas tre Traktateve në vijim.

### Traktati për Bashkimin Evropian

Traktati për Bashkimin Evropian (Traktati i BE-së — ‘TEU’) është ristrukturuar plotësisht në gjashtë titujt në vijim: Dispozitat e përbashkëta (I), Dispozitat e parimeve demokratike (II), Dispozitat mbi institucionet (III), Dispozitat mbi bashkëpunimin e shtuar (IV), Dispozitat e përgjithshme lidhur me veprimet e jashtme të Unionit dhe dispozitat specifike lidhur me politikën e përbashkët për punë të jashtme dhe të sigurisë (V) dhe Dispozitat përfundimtare (VI).

### Traktati mbi Funksonimin e Bashkimit Evropian

Traktati mbi Funksonimin e Bashkimit Evropian (‘TFEU’) u hartua nga Traktati themelues i Komunitetit Evropian dhe ka pak a shumë strukturën e njëjtë si Traktati i KE-së. Ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me aktet e jashtme të BE-së dhe futjen e kapitujve të ri, sidomos politikën e energjisë elektrike, bashkëpunimin policor dhe gjyqësor për çështjet që kanë të bëjnë me vepra penale, hapësirë, sport dhe turizëm.

### Traktati themelues i Komunitetit Evropian për Energji Atomike

Traktati themelues i Komunitetit Evropian për Energji Atomike (Traktati EAEC — ‘Traktati Euratom’) është ndryshuar në faza të ndryshme. Në çdo rast, ndryshimet specifike janë bërë në protokolet shtojcë të Traktatit të Lisbonës.

TEU dhe TFEU kanë bazën e njëjtë juridike. Ky qartësim i çiltër juridik është i domosdoshëm, pasi që titulli i ri i Traktatit të mëparshëm për KE-në (‘Traktati mbi Funksonimin e BE-së’) dhe niveli i rregullimit të dy Traktateve, lënë përshtypjen se TEU është një lloj kushtetute ose traktat bazik, kurse TFEU është i paraparë si traktat implementues. Mirëpo, TEU dhe TFEU nuk kanë natyrë kushtetuese. Terminologjia e përdorur në Traktate, në përgjithësi reflekton këtë ndryshim të qasjes nga propozimi i mëparshëm i kushtetutës. Shprehja ‘kushtetutë’ nuk përdoret më; ‘ministri i jashtëm i BE-së’ tani thirret ‘Përfaqësues i Lartë i Unionit për Politikë të Punëve të Jashtme dhe Sigurisë’; dhe definicionet për ‘ligj’ dhe ‘ligj kornizë’ janë braktisur. Traktatet e ndryshuara nuk përmbajnë as artikuj që u referohen simboleve



të BE-së, siç janë flamuri, himni ose motoja. Përparësia e të drejtës të BE-së nuk është shënuar në mënyrë eksplicite në traktat, mirëpo, ashtu si më parë, rrjedh nga praktika gjyqësore në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian, dhe kjo praktikë gjyqësore trajtohet në deklaratën sqaruese.

Traktati i Lisbonës gjithashtu braktis 'tre shtyllat' e BE-së. Shtylla e parë, e cila përbëhet kryesisht nga tregu i vetëm dhe politikat e Komisionit Evropian, bashkohet me shtyllën e dytë, që përbëhet nga politika e punëve të jashtme dhe sigurisë, dhe shtylla e tretë, e cila përfshin bashkëpunimin policor dhe gjyqësor lidhur me veprat penale. Megjithatë, procedurat speciale që kanë të bëjnë me politikën e punëve të jashtme dhe të sigurisë, përfshirë këtu edhe mbrojtjen evropiane, mbeten në fuqi; deklaratat e Konferencës Ndërqeveritare të bashkangjitura në Traktat theksojnë natyrën e veçantë të kësaj fushe dhe sidomos përgjegjësitë e Shteteve Anëtare në këtë aspekt.

Aktualisht BE-ja ka 27 Shtete Anëtare. Këto përfshijnë pikë së pari gjashtë anëtarët themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian - Belgjika, Gjermania (përfshirë edhe territorin e ish Gjermanisë Lindore, pas unifikimit të dy Gjermanive më 3 tetor 1990), Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Më 1 janar 1973, Danimarka (tani pa Grenlandën, e cila në referendum, në shkurt 1982 votoi të mos mbetet përbrenda Komunitetit Evropian), Irlanda dhe Britania e Madhe u bashkuan në Komunitet; anëtarësimi i planifikuar i Norvegjisë u refuzua në referendumin e tetorit të vitit 1972 (me 53.5% kundër anëtarësimit në KE). 'Zgjerimi drejt jugut' filloi me anëtarësimin e Greqisë më 1 janar 1981 dhe përfundoi me anëtarësimin e Spanjës dhe Portugalisë, më 1 janar 1986. Zgjerimi i ardhshëm ishte më 1 janar 1995, me anëtarësimin e Austrisë, Finlandës dhe Suedisë. Në Norvegji, referendumi përsëriti rezultatin e para 22 viteve, me një mazhorancë të vogël (52.4%) kundër anëtarësimit të Norvegjisë në BE. Më 1 maj 2004 shtetet Baltike - Estonia, Letonia dhe Lituania, shtetet e Evropës Lindore dhe Qendrore - Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Sllovenia dhe Sllovakia, si dhe dy ishujt e Mesdheut - Qiproja dhe Malta u anëtarësuan në BE. Vetëm pas dy vjetësh, zgjerimi përfundoi drejt lindjes me anëtarësimin e Bullgarisë dhe Rumanisë, më 1 janar 2007. Me këtë zgjerim, numri i Shteteve Anëtare u rrit nga 15 në 27, kurse popullata e BE-së u shtua për 90 milionë dhe kështu arriti numrin 474 milionë. Ky zgjerim historik i BE-së është thelbi i procesit të gjatë drejt riunifikimit të Evropës, e cila ishte e ndarë për më se gjysmë shekulli nga Perdja e Hekurt dhe lufta e ftohtë. Mbi të gjitha, zgjerimi reflekton dëshirën

për paqe, stabilitet dhe prosperitet ekonomik në kontinentin e unifikuar Evropian.

Negociatat për anëtarësim të mëtejshëm janë në vazhdim e sipër me Turqinë, e cila dorëzoi aplikacionin e vet për anëtarësim më 14 prill 1987. Mirëpo, marrëdhëniet midis BE-së dhe Turqisë kanë filluar shumë më heret, qysh nga viti 1963, kur Tuqia dhe EEC-ja bënë marrëveshje asociimi, e cila i referohej perspektivës së anëtarësimit. Në vitin 1995 u formua unioni doganor kurse në Helsinki, në dhjetor 1999, Këshilli Evropian vendosi t'i japë zyrtarisht Turqisë statusin e kandidatës për anëtarësim. Kjo pasqyrore besimin se vendi kishte karakteristikat themelore të sistemit demokratik, edhe pse tregonte mangësi të mëdha në aspektin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave. Në dhjetor 2004, na bazë të rekomandimit të Komisionit, Këshilli Evropian më në fund dha dritën e gjelbër për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Turqinë; këto negociata kanë filluar nga tetori 2005. Qëllimi përfundimtar i këtyre negociatave është anëtarësimi, mirëpo nuk ka garanca për realizimin e këtij qëllimi. Ekziston marrëveshje përbrenda BE-së, se anëtarësimi nuk është i mundur para vitit 2014. Anëtarësimi i mundshëm duhet përgatitur me kujdes, për të mundësuar integrimin e pa trazuar dhe për të shmangur rrezikimin e arritjeve 50 vjeçare të integritimit evropian. Kandidatet tjera për anëtarësim janë Kroacia, ku fillimi i negociatave për anëtarësim u lejua në tetor 2005, dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, e cila zyrtarisht fitoi statusin e vendit kandidat në dhjetor të vitit 2005, pa datë të caktuar për fillimin e negociatave. Islanda dorëzoi aplikacionin e anëtarësimit më 17 korrik 2009. Më 24 shkurt 2010, Komisioni Evropian i rekomandoi Këshillit të hapë negociatat e anëtarësimit me Islandën.

BE-ja tani po punon me vendosmëri për zgjerime të reja në rajonin e Ballkanit Perëndimor. BE-ja ka vendosur të zbatojë metodologjinë e njëjtë për vendet e Ballkanit perëndimor, si atë që e ka përdorur për Shtetet e reja Anëtare. Prandaj, procesi i stabilizimit dhe asociimit mbetet korniza e përgjithshme për përparimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, deri në anëtarësimin e tyre të plotë. Hap i parë i rëndësishëm në këtë drejtim është krijimi i 'partneriteteve Evropiane' me Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën dhe Serbinë dhe Malin e Zi, përfshirë Kosovën<sup>(1)</sup>. Roli i partneriteteve evropiane, i cili azhurnohet sipas nevojës, është të ndihmojë shtetet e Ballkanit perëndimor

<sup>(1)</sup>Sipas Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244 të 10 qershorit të vitit 1999.

në përgatitjen për anëtarësim përbrenda një kornize të arsyeshme, si dhe në hartimin e planeve të veprimit me orare të caktuara për reformat dhe hollësitat për mjetet me të cilat synon të trajtojë kërkesat për integrim të mëtejshëm në BE.

Është krijuar dispozitë edhe për tërheqje nga BE-ja. Klauzula e tërheqjes është përfshirë në Traktatin e BE-së, e cila u lejon largimin Shteteve Anëtare nga BE-ja. Nuk ekzistojnë kushte të caktuara për largimin e këtillë nga BE-ja; gjithçka që është e nevojshme është një marrëveshje midis BE-së dhe Shtetit Anëtar të interesuar për aranzhimin e tërheqjes. Nëse nuk arrihet një marrëveshje e tillë, tërheqja është efektive pa asnjë marrëveshje, dy vjet pas informimit për planin e tërheqjes. Mirëpo, për shkelje serioze dhe të përsëritura të Traktateve, nuk ekziston asnjë dispozitë që mund të përjashtojë Shtetin Anëtar nga BE-ja.

# Vlerat fundamentale të Bashkimit Evropian

## *Neni 2 i Traktatit për BE-në (vlerat e Unionit)*

Unioni themelohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare, në një shoqëri ku dominon pluralizmi, jo-diskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis femrave dhe meshkujve.

## *Neni 3 i Traktatit për BE-në (qëllimet e Unionit)*

1. Qëllimi i Unionit është promovimi i paqes, vlerave të veta dhe mirëqenies së popujve të vet.

2. Unioni do t'u ofrojë qytetarëve të vet liri, siguri dhe drejtësi pa kufij të brendshëm, ku lëvizja e lirë e personave garantohej në pajtim me masat e duhura, për sa i përket kontrollit të kufijve të jashtëm, azilit, imigracionit dhe parandalimit dhe luftimit të krimit.

3. Unioni do të themelojë një treg të brendshëm. Ai do të punojë për zhvillimin e vazhdueshëm të Evropës, të bazuar në zhvillimin e balancuar ekonomik dhe stabilitetin e çmimeve, në ekonominë konkurrense të tregut social, duke synuar punësim të plotë dhe progres social, si dhe nivel të lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të kualitetit të ambientit jetësor. Do të promovojë përparimin shkencor dhe teknologjik.

Do të luftojë përjashtimin dhe diskriminimin social, dhe do të promovojë drejtësinë dhe mbrojtjen sociale, barazinë midis femrave dhe meshkujve, solidaritetin midis gjeneratave dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Do të promovojë kohezionin ekonomik, social dhe territorial midis Shteteve Anëtare.

Do të respektojë diversitetin e vet të pasur kulturor dhe gjuhësor dhe do të garantojë sigurinë dhe përmirësimin e trashëgimisë kulturore të Evropës.

4. Unioni do të themelojë një union ekonomik dhe monetar, valuta e të cilit quhet euro.

5. Në marrëdhëniet e veta me botën, Unioni do të mbështesë dhe promovojë vlerat dhe interesat e veta dhe do të kontribuojë në mbrojtjen e qytetarëve të vet. Do të kontribuojë për paqe, siguri, zhvillim të vazhdueshëm të planetit tonë, solidaritet dhe respekt të ndërsjellë midis popujve, tregti të lirë dhe të drejtë, çrrënjosje të skamjes dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut, sidomos të drejtat e fëmijëve, si dhe mbikqyrjen e rreptë dhe zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare, përfshirë edhe respektimin e parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

[...]

Themelet e Evropës së bashkuar u bazuan në ide dhe vlera fundamentale, të cilat i kanë pranuar edhe Shtetet Anëtare dhe të cilat janë kthyer në realitet praktik nga institucionet operative të Komunitetit. Këto janë paqja e përhershme, uniteti, barazia, liria, solidariteti dhe siguria. Qëllimet e pranuar të BE-së janë mbrojtja e parimeve të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit, të cilat i ndajnë të gjitha Shtetet Anëtare, dhe mbrojtja e të drejtave fundamentale dhe të drejtave të njeriut. Këto vlera duhet të jenë synim i shteteve që duan të bashkohen në BE, në të ardhmen. Veç kësaj, dënimet mund të zbatohen në secilin Shtet Anëtar, i cili bën shkeljen serioze dhe të vazhdueshme të këtyre vlerave dhe parimeve. Nëse Shefat e Shteteve dhe Qeverive, duke vepruar në bazë të propozimit të një të tretës të Shteteve Anëtare ose të Komisionit – dhe pas marrjes së pëlqimit të Parlamentit Evropian, deklarojnë se ka ndodhur shkelje serioze dhe e vazhdueshme e vlerave dhe parimeve themelore të BE-së, Këshilli – me mazhorancë të kualifikuar – mund të suspendojë disa të drejta që janë rrjedhojë e zbatimit të Traktatit të BE-së dhe Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian në Shtetin përkatës Anëtar, duke përfshirë edhe të drejtat e votimit në Këshill. Nga ana tjetër, sipas Traktateve obligimet mbi Shtetin Anëtar në fjalë vazhdojnë të jenë detyruese. Kujdes i veçantë i kushtohet efektit mbi të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe ndërmarrjeve.

## BE-JA SI GARANTUESE E PAQES

Nuk ka motivim më të madh për unifikimin evropian se dëshira për paqe. Në shekullin e fundit, dy lufta botërore lanë pasoja në Evropë, midis vendeve që tani janë Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian. Kështu, politika për Evropë njëkohësisht do të thotë politikë për paqe, kurse themelimi i BE-së njëkohësisht krijoi thelbin e kornizës për paqe në Evropë, e cila pamundëson luftën midis Shteteve Anëtare. Provë për këtë janë pesëdhjetë vjet paqe në Evropë. Sa më tepër Shtete Evropiane anëtarësohen në BE, aq më e fuqishme do të jetë kjo kornizë e paqes. Dy zgjerimet e fundit të BE-së, duke përfshirë 12 shtetet e Evropës Lindore dhe Qendrore, kanë dhënë kontribut të madh në këtë aspekt.

## UNITETI DHE BARAZIA SI TEMA TË PËRHERSHME

Uniteti është tema që përsëritet gjithnjë. Problemet e sotshme mund të kontrollohen vetëm nëse shtetet e Evropës ecin përpara në rrugën që i shpie drejt unitetit. Shumë njerëz kanë mendimin se në mungesë të integritetit Evropian dhe pa Bashkimin Evropian, nuk do të ishte e mundur të sigurohet paqëja (qoftë në Evropë apo në mbarë botën), demokracia, ligji dhe drejtësia, prosperiteti ekonomik dhe siguria sociale, dhe garantimi i tyre për të ardhmen do të ishte i pamundur. Ka kohë që papunësia, zhvillimi joadekuat dhe ndotja e ambientit nuk janë thjesht probleme nacionale dhe nuk mund të zgjidhen në nivel nacional. Vetëm në kontekst të BE-së, mund të themelohet një rend stabil ekonomik dhe vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta evropiane, mund të sigurojmë politikë ndërkombëtare ekonomike që përmirëson performancën e ekonomisë evropiane dhe kontribuon në drejtësinë sociale. Pa kohezion të brendshëm, Evropa nuk mund të mbrojë pavarësinë e vet politike dhe ekonomike nga pjesa tjetër e botës, nuk mund të ketë ndikimin në skenën ndërkombëtare dhe të rifitojë rolin e vet në politikën botërore.

Uniteti mund të qëndrojë vetëm aty ku barazia është rregull. Asnjë qytetar i Unionit nuk duhet vënë në pozitë të papëlqyeshme ose të diskriminohet për shkak të nacionalitetit të tij apo të saj. Trajtimi diskriminues në bazë të gjinisë, racës, origjinës etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual, doemos duhet luftuar. Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Njeriut shkon edhe më tej. Çdo lloj diskriminimi në bazë të ngjyrës së lëkurës, karakteristikave gjenetike, gjuhës, politikës ose mendimeve tjera,

anëtarësisë në pakicë nacionale, pronës ose lindjes, është i ndaluar. Veç kësaj, të gjithë qytetarët e Unionit janë të barabarta para ligjit. Sa u përket Shteteve Anëtare, parimi i barazisë nënkupton se asnjë Shtet nuk ka përparësi ndaj një shteti tjetër dhe dallimet natyrore siç janë madhësia, popullata dhe strukturat e ndryshme duhet të trajtohen vetëm në pajtim me parimin e barazisë.

## LIRITË FUNDAMENTALE

Liria rezulton drejtpërdrejt nga paqja, uniteti dhe barazia. Krijimi i një entiteti më të madh duke bashkuar 27 Shtete, mundëson njëkohësisht lirinë e lëvizjes përtej kufijve nacionalë. Kjo do të thotë liri e lëvizjes për punëtorët, liri e krijimit, liri e ofrimit të shërbimeve, lëvizje e lirë e mallërave dhe lëvizje e lirë e kapitalit. Këto liri fundamentale u garantojnë afaristëve lirinë e vendim-marrjes, punëtorëve – lirinë për të zgjedhur vendin e punës dhe konsumatorëve – lirinë e zgjedhjes nga gama e madhe e produkteve. Liria e konkurrencës u lejon bizneseve të ofrojnë mallërat dhe shërbimet e tyre në një rreth shumë më të gjerë të konsumatorëve potencialë. Punëtorët mund të kërkojnë punë dhe të ndërrojnë vendin e punës sipas dëshirës dhe interesave të tyre, në tërë territorin e BE-së. Konsumatorët mund të zgjedhin prodhime të lira dhe të mira nga oferta e madhe e mallërave, gjë që është rrjedhojë e konkurrencës së shtuar.

Mirëpo, rregullat e tranzicionit vlejné akoma në disa raste, për qytetarët e disa Shteteve Anëtare që u anëtarësuan në BE më 1 maj 2004 dhe më 1 janar 2007. Traktati i Anëtarësimit përmbante përjashtime, sidomos lidhur me lëvizjen e lirë të punëtorëve, lirinë e sigurimit të shërbimeve dhe lirinë e krijimit. Si pasojë e kësaj, Shtetet e ‘vjetra’ Anëtare të BE-së mund të kufizojnë lëvizjen e lirë të punëtorëve që janë shtetas të Shteteve të ‘reja’ Anëtare për një periudhë deri në shtatë vjet, duke ofruar qasje në punësim, varësisht nga ligji nacional ose bilateral.

## PARIMI I SOLIDARITETIT

Solidariteti është kurë e domosdoshme për lirinë, pasi që përdorimi i shkuadësuar i lirisë është gjithnjë në kurriz të tjetrit. Për këtë arsye, nëse korniza e Komunitetit është të jetë i qëndrueshëm, duhet poashtu të njohë solidaritetin



1 deri 3 qershor 1955, Taormina (Itali).

Josef Bek, Paul-Henri Spak dhe Johan Uilem Bejen, në kopshtin e hotelit ku ishin të vendosur gjatë Konferencës në Mesina. Këta tre Ministra të Punëve të Jashtme hartuan Memorandumin e Beneluksit, i cili u diskutua nga Gjashtëshja gjatë kësaj konference.



e anëtarëve të tij si parim fundamental, dhe të ndajë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë midis vendeve anëtare, si prosperitetin ashtu edhe barrën.

## RESPEKTIMI I IDENTITETIT NACIONAL

Identitetet nacionale të Shteteve Anëtare respektohen. Shtetet Anëtare nuk duhet të 'shkrihen' në BE, por të kontribuojnë me kualitetet e veta të veçanta. Është pikërisht kjo llojllojshmëri e karakteristikave dhe identiteteve nacionale që i jep BE-së autoritetin e vet moral, i cili shfrytëzohet për përfitimet e BE-së si tërësi.

## NEVOJA PËR SIGURI

Të gjitha këto vlera fundamentale janë në vartësi supreme nga siguria. Sidomos pas sulmit mbi SHBA-të, më 11 shtator 2001, lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar në Evropë ka qënë në qendër të vëmendjes përsëri. Bashkëpunimi policor dhe gjyqësor vazhdon të jetë i konsoliduar, kurse mbrojtja e kufijve të jashtëm të BE-së është intensifikuar. Mirëpo, siguria në kontekst evropian gjithashtu nënkupton siguri sociale për të gjithë qytetarët që jetojnë në BE, siguri të punës dhe kushte të sigurta të përgjithshme ekonomike dhe për biznes. Në këtë aspekt, institucionet e BE-së priten t'u mundësojnë qytetarëve dhe bizneseve të zgjidhin ardhmërinë e tyre duke krijuar kushtet nga të cilat varen.

## TË DREJTAT FUNDAMENTALE

Vlerat dhe konceptet fundamentale në qendër të BE-së gjithashtu përfshijnë edhe të drejtat fundamentale të qytetarëve individualë të Unionit. Historia e Evropës, për më se 200 vjet, është karakterizuar me përpjekjet e vazhdueshme të mbrojtjes së të drejtave fundamentale. Duke filluar me deklaratat e të drejtave civile dhe të njeriut në shekullin 18, të drejtat fundamentale dhe liritë civile tani ankorohen në kushtetutat e shteteve më të civilizuar. Kjo është veçanërisht e saktë për Shtetet Anëtare të BE-së, sistemet ligjore të të cilave janë të ndërtruara në bazë të sundimit të ligjit dhe respektimit të dinjitetit, lirisë dhe të drejtës për vetë-zhvillimin e individit. Ekzistojnë shumë konventa ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, midis të cilave me rëndësi të madhe është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në vitin 1969, Gjykata e Drejtësisë themeloi organin e praksës gjyqësore që të shërbente si kornizë e të drejtave fundamentale. Kjo ndodhi pasi që në vitet e para Gjykata kishte refuzuar të gjitha veprimet që kishin të bënin me të drejtat themelore, për arsye se nuk duhej të merret me çështje që i përkisnin të drejtës kushtetuese nacionale. Gjykata duhej të ndryshonte qëndrimin e vet, por jo për shkak se ajo vetë ishte mishërim i prioritetit të të drejtës së Unionit dhe paraprirjen e saj ndaj të drejtës nacionale; kjo përparësi mund të themelohet vetëm nëse e drejta e Unionit është e vetë-kënaqshme për të garantuar mbrojtjen e të drejtave themelore me fuqinë e njëjtë ligjore si me atë të kushtetutave nacionale.

Pika fillestare në këtë praksë gjyqësore ishte vendimi *Stauder*, ku çështja në fjalë ishte fakti se përfituesi i beneficioneve mbarëvajtëse për viktime lufte konsideronte shkelje të dinjitetit të vet njerëzor dhe të parimit të barazisë, kërkesën për të dhënë emrin gjatë regjistrimit për blerje të gjalpës me çmim të liruar në periudhën e Krishtlindjes. Në interpretimin e dispozitës të Komunitetit, edhe pse Gjykata e Drejtësisë erdhi në përfundim se nuk ishte e domosdoshme që pranuesit të jepnin emrin e tyre; dhe kështu, në fakt, marrja parasysh e shkeljes së të drejtave fundamentale do të ishte e panevojshme, deklaroi përfundimisht se parimet e përgjithshme fundamentale të rendit ligjor të Komunitetit, të cilat duhej t'i ruante Gjykata e Drejtësisë, përfshinin respektimin e të drejtave fundamentale. Kjo ishte hera e parë që Gjykata e Drejtësisë njëjtte ekzistimin e një kornize të BE-së mbi të drejtat e veta fundamentale.

Fillimisht, Gjykata përgatiti mbrojtjen e të drejtave fundamentale nga disa dispozita të Traktateve. Ky është rasti për numrin e madh të dekretimeve të diskriminimit, në rrethana specifike, trajtojnë aspekte të caktuara të parimit të përgjithshëm të barazisë. Shembujt janë ndalimi i të gjitha diskriminimeve në bazë të nacionalitetit (Neni 18 TFEU), parandalimi që njerëzit të trajtohen ndryshe, në bazë të gjinisë, racës, origjinës etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual (Neni 10 TFEU), trajtimi i barabartë i mallërave dhe personave, në kontekstin e katër të drejtave themelore (liria e lëvizjes së mallërave — Neni 34 TFEU; liria e lëvizjes së personave — Neni 45 TFEU; e drejta e krijimit — Neni 49 TFEU; dhe e drejta e ofrimit të shërbimeve — Neni 57 TFEU), liria e konkurrencës (Neni 101 et seq. TFEU) dhe pagat e barabarta për meshkujt dhe femrat (Neni 157 TFEU). Katër liritë fundamentale të Komunitetit, të cilat garantojnë liritë themelore të jetës profesionale, mund të konsiderohen edhe si e drejtë fundamentale e

Komunitetit për liri të lëvizjes dhe liri të zgjedhjes së profesionit. Garancat eksplicite gjithashtu mundësohen për të drejtën e asociimit (Neni 153 TFEU), të drejtën e peticionit (Neni 24 TFEU) dhe mbrojtja e bizneseve dhe privatësisë profesionale (Neni 339 TFEU).

Gjykata e Drejtësisë gradualisht ka zhvilluar dhe ka shtuar këto përpjekje fill-estare për mbrojtjen e të drejtave fundamentale me anë të ligjit të Komunitetit. Këtë e ka bërë me njohjen dhe zbatimin e parimeve të përgjithshme ligjore, duke u joshur drejt koncepteve të përbashkëta për kushtetutat e Shteteve Anëtare dhe konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat janë nënshkruar edhe nga Shtetet Anëtare. Më e spikatur nga konventat ndërkombëtare është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ndihmoi formësimin e substancës për të drejta fundamentale në Union dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre. Duke u bazuar në këtë, Gjykata ka njohur një numër të lirive si të drejta themelore të siguruara me ligjin e Komunitetit: e drejta e pronësisë, liria e angazhimit në një profesion, pacënueshmëria e shtëpisë, liria e opinionit, të drejtat e përgjithshme të personalitetit, mbrojtja e familjes (p.sh. të drejtat e anëtarëve të familjes t'i bashkohen një punëtori emigrant), liria ekonomike, liria e fesë ose besimit, si dhe një numër i i të drejtave fundamentale procedurale, siç janë e drejta e procesit përkatës gjyqësor, parimi i konfidencialitetit të korrespondencës midis avokatit dhe klientit (i njohur si 'komunikim i privilegjuar' në shtetet me ligj zakonor), ndalimi i dënimit të dyfishtë për të njëjtën veprë penale, ose kërkesa e justifikimit të një akti ligjor të BE-së.

Një parim veçanërisht i rëndësishëm, i cili rregullisht paraqitet në konfliktet ligjore, është parimi i trajtimit të barabartë. Thënë shkurt, kjo do të thotë se rastet e ngjashme duhen trajtuar njëllëj, përveç nëse nuk ekziston bazë e arsyetueshme objektive për t'i dalluar ato. Mirëpo, përkundër traditës ndërkombëtare, qëndrimi i Gjykatës së Drejtësisë është se ky parim nuk përjashton mundësinë që shtetasit dhe mallërat vendore t'u nënshtrohen kërkesave më të ashpra për dallim nga qytetarët ose prodhimet nga Shtetet e tjera Anëtare. Ky 'diskriminim i mbrapsht' është rezultat i pashmangshëm i fushëveprimit të kufizuar të fuqive të Unionit dhe nuk mund të rregullohet nga ligji i Komunitetit. Sipas vendimeve të deritanishme të Gjykatës, rregullat e liberalizimit, të cilat rrjedhin nga liritë fundamentale, vlejné vetëm për tregti jashtë kufijve. Rregullat që rregullojnë prodhimin dhe marketingun e mallërave vendore ose statusin ligjor të shtetasve në Shtetin e tyre Anëtar, ndikohen nga e drejta e Komunitetit vetëm nëse Unioni ka inkuadruar masat e harmonizimit.

Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë i ka dhënë Unionit një organ të shtrirë të ligjit kuazi-kushtetues. Me fjalë të thjeshta, parimi i proporcionalitetit është kryesori. Kjo do të thotë se objektivat e ndjekura dhe masat e përdorura duhet të peshohen dhe të bëhet përpjekje për t'i mbajtur ato të balancuara, në mënyrë që të mos i nënshtrohen barrës së panevojshme. Midis parimeve të tjera fundamentale që përbëjnë të drejtën e Unionit, janë parimet e përgjithshme të ligjit administrativ dhe koncepti i procesit gjyqësor përkatës: mundësitë legjitime doemos duhet të mbrohen, duhet të parandalohen dispozitat retroaktive që ngarkojnë barrë ose tërheqin avantazhet e fituara në mënyrë legjitime dhe e drejta e procesit përkatës gjyqësor — drejtësia natyrore është termi tradicional — duhet të sigurohen me procedurat administrative të Komisionit dhe procedurat gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë. Vlerë të posaçme ka transparencja më e madhe, gjë që do të thotë se vendimet duhet të jenë të hapura dhe më afër qytetarëve. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj transparence është se të gjithë qytetarët e BE-së ose personat juridik në një Shtet Anëtar mund të kenë qasje të hapur në dokumentet e Këshillit ose të Komisionit. Të gjitha grantet dhe subvencionet e buxhetit të BE-së duhet t'u bëhen të ditura personave fizikë dhe juridik, me anë të bazave të të dhënave, të hapura për të gjithë qytetarët e Unionit.

Përkundër arritjeve të Gjykatës së Drejtësisë në zhvillimin e të drejtave të pashkruara fundamentale, procesi i 'të drejtave fundamentale evropiane' ka disavantazhe të mëdha: Gjykata e Drejtësisë i përmbahej vetëm rastit në fjalë. Prandaj Gjykata nuk kishte mundësi të hartojë të drejtat fundamentale nga parimet e përgjithshme ligjore për të gjitha fushat në të cilat kjo ishte e domosdoshme ose e dëshirueshme. Nuk kishte as mundësi të elaborojë fushëveprimin dhe kufizimet për mbrojtjen e të drejtave fundamentale në mënyrë sa më të përgjithshme dhe më karakteristike. Si rezultat i kësaj, institucionet e BE-së nuk mund të jepnin vlerësim preciz nëse rrezikonin apo jo shkeljen e të drejtave fundamentale. As edhe qytetarët e cenuar të Unionit nuk mund të gjykonin (pa përpjekje më të thella në çdo rast) nëse është bërë shkelja e të drejtave të tij/saj fundamentale.

Një kohë të gjatë, anëtarësimi i BE-së në Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut konsiderohej si dalje nga kjo situatë. Mirëpo, në Opinionin e vet 2/94, Gjykata mbante qëndrimin se, sipas ligjit ekzistues, BE-ja nuk kishte kompetencë të përputhet me konventën. Gjykata deklaronte se respektimi i të drejtave të njeriut është kusht për ligjshmërinë e akteve të BE-së. Mirëpo, përputhja me konventën do të detyronte ndryshim substancial në sistemin e tanishëm të Unionit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pasi që do të involvonte hyrjen

e BE-së në një sistem të dalluar ndërkombëtar institucional si dhe integrimi i të gjitha dispozitave të konventës në rendin ligjor të Unionit. Gjykata mori qëndrimin se modifikimi i këtillë i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në BE, me implikime të barabarta fundamentale institucionale për Unionin dhe Shtetet Anëtare, do të kishte rëndësi kushtetuese dhe prandaj do të mund të tejkalonte fushëveprimin e fuqive dispozitive të rregulluara me Nenin 352 TFEU. Prandaj, Anëtarësimi i BE-së në konventë ishte i paraparë me Nenin 6(2) të Traktatit të BE-së. Mirëpo, Traktati i Lisbonës bëri një hap vendimtar drejt krijimit të të drejtës të përbashkët kushtetuese për BE-në dhe sërish ekuilibri mbrojtjen e të drejtave fundamentale në BE. Neni i ri mbi të drejtat fundamentale në Traktatin e BE-së (Neni 6 TEU) i referohet Kartës të Bashkimit Evropian për të Drejta Fundamentale, duke e shpallur atë detyrues për aktet e institucioneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare, në atë masë që zbatojnë dhe implementojnë të drejtën e Unionit.

Kjo Kartë e të Drejtave Fundamentale bazohet në propozimin e hartuar gjatë konventës së 16 përfaqësuesve të Shefave të Shteteve ose Qeverive të Shteteve Anëtare dhe Presidentit të Komisionit Evropian, 16 Deputetë të Parlamentit Evropian dhe 30 deputetë të parlamenteve nacionale (dy nga secili Shtet i atëhershëm Anëtar) nën kryesinë e Profesorit Roman Herzog. Karta e deklaruar zyrtarisht u shpall si 'Karta e Bashkimit Evropian për të Drejta Fundamentale' nga Presidentët e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit Evropian, më 7 dhjetor 2000. Gjatë negociatave mbi kushtetutën evropiane, kjo Kartë e të Drejtave Fundamentale u rishqyrtua dhe u bë pjesë përbërëse e Traktatit themelues të Kushtetutës për Evropën, më 29 tetor 2004. Pas dështimit të Traktatit, Karta e të Drejtave Fundamentale përsëri zyrtarisht u shpall si 'Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Fundamentale', këtë herë si instrument i veçantë, nga Presidentët e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit Evropian, më 12 dhjetor 2007 në Strazbur. Traktati i BE-së i referohet këtij versioni të kartës në formë detyruese. Kjo e bën Kartën e të Drejtave Fundamentale ligjërisht detyruese dhe gjithashtu themelon zbatueshmërinë e të drejtave fundamentale në të drejtën e Unionit. Mirëpo, kjo nuk vlen për Poloninë dhe Britaninë e Madhe. Këto dy Shtete Anëtare nuk mundën, ose nuk deshën të miratojnë sistemin e të drejtave fundamentale sipas kartës, pasi që mendonin se do të ishin të obliguara të dorëzojnë ose së paku të ndryshojnë disa qëndrime të caktuara nacionale që kanë të bëjnë me çështjet fetare ose trajtimin e pakicave. Prandaj, ato nuk janë të detyruara ndaj të drejtave fundamentale të kartës, por nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë, ashtu si më parë.

# 'Kushtetuta' e Bashkimit Evropian

Çdo organizatë sociale ka kushtetutë. Kushtetuta është mjeti me të cilin definohet struktura e një sistemi politik, d.m.th. precizohet marrëdhënia e pjesëve të ndryshme me njëri tjetrin dhe ndaj tërësisë, definohen synimet e përbashkëta dhe përcaktohen rregullat për krijimin e vendimeve detyruese. Kushtetuta e BE-së, si një asociacion i shteteve të cilave u janë ndarë detyra dhe funksione mjaft specifike, duhet t'u përgjigjet pyetjeve njëloj si një kushtetutë shtetërore.

Në Shtetet Anëtare politika formësohet nga dy parime parësore: sundimi i ligjit dhe demokracia. Të gjitha aktivitetet e Unionit, nëse i qëndrojnë besnikë kërkesave fundamentale të ligjit dhe demokracisë, duhet të kenë legjitimitetin ligjor dhe demokratik: elementet në të cilat bazohet ai; struktura e tij, fuqitë e tij, mënyra e funksionimit, qëndrimi i Shteteve Anëtare dhe institucioneve të tyre, dhe qëndrimi i qytetarëve.

Pas dështimit të Traktatit themelues të Kushtetutës për Evropën, më 29 tetor 2004, 'kushtetuta' akoma nuk është formuluar në një dokument të përgjithshëm kushtetues, ashtu si është rasti në kushtetutat e Shteteve të veta Anëtare, mirëpo kushtetuta del nga të gjitha rregullat dhe vlerat fundamentale me të cilat janë të lidhur ato në fuqi. Këto rregulla pjesërisht janë të përfshira në Traktatet Evropiane ose në instrumentet ligjore që dalin nga institucionet e Unionit, por pjesërisht mbeten në përvojë.

## NATYRA LIGJORE E BE-SË

Çdo vlerësim i natyrës ligjore të BE-së duhet të fillojë nga karakteristikat e tij ligjore. Edhe pse natyra ligjore e BE-së u shpalo në dy vendimet e Gjykatës së Drejtësisë që përcaktuan presidencën, në 1963 dhe 1964, mbi Komunitetin e atëhershëm Ekonomik Evropian, vendimet vlejné edhe për Bashkimin Evropian në formën e sotshme.

*VAN GEND & LOOS*

Në këtë konflikt ligjor, ndërmarrja hollandeze për transport Van Gend & Loos ngriti padi kundër autoriteteve doganore hollandeze për vënien e tatimit të importit një prodhimit kimik nga Gjermania, i cili ishte më i lartë se tatimet në importet e mëparshme. Ndërmarrja këtë e konsideronte shkëlqje të Nenit 12 të Traktatit të Komunitetit Ekonomik Evropian, i cili ndalon futjen e tatimeve të reja të importit apo rritje të tatimeve tjera ekzsituose midis Shteteve Anëtare. Gjykata në Hollandë pezulloi procesin gjyqësor dhe referoi rastin në Gjykatën e Drejtësisë për qartësim të diapazonit dhe implikimeve ligjore të nenit të lartpërmendur të Traktatit themelues të KE-së.

Gjykata e Drejtësisë shfrytëzoi këtë rast si mundësi për të përcaktuar disa vërejtje të natyrës fundamentale, që kanë të bëjnë me natyrën ligjore të BE-së. Në vendimin e vet, Gjykata deklaroi se:

‘Objektiva e Traktatit të Komunitetit Ekonomik Evropian – themelimi i tregut të vetëm, funksionimi i të cilit është çështje e palëve të interesuara në Komunitet, lë të kuptohet se ky Traktat është më shumë se një marrëveshje që krijon obligime reciproke midis Shteteve kontraktuese. Këtë qëndrim e konfirmon preambulla e Traktatit, e cila u referohet jo vetëm qeverive por edhe popujve. Ky qëndrim është konfirmuar në mënyrë më specifike edhe me themelimin e institucioneve të pajisura me të drejta sovraane, ushtrimi i të cilave ka ndikim në Shtetet Anëtare dhe qytetarëve të tyre ... Nga kjo mund të konkludohet se Komuniteti përbën një rend të ri ligjor në të drejtën ndërkombëtare, për beneficionin e të cilit, Shtetet kanë kufizuar të drejtat e tyre sovraane, megjithëse vetëm në disa fusha, dhe subjektet nga të cilat përbëhen jo vetëm Shtetet Anëtare por edhe shtetasit e tyre.’

*COSTA KUNDËR ENEL*

Vetëm pas një viti, rasti *Costa* kundër *ENEL* i dha Gjykatës të Drejtësisë mundësinë e përcaktimit më të detajuar të pozitës së vet. Faktet e këtij rasti ishin si vijon. Në 1962, Italia nacionalizoi prodhimin dhe distribuimin e energjisë elektrike dhe asetet e ndërmarrjeve të energjisë elektrike i transferoi bordit nacional për energji elektrike, ENEL. Si aksioner i ndërmarrjes Edison Volt, një nga kompanitë e nacionalizuara, z. Costa konsideronte se ishte privuar nga dividenda e tij dhe si pasojë, refuzonte të pagojë llogarinë e energjisë elektrike në shumë prej 1 926 lira italiane. Në procesin gjyqësor

para gjykatës së arbitrazhit në Milano, një nga argumentet e prezantuara nga z. Costa, për të justifikuar sjelljen e tij, ishte se akti i nacionalizimit bënte shkeljen e një numri të madh të dispozitave të Traktatit për Komunitetin Ekonomik Evropian. Në mënyrë që të vlerësonte parashtrimin e z. Costa për mbrojtjen e vet, gjyqi kërkoi nga Gjykata e Drejtësisë të interpretonte aspektet e ndryshme të Traktatit të EEC-së. Në vendimin e vet, Gjykata e Drejtësisë deklaroi si vijon, lidhur me natyrën ligjore të EEC-së:

‘Për dallim nga traktatet e zakonshme ndërkombëtare, Traktati i EEC-së ka krijuar sistemin e vet ligjor, i cili ... u bë pjesë përbërëse e sistemeve ligjore të Shteteve Anëtare, gjykatat e të cilave janë të detyruara t’i zbatojnë ato. Me krijimin e një Komuniteti që ka kohëzgjatje të pakufizuar, me institucione të veta, me personalitet të vetin, kapacitetin e vet ligjor dhe kapacitetin e përfaqësimit në nivel ndërkombëtar dhe, sidomos, fuqitë reale që vijnë nga kufizimi i sovranitetit dhe transferi i fuqive prej Shteteve në Komunitet, Shtetet Anëtare kanë kufizuar të drejtat e tyre sovraane ... dhe kështu kanë krijuar një trup ligjor që detyron shtetasit e tyre dhe ato vetë.’

Në bazë të vëzhgimit të hollësishëm, Gjykata mori vendimin në vijim:

‘Pas të gjitha këtyre vëzhgimeve, del se ligji që ka rrënjë nga Traktati – një burim i pavarur i ligjit, për shkak të natyrës së vet origjinale dhe specifike nuk mund të tejkalohet nga dispozitat ligjore vendore, sidoqofshin të formësuara ato, pa qënë e privuar nga karakteri i saj si e drejtë e Komunitetit dhe pa e vënë në dyshim bazën ligjore të vetë Komunitetit. Transferimi i të drejtave dhe obligimeve që dalin nga Traktati, prej sistemeve legjislativë vendore të Shteteve në sistemin ligjor të Komunitetit, mbart një kufizim permanent të të drejtave të tyre sovraane, kundër të cilit nuk mund të mbizotërojë akti unilateral që nuk është në pajtim me konceptin e Komunitetit.’

Lidhur me këto vendime, elementet që së bashku karakterizojnë natyrën speciale ligjore të BE-së, janë:

- struktura institucionale, e cila garanton se veprimet e BE-së gjithashtu karakterizohen edhe me interesin e përgjithshëm të Evropës, d.m.th reflektohet në interesin e Unionit ose influencohet nga ai, sipas objektivave të parapara;
- shkalla më e lartë e transferit të fuqive në institucionet e Unionit në krahasim me organizatat tjera ndërkombëtare, dhe shtrirja në fushat ku Shtetet zakonisht ruajnë të drejtat e tyre sovraane;



- krijimi i rendit të vet ligjor, i cili është i pavarur nga rendet ligjore të Shteteve Anëtare;
- zbatimi i drejtpërdrejtë i të drejtës së Unionit, me çka dispozitat e të drejtës së Unionit janë plotësisht të zbatueshme dhe të njëtrajshme në të gjitha Shtetet Anëtare, si dhe vendos të drejta dhe imponon obligime për Shtetet Anëtare dhe për qytetarët e vet;
- parësia e të drejtës së Unionit, e cila garanton se e drejta e Unionit nuk mund të anulohet ose të ndryshohet nga e drejta nacionale dhe se ka përparësi mbi të drejtën nacionale, nëse këto të dyja ndeshen.

Prandaj, BE-ja është entitet autonom me të drejtat e veta sovraane dhe rendin ligjor të pavarur nga Shtetet Anëtare, të cilit i nënshtrohen edhe Shtetet Anëtare edhe shtetasit e tyre, përbrenda fushave të kompetencës të BE-së.

Nga natyra e vet, BE-ja ka karakteristika të caktuara, të përbashkëta me llojin e zakonshëm të organizatave ndërkombëtare ose strukturën e llojit federal, si dhe një numër dallimesh.

BE-ja nuk është akoma një 'produkt përfundimtar'; është në proces të evoluimit dhe forma përfundimtare e tij nuk mund të parashikohet akoma.

Karakteristika e vetme që BE-ja e ka të përbashkët me organizatat tradicionale ndërkombëtare është se u krijua si rezultat i një traktati ndërkombëtar. Mirëpo, BE-ja ka ecur rrugë të gjatë. Kjo është për arsye se, edhe pse Traktatet themeluese të BE-së bazoheshin në traktatet ndërkombëtare, ato çuan deri të krijimi i një Unioni të pavarur me të drejtat dhe përgjegjësitë e veta sovraane. Shtetet Anëtare kanë hequr dorë nga disa prej fuqive të tyre sovraane për t'ia dorëzuar ato Unionit. Veç kësaj, detyrat që i janë dhënë BE-së dallojnë shumë nga ato të organizatave të tjera ndërkombëtare. Ndërsa organizatat ndërkombëtare kryesisht kanë detyra të definuara qartë të natyrës teknike, BE-ja ka fusha përgjegjësie të cilat së bashku përbëjnë atributet themelore të një shteti.

Përmes këtyre dallimeve midis BE-së dhe llojit tradicional të organizatave ndërkombëtare, BE-ja është në proces të marrjes së statusit të ngjashëm me atë të një shteti individual. Sidomos, dhënia e pjesërishme e të drejtave sovraane të Shteteve Anëtare u konsiderua si shenjë se BE-ja tani më ishte strukturuar në një lloj të shtetit federal. Megjithatë, ky qëndrim dështon të marrë parasysh se institucionet e BE-së kanë fuqi vetëm në fusha të caktuara

për të ndjekur synimet e përcaktuara në Traktate. Kjo do të thotë se ato nuk mund të zgjedhin synimet e veta në mënyrë të njejtë siç e bëjnë atë një shtet sovran; nuk janë as në pozitë të përballen me sfidat më të cilat përballohen shtetet moderne sot. BE-ja nuk ka as juridiksionin e përgjithshëm që e gëzojnë shtetet sovrane, e as fuqinë për themelimin e fushave të reja të përgjegjësive ('juridiksion mbi juridiksion').

Prandaj, BE-ja nuk është as organizatë ndërkombëtare në kuptimin e zakonshëm dhe as asocim i shteteve, por më mirë thënë një entitet autonom që paraqet kombinim të dy formave të lartpërmendura. Në qarqet juridike, tani përdoret shprehja 'organizatë supranacionale'.

## DETYRAT E BE-SË

Lista e detyrave që i janë besuar BE-së i ngjan shumë rregullit kushtetutar të një shteti. Këto nuk janë detyra teknike të kufizuara të cilat zakonisht i pranojnë organizatat ndërkombëtare, mirëpo fusha të kompetencës, të cilat si tërësi formojnë attribute themelore të shtetësisë.

Lista e detyrave të besuara BE-së është e shumëllojshme, ku përfshihen veprimet ekonomike, sociale dhe politike.

Detyrat ekonomike janë të fokusuar në krijimin e tregut të përbashkët që unifikon tregjet nacionale të Shteteve Anëtare dhe në të cilin mallërat dhe shërbimet do të ofrohen dhe shiten me kushtet e njëjta si në një treg të brendshëm, dhe në të cilin do të kenë qasjen e njëjtë dhe të lirë të gjithë qytetarët e Unionit.

Plani për të krijuar një treg të përbashkët është plotësuar kryesisht përmes programit që ka për qëllim përfundimin e tregut të brendshëm në vitin 1992, gjë që u inicua nga Presidenti i atëhershëm i Komisionit, Zhak Delor, dhe u miratua nga Shefat e Shteteve ose Qeverive. Paso i hartimi i suksesshëm i kornizës ligjore - nga institucionet e Unionit - për funksionimin e duhur të tregut unik. Kjo kornizë tani mishërohet në një shkallë të madhe në masat nacionale të zhvendosjes, me rezultatin se tregu unik tani më është bërë realitet. Ky treg unik gjithnjë e më shumë ndjehet në jetën e përditshme, sidomos gjatë udhëtimeve përbrenda BE-së, ku kontrollet e identifikimit në kufijtë nacionalë ka kohë që janë ndërprerë.

Tregun e brendshëm e mbështet unioni ekonomik dhe monetar.

Detyra e BE-së në politikën ekonomike nuk është të hartojë dhe të vejë në funksion politikën ekonomike evropiane, por të koordinojë politikën ekonomike nacionale, në mënyrë që vendimet politike të një ose më tepër Shteteve Anëtare të mos kenë reperkusione negative për operimin e tregut të vetëm. Për këtë qëllim, Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit u miratua për t'u dhënë Shteteve Anëtare kritere të hollësishme të cilat duhet t'i plotësojnë vendimet e tyre mbi politikën buxhetore. Nëse dështojnë ta bëjnë këtë, Komisioni Evropian mund të japë paralajmërim, në rastet e deficitit të madh dhe të vazhdueshëm buxhetor, Këshilli mund të imponojë gjyba.

Detyra e BE-së në politikën monetare ishte dhe është të fusë valutën e vetme në BE dhe të kontrollojë çështjet monetare në nivel qendror. Në këtë fushë tani më është arritur sukses. Më 1 janar 1999, valuta euro u prezantua si valuta e vetme evropiane në Shtetet Anëtare, të cilat kishin plotësuar kriteret e konvergencës të themeluara për këtë qëllim. Këto shtete ishin Belgjika, Gjermania, Irlanda, Spanja, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia dhe Finlanda. Më 1 janar 2002, valutat nacionale të këtyre shteteve u zëvendësuan me banknotat dhe monedhat euro. Prej atëherë, pagesat e tyre të përditshme dhe transaksionet financiare janë bërë vetëm në një valutë — euro. Greqia dhe Suedia, në fillim dështuan të plotësonin kriteret e konvergencës. Greqia u përfshi më 1 janar 2001. Suedia, e cila nuk mund t'i plotësonte kriteret e konvergencës, parimisht për shkak të faktit se nuk mirrte pjesë në mekanizmin e këmbimit valutor të Sistemit Monetar Evropian ('dhoma e pritjes' për euron), i nënshtrohet dobësisht me atë që Komisioni dhe Banka Qendrore Evropiane duhet të paraqesin raportet e konvergencës për Suedinë, së paku çdo dy vjet, në të cilat mund të rekomandojnë pjesëmarrjen e Suedisë në Këshill. Nëse një rekomandim i këtillë jepet dhe miratohet nga Këshilli, Suedia nuk do të mund të refuzojë pjesëmarrjen. Mirëpo, për momentin, përkrahja e popullatës suedeze për t'iu bashkuar zonës euro, është shumë e vogël. Në referendumin e vitit 2003, 55.9% ishin kundër futjes së euros. Në një anketë në dhjetor 2005, 49% ishin akoma kundër euros, kurse 36% në favor të saj. Situata dallon nga ajo me Danimarkën dhe Britaninë e Madhe. Këto Shtete Anëtare siguruan opcionin e daljes, i cili u mundëson të vendosin nëse dhe kur duhet të inicohet procedura për verifikimin e përpunshmërisë për t'iu bashkuar me valutën e vetme. Shtetet e reja Anëtare janë të obliguara të pranojnë euron si valutën e vet nacionale, posa t'i plotësojnë kriteret e konvergencës. Asnjë nga Shtetet e



6 dhjetor 1977, Bruksel.

Demonstrata në favor të zgjedhjeve në bazë të votimit universal për Parlamentin Evropian dhe në favor të valutës së vetme gjatë takimit të Këshillit Evropian më 5 dhe 6 dhjetor 1977.

reja Anëtare nuk kanë klauzolën e largimit, kurse shumica e Shteteve të reja Anëtare duan të fusin euron sa më shpejtë. Sllovenia (1 janar 2007), Qiproja (1 janar 2008), Malta (1 janar 2008) dhe Sllovakia (1 janar 2009) tani më e kanë arritur këtë, duke zgjeruar ‘zonën euro’ — vendet që përdorin euron si valutë të vetën — janë gjithsej 16 Shtete Anëtare.

Veç fushës së politikës ekonomike dhe monetare, ka edhe shumë fusha të tjera të politikës ekonomike ku BE-ja ka përgjegjësi. Këto përfshijnë sidomos politikën e bujqësisë dhe peshkimit, politika e transportit, politika e konsumatorëve, politika strukturore dhe e kohezionit, politika e hulumtimit dhe e zhvillimit, politika e hapësirës, politika e ambientit jetësor, politika e shëndetësisë, politika e tregtisë dhe politika e energjisë elektrike.

Në politikën sociale, BE-ja ka për detyrë të garantojë se beneficionet e integritimit ekonomik nuk i ndejnë vetëm ata që janë aktivë në ekonomi, por formësojnë edhe dimenzionin social të tregut të vetëm. Një nga pikat fillestare për këtë ka qënë futja e sistemit të sigurimit social për punëtorët emigrantë. Me këtë sistem, punëtorët që kanë punuar në më tepër Shtete Anëtare dhe si rrjedhojë kanë pasur skema të ndryshme të sigurimit social, nuk do të pësojnë disavantazhe, për sa i përket sigurisë së tyre sociale (pensioni sipas moshës, pensioni invalidor, shëndetësia, beneficionet, beneficionet e papunësisë). Një detyrë tjetër prioritare e politikës sociale, lidhur me gjendjen e papunësisë në BE, gjë që ka shkaktuar shqetësim për shumë vite me radhë, ka qënë nevoja për krijimin e mekanizmit evropian për strategji të punësimit. Me këtë, ju bëhet apel Shteteve Anëtare dhe BE-së të zhvillojnë strategji për punësim dhe sidomos të nxisin forcën e kualifikuar të punës, të trajnuar dhe të adaptueshme. Pos kësaj tregjet e forcës punëtore duhet t’i adaptohen ndryshimit ekonomik. Promovimi i punësimit konsiderohet si çështje e përbashkët, dhe kërkon nga Shtetet Anëtare t’i koordinojnë masat e veta nacionale përbrenda Këshillit. BE-ja do të kontribuojë në nivelin e lartë të punësimit, me anë të inkurajimit të bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare dhe, nëse është nevoja, të plotësojnë veprimet e veta duke respektuar kompetencat e tyre.

Në lidhje me fushën aktuale të politikës, BE-ja ka detyra në fushën e shtetësisë së Unionit, politikën e bashkëpunimit gjyqësor në rastet e veprave penale dhe politikën e përbashkët të punëve të jashtme dhe të sigurisë. Shtetësia e Unionit ka përforcuar edhe më shumë të drejtat dhe interesat e shtetasve të Shteteve Anëtare përbrenda BE-së. Qytetarët gëzojnë të drejtën e lëvizjes së

libër përbrenda Unionit (Neni 21 TFEU), e drejta për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhjet lokale (Neni 22 TFEU), gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga autoritetet diplomatike dhe konsulare të cilitdo Shtet Anëtar (Neni 23 TFEU), të drejtën për t'i dorëzuar peticion Parlamentit Evropian (Neni 24 TFEU) dhe, në kontekst të ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit – të drejtën për të qënë i trajtuar nga Shtetet Anëtare, në mënyrë të njëjtë siç trajtohen shtetasit e tyre (neni 20(2) në pajtim me Nenin 18 TFEU). Për sa i përket politikës së përbashkët të punëve të jashtme dhe të sigurisë, BE-ja ka veçanërisht detyrat si vijon:

- mbrojtjen e vlerave të përbashkëta, interesat fundamentale dhe pavarësia e BE-së;
- përforcimi i sigurisë së BE-së dhe i Shteteve të veta Anëtare;
- sigurimi i paqes botërore dhe përmirësimi i sigurisë ndërkombëtare;
- promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar;
- promovimi i demokracisë dhe sundimi i ligjit, si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
- themelimi i mbrojtjes së përbashkët.

Pasi që BE-ja nuk është shtet individual, këto detyra mund të realizohen vetëm gradualisht. Tradicionalisht, politika e punëve të jashtme, sidomos ajo e sigurisë, janë fusha ku Shtetet Anëtare dëshirojnë të ruajnë sovranitetin e tyre (nacional). Një arsye tjetër për vështirësinë e definimit të interesave të përbashkëta në këtë fushë, është se vetëm Franca dhe Britania e Madhe kanë armë nukleare. Problem tjetër është se disa Shtete Anëtare nuk janë anëtare në NATO ose në WEU. Numri më i madh i vendimeve mbi 'politikën e punëve të jashtme dhe sigurisë' akoma merren në bazë të bashkëpunimit midis shteteve. Ndërkohë, janë shfaqur një varg mjetesh, të cilat e bëjnë bashkëpunimin midis shteteve një kornizë të fuqishme ligjore.

Në fushën e bashkëpunimit gjyqësor lidhur me veprat penale, roli kryesor i BE-së është të zbatojë detyra që janë në interes të Evropës si tërësi. Këto përfshijnë, në veçanti luftën kundër krimit të organizuar, parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe ndjekjen e veprave penale. Pasi që krimi i organizuar nuk mund të luftohet në mënyrë efektive në nivel nacional, është i nevojshëm një reagim i përbashkët në nivel të BE-së. Dy hapa shumë pozitive janë ndërmarrë me direktivën mbi larjen e parave dhe krijimin e autoritetit policor evropian, Europol, i cili ka filluar të funksionojë nga viti 1998 (Neni 88 TFEU). Ky bashkëpunim përfshin lehtësimin dhe përs-

pejtimin e bashkëpunimit lidhur me proceset gjyqësore dhe hyrjen në fuqi të vendimeve, lehtësimin e ekstradimit midis Shteteve Anëtare, themelimin e rregullave minimale që kanë të bëjnë me elementet përbërëse të akteve penale dhe dënimeve në fushat e krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe eksploatimin seksual të femrave dhe fëmijëve, trafikimin e materieve ilegale narkotike dhe trafikimin ilegal të armëve, larjen e parave dhe korrupsionin (Neni 83 TFEU). Një nga përparësitë më të rëndësishme në bashkëpunimin gjyqësor të BE-së ishte themelimi i Euroxhast-it në prill 2003 (Neni 85 TFEU). Me seli në Hag, Euroxhasti është një ekip i gjykatësve dhe prokurorëve nga të gjitha vendet e BE-së. Detyra e tij është të ndihmojë koordinimin e hetimeve dhe ndjekjen penale të krimeve serioze jashtë kufijve. Nga Euroxhasti, Këshilli mund të formojë Zyrën Evropiane të Prokurorit Publik, për të luftuar krimet që prekin interesat financiare të Unionit (Neni 86 TFEU). Është arritur progres edhe me fletë-arrestin evropian, i cili vlen në mbarë BE-në prej muajit janar 2004. Urdhëri mund të jepet për këdo që akuzohet për kundërvajtje, për të cilën dënimi më i vogël është një vjet burgim. Fletë-arresti evropian është formuluar për të zëvendësuar procedurat e gjata të ekstradimit.

## FUQITË E BE-SË

Traktatatet themeluese të BE-së nuk transferojnë asnjë fuqi të përgjithshme në Union, për të marrë të gjitha masat e nevojshme në arritjen e objektivave të Traktatit, por në çdo kapitull përcaktojnë shtrirjen e fuqive të veprimit. Si parim themelor BE-ja dhe institucionet e veta nuk kanë fuqinë për të vendosur lidhur me bazën dhe kompetencat e tyre ligjore; parimi i transferimit specifik të fuqive (Neni 2 TFEU) vazhdon të vlejë akoma. Këtë metodë e kanë zgjedhur Shtetet Anëtare, për të siguruar se dorëzimi i fuqive të veta mund të mbikqyret dhe kontrollohet më lehtë.

Gama e çështjeve që përfshihen në transferimin specifik të fuqive dallon varësisht nga natyra e detyrave të caktuara për BE-në. Kompetencat që nuk i janë transferuar BE-së, mbeten në fuqinë ekskluzive të Shteteve Anëtare. Traktati i BE-së në mënyrë eksplicite thekson se çështjet e sigurisë nacionale mbeten në autoritetin ekskluziv të Shteteve Anëtare.

Kështu vetvetiu konfirmohet ajo që është vërtetuar më parë se ku qëndron linja ndarëse midis kompetencave të BE-së dhe atyre të Shteteve Anëtare. Kjo linjë ndarëse tërhiqet në bazë të tre kategorive të kompetencës:

- kompetenca ekskluzive e BE-së (Neni 3 TFEU) në fushat ku mund të supozohet se një masë në nivel të BE-së do të jetë më efektive se një masë e pakoordinuar në cilindo Shtet Anëtar. Këto fusha janë të parapara dhe përbëjnë unionin doganor, formulimi i rregullave të nevojshme të konkurrencës për funksionimin e tregut të brendshëm, politika monetare e Shteteve me valutën euro, politika e përbashkët komerciale dhe pjesë të politikës së përbashkët të peshkimit. Në këto fusha të politikës, vetëm Bashkimi Evropian mund të nxjerrë ligje dhe të miratojë akte detyruese me ligj, kurse Shtetet Anëtare mund ta bëjnë këtë vetëm nëse i autorizon Bashkimi Evropian ose për implementimin e akteve të Unionit (Neni 2(1) TFEU);
- kompetenca e përbashkët e BE-së dhe Shteteve Anëtare (Neni 4 TFEU) në fushat ku veprimi në nivel evropian do të shtojë vlerën e veprimeve të Shteteve anëtare. Ekziston kompetencë e përbashkët për rregullat e brendshme të tregut, kohezioni ekonomik, social dhe territorial, bujqësia dhe peshkataria, ambienti jetësor, transporti, rrjetet jashtë Evropës, furnizimi me energji elektrike dhe fusha e lirisë, sigurisë dhe gjyqësisë, si dhe për sigurimin në çështjet e shëndetësisë publike, hulumtimi dhe zhvillimi teknologjik, hapësira, bashkëpunimi në zhvillim dhe ndihma humanitare. Në të gjitha këto fusha, Unioni është i pari që mund të ushtrojë kompetencën mirëpo vetëm lidhur me çështjet e parapara në instrumentin relevant të Unionit, dhe jo në tërë fushën e politikës së caktuar. Shtetet Anëtare ushtrojnë kompetencën e tyre në shkallën ku BE-ja nuk e ka ushtruar ose ka vendosur të pushojë së ushtruar kompetencën e vet (Neni 2(2) TFEU). Situata e fundit shfaqet kur institucionet relevante të BE-së vendosin të shfuqizojnë një akt legjislativ, sidomos për të respektuar parimet e subvencionimit dhe proporcionalitetit. Në iniciativë të një ose më tepër anëtareve, Këshilli mund të kërkojë nga Komisioni të dorëzojë propozime për shfuqizimin e një akti legjislativ;
- kompetenca për realizimin e aktivitetit mbështetës (Neni 6 TFEU). Kompetenca e BE-së për realizimin e aktivitetit mbështetës është e kufizuar në koordinimin ose sigurimin e aktiviteteve plotësuese për veprimet e Shteteve Anëtare; BE-ja nuk mund të harmonizojë ligjin nacional në fushat në fjalë (Neni 2(5) TFEU). Përgjegjësia për hartimin e legjislativës vazhdon t'u mbetet Shteteve Anëtare, të cilat në këtë mënyrë kanë liri të madhe të veprimit. Fushat e përfshira në këtë kategori të kom-



petencës janë mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit njerëzor, industria, kultura, turizmi, arsimi, rinia, sporti dhe trajnimi profesional, mbrojtja civile dhe bashkëpunimi administrativ. Në fushën e punësimit dhe politikës ekonomike, Shtetet Anëtare pranojnë në mënyrë eksplicite nevojën për të koordinuar masat nacionale përbrenda BE-së.

Duhet theksuar se kompetencat e BE-së në fushën e koordinimit të politikës ekonomike dhe asaj të punësimit dhe politikën e punëve të jashtme dhe sigurisë nuk klasifikohen në asnjë nga këto tre kategori dhe prandaj nuk i përkasin këtij korpusi kompetencash. Megjithatë, është një deklaratë që thotë se politika e përbashkët e BE-së për punë të jashtme dhe siguri nuk do të ndikojë në kompetencat e Shteteve Anëtare në politikën e tyre të punëve të jashtme dhe qëndrimin e tyre në skenën botërore. Përveç këtyre fuqive speciale të veprimit, Traktatet e Unionit gjithashtu u transferojnë institucioneve fuqinë e veprimit kur ajo është e nevojshme për funksionimin e tregut të vetëm ose për të garantuar konkurrencën e patrazuar (shih Neni 352 TFEU — fuqitë dispozitive ose klauzola e fleksibilitetit). Këto nene nuk u transferojnë institucioneve asnjë fuqi të përgjithshme që u mundëson të realizojnë detyra që janë jashtë objektivave të parapara në Traktate, kurse institucionet e Unionit nuk mund t'i ofrojnë fuqitë e tyre në dëm të fuqive të Shteteve Anëtare. Në përvojë, mundësitë e ofruara nga kjo fuqi janë shfrytëzuar shumë në të kaluarën, pasi që BE-ja shpesh herë është përballur me detyra të reja që nuk ishin paraparë në kohën e krijimit të Traktateve dhe për të cilat nuk u janë transferuar fuqitë e duhura. Shembuj për këtë janë mbrojtja e ambientit jetësor dhe konsumatorëve ose themelimi i Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal si mjet për mbylljen e zbrazëtirës midis rajoneve të zhvilluara dhe të prapambetura të BE-së. Mirëpo tani, për fushat e lartëshënuara është dhënë pushtet specifik. Këto dispozita të veçanta nënkuptojnë se rëndësia praktike e fuqive dispozitive ka pësuar rënie të madhe.

Ushtrimi i këtyre fuqive ka nevojë për miratimin e Parlamentit Evropian. Së fundi, ka edhe fuqi të tjera që do të marrin masa të tilla që janë shumë të nevojshme për implementimin efektiv dhe kuptimplotë të fuqive që tani më shprehimisht janë transferuar (fuqitë e nënkuptuara). Këto fuqi kanë marrë rëndësi të veçantë në administrimin e marrëdhënieve të jashtme. Ato i mundësojnë BE-së të marrë përsipër obligimet ndaj vendeve që nuk janë anëtare ose ndaj organizatave të tjera ndërkombëtare në fushat e përfshira në listën e detyrave që i janë besuar BE-së. Shembull i spikatur është rasti Kramer në Gjykatën e të Drejtës. Ky rast kishte të bënte me kapacitetin e BE-së për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare lidhur me fiksimin e kuotave të peshkimit, aty ku është e përshtatshme, për marrjen e obligimeve mbi çështjen në suaza të

ligjit ndërkombëtar. Pasi që nuk ka dispozitë specifike të paraparë në Traktat, Gjykata konkludoi kompetencën e jashtme, të domosdoshme për BE-në, nga kompetenca e brendshme për politikën e peshkimit, nën politikën e përbashkët bujqësore.

Mirëpo, duke ushtruar këto fuqi, BE-ja udhëhiqet nga parimi i subvencionimit, i përvetësuar nga doktrina sociale katolike, i cili, në të vërtetë ka fituar statusin kushtetues, duke qënë i mishëruar në traktatin e BE-së (Neni 5(3)). Këtu ka dy aspekte: formulimi pozitiv se BE-ja duhet të veprojë aty ku synimet mund të realizohen më mirë në nivel të Unionit, gjë që rrit fuqitë e tij; dhe formulimi negativ se nuk guxon të veprojë aty ku objektivat mund të përmbushen në nivel të kënaqshëm nga veprimi individual i Shteteve Anëtare. Në praksë, kjo do të thotë se të gjitha institucionet e Unionit, por sidomos Komisioni, duhet gjithnjë të demonstrojnë se ka nevojë reale për rregulla dhe veprime të përbashkëta. Nëse parafrazojmë Monteskenë – kur nuk është e nevojshme që BE-ja të ndër marrë hapa, është e domosdoshme që të mos ndër marrë asnjë hap. Nëse demonstron nevoja për rregullat e Unionit, atëherë pyetja e ardhshme ka të bëjë me intensitetin dhe formën që këto rregulla duhet të marrin. Përgjigja rrjedh nga parimi i proporcionalitetit, i cili ka hyrë në të drejtën e Unionit përmes vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, dhe është ndërthurrur në Traktatin e BE-së së bashku me dispozitat e kompetencës (Neni 5(4)). Kjo nënkupton vlerësimin e kujdesshëm të nevojës për instrument specifik ligjor, që të shihet nëse ekzistojnë masa më pak të sforcuara për arritjen e rezultatit të njëjtë. Konkluzat kryesore që duhet arritur në kushte të përgjithshme është se legjislacioni kornizë, standardet minimale dhe njohja reciproke e standardeve ekzistuese të Shteteve Anëtare duhet të parapëlqehet më shumë se sa dispozitat ligjore të detajuara jashtë mase.

Parlamentet nacionale tani mund të kontrollojnë edhe përputhjen me parimet e subvencionimit dhe proporcionalitetit. Për këtë arsye, është futur një sistem i njoftimit të hershëm, i cili u lejon parlamenteve nacionale të japin qëndrim të argumentuar, tetë javë pas transmetimit të propozimit legjislativ, ku do të qartësojnë pse propozimi legjislativ në fjalë, nuk plotëson kërkesat e subvencionimit dhe proporcionalitetit. Nëse ky qëndrim i arsyetuar mbështetet nga, së paku, një e treta e votave të parlamenteve nacionale (ku çdo parlament nacional ka dy vota, ose, në rastet e sistemeve me Dhoma, një votë për Dhomë), propozimi legjislativ duhet rishikuar nga institucioni që e ka dhënë atë (zakonisht Komisioni). Pas këtij rishikimi, propozimi mund të ruhet, të ndryshohet ose të tërhiqet. Nëse Komisioni Evropian vendos të ruajë propozimin fillestar,

atëherë duhet të japë opinion të argumentuar, ku do të theksojë se pse mendon që propozimi duhet të respektojë parimin e subvencionimit. Ky opinion i argumentuar i dërgohet legjislatorit të BE-së me opinionet e argumentuara të parlamenteve nacionale, në mënyrë që të merren parasysh në procedurën legjislative. Nëse, me mazhorancë 55% të Anëtarëve të Këshillit të BE-së ose me mazhorancën e votave në Parlamentin Evropian, legjislatori i BE-së mendon se opinionin nuk është në pajtim me parimin e subvencionimit, propozimi legjislativ nuk shqyrtohet më tej.

## INSTITUCIONET E BE-SË

### *Neni 13 i TEU (korniza institucionale)*

1. Unioni duhet të ketë një kornizë institucionale, e cila do të ketë për qëllim të promovojë vlerat e veta, të përparojë objektivat e veta, t'u shërbejë interesave të veta, t'u shërbejë interesave të qytetarëve të vet dhe atyre të Shteteve Anëtare, të garantojë lidhje logjike, efektshmëri dhe vazhdimësi të politikave dhe veprimeve të veta.

Institucionet e BE-së do të jenë:

- Parlamenti Evropian,
- Këshilli Evropian,
- Këshilli,
- Komisioni Evropian (më poshtë në këtë dokument, i referuar si 'Komisioni'),
- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian,
- Banka Qendrore Evropiane,
- Gjykata e Revizorëve.

2. Çdo institucion do të veprojë përbrenda kufijve të fuqive të fituara sipas Traktateve dhe në pajtim me procedurat, kushtet dhe synimet e përcaktuara përbrenda tyre. Institucionet do të ushtrjnë bashkëpunim të sinqertë reciprok.

3. Dispozitat që kanë të bëjnë me Bankën Qendrore Evropiane dhe Gjykatën e Revizorëve, si dhe dispozitat e detajuara mbi institucionet e tjera, janë përcaktuar në Traktatin e Funkcionimit të Bashkimit Evropian.

4. Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni do të kenë mbështetjen e Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, të cilat do të veprojnë në kapacitet këshilldhënës.

PASQYRË E INSTITUCIONEVE TË BE-së, SIPAS TFEU-së



<sup>(2)</sup> Kur Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009, numri i Anëtarëve u shtua përkohësisht në 754. Mirëpo, deri në zgjedhjet e ardhshme në 2014 duhet të mbahet numri maksimal 751.

SHTETET ANËTARE	VOTAT NË KËSHILL	ULËSET NË PARLAMENTIN EVROPIAN
GJERMANIA	29	99
FRANCA	29	78
ITALIA	29	78
BRITANIA E MADHE	29	78
SPANJA	27	54
POLONIA	27	54
RUMANIA	14	35
HOLLANDA	13	27
BELGIKA	12	24
REPUBLIKA ÇEKE	12	24
GREQIA	12	24
HUNGARIA	12	24
PORTUGALIA	12	24
SUEDIA	10	19
BULLGARIA	10	18
AUSTRIA	10	18
DANIMARKA	7	14
SLLOVAKIA	7	14
FINLANDA	7	14
IRLANDA	7	13
LITUANIA	7	13
LETONIA	4	9
SLLOVENIA	4	7
ESTONIA	4	6
QIPROJA	4	6
LUKSEMBURGU	4	6
MALTA	3	5

Çështje tjetër që del lidhur me kushtetutën e Bashkimit Evropian është ajo e organizimit të tij. Cilat janë institucionet e Unionit? Pasi që BE-ja ushtron funksione që zakonisht janë të rezervuara për Shtetet Anëtare – a ka qeveri, parlament, autoritete administrative dhe gjykata siç i njohim në Shtetet Anëtare? Aktivitetet lidhur me detyrat e caktuara për BE-në dhe orientimi i procesit integruar, me qëllim nuk u është lënë Shteteve Anëtare ose bashkëpunimit ndërkombëtar. BE-ja ka një sistem institucional që pajis atë

për të ofruar motivacione të reja dhe objektiva për unifikimin e Evropës, si dhe për të krijuar ligjin, i cili është i pajisur dhe njëtrajtshëm detyrues në të gjitha Shtetet Anëtare, lidhur me çështjet që janë përgjegjësi e vet.

Aktorët kryesorë në sistemin institucional të BE-së janë institucionet e BE-së — Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, Këshilli, Komisioni Evropian, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe Gjykata e Revizorëve. Organet ndihmëse të sistemit institucional të BE-së janë Banka Evropiane e Investimeve, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve.

## INSTITUCIONET

### *Parlamenti Evropian (Neni 14 TEU)*

Parlamenti Evropian përfaqëson popujt e Shteteve Anëtare të BE-së. Ai paraqet shkrirjen e Asamblesë së Përbashkët të Komunitetit Evropian për Thëngjill dhe Çelik, Asamblesë së Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Asamblesë Euratom, të cilat u kombinuan për të formuar një ‘asamble’ nën Konventën e vitit 1957 lidhur me Institucionet e Sigurta dhe të Përbashkëta për Komunitetet Evropiane (‘Traktati i parë bashkues’). Emri nuk u ndryshua zyrtarisht në ‘Parlament Evropian’ deri në momentin kur Traktatin e Komunitetit Evropian e zëvendësoi Traktati për Bashkimin Evropian, edhe pse ky hap vetëm reflektonte atë që ishte në përdorim të përbashkët deri në ndryshimin e emrit të Asamblesë në ‘Parlament Evropian’ në vitin 1958.

### **Përbërja dhe zgjedhja**

Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, më 1 dhjetor 2009, Parlamenti Evropian ka pasur 754 ulëse. Ky numër tejkalon maksimumin e 751 Anëtarëve të paraparë në TEU (Neni 14(2)), mirëpo duhet pranuar për periudhën legjislative 2009–14, pasi që Deputetët e Parlamentit Evropian të zgjedhur në qershor nuk mund të humbin ulëset e tyre. Mirëpo, numri maksimal i Deputetëve duhet të respektohet në zgjedhjet e ardhshme në vitin 2014. Edhe pse çdo Deputet i ndonjë Shteti Anëtar të populluar shumë përfaqëson më tepër qytetarë se çdo Deputet i një Shteti me popullatë më të vogël, këto ulëse u ndahen Shteteve Anëtare në mënyrë që asnjë Shtet me numër më të vogël të popullatës të mos ketë më tepër ulëse se një Shtet i populluar më shumë. Zakonisht, numri minimal i ulëseve për Shtet Anëtar

është gjashtë, kurse ai maksimal 96, mirëpo, për shkak të hyrjes së vonshme në fuqi të Traktatit të Lisbonës, është bërë përjashtim për Gjermaninë për periudhën legjislativë 2009–14, duke i lejuar të vazhdojë të ketë 99 Deputetë (Deputetët e Parlamentit Evropian të zgjedhur në qershor 2009 nuk mund të humbin ulëset e tyre për shkak të hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës).

Përbërja e saktë ende nuk është vendosur nga Këshilli. Kjo duhet të jetë bërë në kohë për zgjedhjet direkte të Parlamentit Evropian, në qershor 2009. Megjithatë, pasi që Traktati i Lisbonës nuk hyri në fuqi para zgjedhjeve të qershorit 2009, rregullat e reja mbi përbërjen e Parlamentit Evropian nuk mundën të zbatohen për periudhën legjislativë 2009–14. Në vend të kësaj, shpërndarja e ulëseve që rezultoi pas anëtarësimit të Bullgarisë dhe Rumanisë vlente për këto zgjedhje të Parlamentit Evropian. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, më 1 dhjetor 2009, numri i Anëtarëve u shtua nga 18 në 754, me Deputetët e rinj nga 12 Shtete Anëtare.

Përbërja e Parlamentit Evropian pasqyrohet më poshtë në tabelë grafike; kjo është situata për periudhën aktuale legjislativë 2009–14. Janë shfaqur ndryshimet e shkaktuara nga Traktati i Lisbonës.

#### PRESIDENTI

14 Zëvendës Presidentë

5 Kuestorë (këshillimorë)

Presidenti, Zëvendës Presidentët dhe Kuestorët e përbëjnë Byronë, të cilën e zgjedh Parlamenti me mandat dy vjet e gjysmë. Një organ tjetër, Konferenca e Presidentëve, gjithashtu përfshin kryesuesit e grupeve politike. Ky organ mban përgjegjësinë e organizimit të punës së Parlamentit dhe marrëdhënie me institucionet e tjera të BE-së dhe me institucionet që nuk i përkasin Bashkimit Evropian.

## SEANCA PLENARE E PARLAMENTIT ME 754 ANËTARË

ULËSET E SHTETEVE	ANËTARE NË PARLAMENTIN EVROPIAN
GJERMANIA	99
FRANCA	72+2
ITALIA	72+1
BRITANIA E MADHE	72+1
SPANJA	50+4
POLONIA	50+1
RUMANIA	33
HOLLANDA	25+1
BELGIKA	22
REPUBLIKA ÇEKE	22
GREQIA	22
HUNGARIA	22
PORTUGALIA	22
SUEDIA	18+2
BULLGARIA	17+1
AUSTRIA	17+2
DANIMARKA	13
SLLOVAKIA	13
FINLANDA	13
IRLANDA	12
LITUANIA	12
LETONIA	8+1
SLLOVENIA	7+1
ESTONIA	6
QIPROJA	6
LUKSEMBURGU	6
MALTA	5+1

Deri në vitin 1979, përfaqësuesit e Parlamentit Evropian zgjidheshin nga anëtarësia e parlamenteve nacionale, të cilat edhe i delegonin ata në Parlamentin Evropian. Zgjedhjet e përgjithshme direkte të Deputetëve të Parlamentit Evropian nga popujt e Shteteve Anëtare, ishin të parapara në vet Traktatet por zgjedhjet e para direkte nuk u mbajtën deri në qershor 1979, pas një numri të iniciativave të pafrytshme paraprake. Zgjedhjet tani mbahen çdo vjet, gjë që korrespondon me kohëzgjatjen e 'periudhës legjislative'. Pas përpjekjeve shumë dekadëshe, më në fund u fut një procedurë elektorale e njëtrajtshme me ak-



tin mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të Parlamentit Evropian me votim direkt universal më 20 shtator 1976, siç u ndryshua herën e fundit me vendimin e Këshillit më 25 qershor dhe 23 shtator 2002 (i njohur si Akti për Zgjedhje Direkte). Me këtë akt, çdo Shtet Anëtar përcakton procedurën e vet të zgjedhjeve, por duhet të zbatojë rregullat e njëjta të demokracisë elementare: zgjedhjet e përgjithshme direkte, përfaqësimi proporcional, votime të lira dhe të fshehta, mosha minimale, (për të drejtë vote, mosha është 18 vjeç në të gjitha Shtetet Anëtare përveç në Austri, ku kjo moshë është ulur në 16), mandati pesëvjeçar me mundësi përtëritjeje, mospërputhshmëria (deputetët nuk mund të kenë dy mandate në të njëjtën kohë, p.sh. mandatin e gjykatësit, prokurorit publik, Ministrit; ata u nënshtrohen edhe ligjeve të shteteve të veta, të cilat mund të kufizojnë mundësinë për mbajtjen e me tepër posteve ose mandateve), data e zgjedhjeve dhe barazia midis meshkujve dhe femrave. Në disa shtete (Belgjikë, Greqi dhe Luksemburg), votimi është i obligueshëm. Veç kësaj, statuti për Deputetët e Parlamentit Evropian hyri në fuqi më 14 korrik 2009. Në statutin e ri, kushtet e punës së deputetëve bëhen më transparente dhe rregullat janë më të qarta. Statuti gjithashtu parashikon rrogën e njëtrajshme për të gjithë Deputetët e Parlamentit, të cilat pagohen nga buxheti i BE-së.

Tani, i zgjedhur në mënyrë direkte, Parlamenti gëzon legjitimitetin demokratik dhe mund të deklarojë sinqerisht se i përfaqëson qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së. Mirëpo, vet ekzistimi i Parlamentit të zgjedhur në mënyrë direkte nuk mund të kënaqë kërkesën fundamentale të një kushtetute demokratike, e ajo është se të gjitha autoritetet publike duhet të dalin nga populli. Kjo nuk nënkupton vetëm nevojën për transparencë të procesit të vendim-marrjes dhe përfaqësimin e institucioneve vendim-marrëse; por është i nevojshëm kontrolli parlamentar dhe Parlamenti duhet t'u ofrojë legjitimitetin institucioneve të Unionit të inkuadruara në procesin e vendim-marrjes. Në këtë fushë është arritur progres i madh gjatë viteve të fundit – të drejtat e Parlamentit janë shtuar vazhdimisht dhe Traktati i Lisbonës ka themeluar në mënyrë eksplicite obligimin që aktivitetet e BE-së t'i përmbahen parimit të demokracisë përfaqësuese. Si rezultat i kësaj, të gjithë qytetarët e Unionit janë të përfaqësuar drejtpërsëdrejti në Parlament dhe kanë të drejtë të marrin pjesë aktive në jetën demokratike të BE-së. Objektiva kryesore e kësaj është se vendimet në nivel të BE-së merren sa më hapur dhe sa më afër qytetarëve. Partitë politike në nivel të BE-së duhet të kontribuojnë në formësimin e identitetit evropian dhe të artikulojnë vullnetin e qytetarëve. Nëse ka ndonjë mangësi në modelin ekzistues demokratik të BE-së, është se Parlamenti Evropian, për dallim nga parlamentet e vërteta në demokraci parlamentare, nuk zgjedh qeverinë e cila i përgjigjet atij.

### *Neni 10 i TEU (demokracia përfaqësuese)*

1. Funksionimi i Unionit do të themelohet në demokracinë përfaqësuese.
2. Qytetarët janë të përfaqësuar drejtpërsëdrejti në nivel të Unionit, në Parlamentin Evropian.

Shtetet Anëtare përfaqësohen në Këshillin Evropian nga Shefat e Shteteve ose Qeverive dhe në Këshill nga qeveritë e tyre, të cilat mbajnë përgjegjësinë demokratike ndaj parlamenteve të tyre nacionale ose qytetarëve të vet.

3. Çdo qytetar do të ketë të drejtën të marrë pjesë në jetën demokratike të Unionit. Vendimet do të merren në mënyrë sa më transparente për qytetarët.

4. Partitë politike në nivel evropian kontribuojnë në formimin e vetëdijes politike evropiane dhe për të shprehur vullnetin e qytetarëve të Unionit.

Megjithatë, arsyeja për këtë mangësi është shumë e thjeshtë – asnjë qeveri në kuptimin normal nuk ekziston në nivel të BE-së. Në vend të kësaj, funksionet analoge për qeverinë të cilat janë të parapara në Traktatet e Unionit i realizon Këshilli dhe Komisioni Evropian, sipas një forme të ndarjes së punës. Megjithatë, Traktati i Lisbonës i dha Parlamentit fuqi gjithëpërfshirëse lidhur me emërimet për Komisionin, duke filluar me zgjedhjen e Presidentit të Komisionit nga Parlamenti, lidhur me rekomandimin e Këshillit Evropian, e deri te vota miratuese e Parlamentit për kolexhin e plotë të Komisionarëve ('e drejta e emërimit'). Mirëpo, Parlamenti nuk ka ndikim të tillë mbi anëtarësinë e Këshillit, i cili i nënshtrohet kontrollit parlamentar vetëm nëse secili nga anëtarët e tij, si Ministër nacional, i raporton parlamentit nacional.

Roli i Parlamentit Evropian në procesin legjislativ të BE-së është shtuar dukshëm. Ngritja e procedurës së bashkë-vendosjes në nivel të procedurës së rregullt legjislative, në fakt, ka bërë Parlamentin Evropian 'ko-legjislator' së bashku me Këshillin.

Në procedurën e rregullt legjislative, Parlamenti jo vetëm që mund të propozojë ndryshime të legjislacionit gjatë leximeve të ndryshme, por gjithashtu, në masë të caktuar, mund të marrë miratimin e Këshillit për këto ndryshime. Legjislacioni i Unionit nuk mund të miratohet pa marrëveshje midis Këshillit dhe Parlamentit Evropian.

Tradicionalisht, Parlamenti ka luajtur rol të madh në procedurën buxhetore. Traktati i Lisbonës i ka zgjeruar fuqitë buxhetore të Parlamentit Evropian, ku specifikon se Parlamenti duhet të miratojë planin shumë vjetor financiar

dhe i jep fuqi bashkë-vendosjeje për të gjitha shpenzimet (shpenzimet e domosdoshme dhe jo të domosdoshme nuk dallojnë më nga njëra tjetra).

Parlamenti ka të drejtë të pajtohet me të gjitha marrëveshjet kryesore ndërkombëtare në fusha që përfshihen me bashkë-vendosjen, dhe me Traktatet e Anëtarësimit të nënshkruara me Shtetet Anëtare, ku përcaktohen kushtet e pranimit.

Me kalimin e kohës, edhe fuqitë mbikqyrëse të Parlamentit Evropian janë shtuar shumë. Ato ushtrohen kryesisht nga fakti se Komisioni duhet t'i raportojë Parlamentit, të mbrojë propozimet e veta para tij dhe t'i prezantojë raportin vjetor lidhur me aktivitetet e BE-së, për debatim. Me dy të tretat e mazhorancës së deputetëve, Parlamenti mund të kalojë një mocion kundërshtimi dhe në këtë mënyrë të detyrojë Komisionin të japë dorëheqje si organ (Neni 234 TFEU). Disa mocione të tilla i janë dorëzuar Parlamentit por asnjë nga ato deri më tani nuk ka arritur të marrë mazhorancën e nevojshme. Dorëheqja Komisionit Santer në vitin 1999 u nxit nga refuzimi i Parlamentit të shkarkojë atë lidhur me menaxhimin financiar; mocioni i kundërshtimit nuk ishte i suksesshëm, edhe pse për një diferencë të vogël. Pasi që në praktikë Këshilli gjithashtu përgjigjet në pyetjet parlamentare, Parlamenti ka mundësinë e debatit të drejtpërdrejtë publik me dy institucione kryesore. Prej atëherë, këto fuqi mbikqyrëse të Parlamentit janë shtuar. Tani ai është i autorizuar edhe për themelimin e Komiteteve speciale të Hetimit për të hetuar rastet e dyshuara të shkeljes së ligjit të Komunitetit ose administrimit joefikas. Komiteti i këtillë u shfrytëzua, për shembull, për të hetuar përgjegjësinë e Komisionit për vonesën e reagimit lidhur me 'sëmundjen e lopëve të çmendura' në Britani të Madhe, gjë që përfaqësonte kërcnim për jetën dhe shëndetin e njeriut. Në këto Traktate është e shkruar edhe e drejta e çdo personi fizik apo juridik t'i dorëzojë peticion Parlamentit, të cilat pastaj i trajton Komiteti i Peticioneve. Së fundi, Parlamenti ka shfrytëzuar fuqinë e vet për emërimin e Ombudsmanit, të cilit mund t'i drejtohen ankesat lidhur me keqadministrimin e aktiviteteve të institucioneve të Unionit, me përjashtim të Gjykatës të Drejtësisë. Ombudsmani mund të bëjë hetime dhe duhet të informojë institucionin ose organin e caktuar, lidhur me veprimin e këtillë dhe duhet t'i dorëzojë Parlamentit një raport lidhur me rezultatet e hetimeve të tij apo të saj.


### **Procedurat e punës**

Rregullat elementare që qeverisin punimet e Parlamentit përcaktohen në rregulloren e tij.

Deputetët e Parlamentit Evropian formojnë grupe politike. Duke marrë parasysh statusin e Parlamentit si një institucion të BE-së, këto janë grupime të partive politike në mbarë Unionin, të cilat tejkalojnë linjat nacionale.

Parlamenti mban seancat e veta plenare një javëshe, një herë në muaj në Strazburg, përveç në gusht. Mund të mbahen edhe seanca plotësuese, sidomos në lidhje me buxhetin. Seancat e shkurta (që zgjasin një ose dy ditë) mbahen në Bruksel. Së fundi, seancat urgjente mund të thirren për të trajtuar çështjet e mëdha, dhe kështu i mundësojnë Parlamentit të strukturojë qëndrimin e vet pa vonesë, lidhur me çështje të rëndësishme (siç janë çështjet e Unionit, çështjet ndërkombëtare, shkelja e të drejtave të njeriut). Të gjitha seancat plenare janë të hapura për publikun.

**GRUPET POLITIKE NË PARLIAMENTIN EVROPIAN <sup>(3)</sup>**



<sup>(3)</sup> 18 deputetët plotësues të Parlamentit të PE-së u shpërndanë në grupe politike pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës; nominimet për shtatë deputetë nga Franca, Italia, Polonia dhe Britania e Madhe nuk janë bërë akoma.

## Procedurat e vendim-marrjes

Mazhoranca absolute e votave është zakonisht e mjaftueshme për marrjen e një vendimi. Mirëpo, me rritjen e rëndësisë së Parlamentit, kërkesat për prezencën e Deputetëve të Parlamentit janë më të rrepta se kurrë më parë. Një varg i tërë i vendimeve mund të miratohet vetëm nëse përkrahet nga mazhoranca absolute e të gjithë Deputetëve të Parlamentit. Së fundi, çdo mocion kundërshtimi kundër Komisionit Evropian jo vetëm që duhet mbështetur nga mazhoranca e deputetëve por gjithashtu duhet të ketë dy të tretën e votave në favor.

### KOMITETET PERMANENTE TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Komiteti i Punëve të Jashtme (me nënkomitetet për 'Të Drejta të Njeriut' dhe 'Siguri dhe Mbrojtje')

Komiteti për Zhvillim

Komiteti për Tregti Ndërkombëtare

Komiteti i Buxhetit

Komiteti për Kontroll Buxhetor

Komiteti për Çështje Ekonomike dhe Monetare

Komiteti për Punësim dhe Çështje Sociale

Komiteti për Ambientin Jetësor, Shëndetësinë Publike, dhe Sigurinë e Ushqimit

Komiteti për Industri, Hulumtim dhe Energji

Komiteti për Tregun e Brendshëm dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve

Komiteti për Transport dhe Turizëm

Komiteti për Zhvillim Rajonal

Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Komiteti për Peshkatori

Komiteti për Kulturë dhe Arsim

Komiteti për Çështje Juridike

Komiteti për Liritë Qytetare, Drejtësi dhe Punë të Brendshme

Komiteti për Çështje Kushtetuese

Komiteti për Të Drejtat e Femrave dhe Barazi Gjinore

Komiteti i Peticionit

## Selia

Këshilli Evropian vendosi që selia e Parlamentit të jetë në Strazburg dhe kështu mbylli statusin e përkohshëm të një marrëveshjeje që funksiononte

30 vjet. Ishte bërë përvojë e rregullt që seancat plenare të mbahen në Strazburg dhe Bruksel, takimet e grupeve politike dhe komiteteve të mbahen në Bruksel gjatë javëve kur Parlamenti nuk kishte seanca, kurse Sekretariati Gjeneral të ketë selinë në Luksemburg. Vendimi i Këshillit lidhur me vendet e selive të institucioneve, konfirmoi vlefshmërinë e këtyre aranzhimeve, me kusht që 12 periudhat e seancave mujore plenare të mbahen në Strazburg. Rezultati i pakënaqshëm i këtij vendimi është se Deputetët e Parlamentit Evropian dhe zyrtarë të Parlamentit duhet të udhëtojnë rregullisht midis Strazburgut, Brukselit dhe Luksemburgut — gjë që kushton shumë.

### ***Këshilli Evropian (Neni 15 TEU)***

Këshilli Evropian u krijua nga konferencat e samiteve të Shefave të Shteteve ose Qeverive të BE-së. Në Samitin e Parisit, në dhjetor 1974, u vendos që mbledhjet të mbahen tre herë në vjet dhe të cilësohen si Këshill Evropian. Prej atëherë, Këshilli Evropian është trup i pavarur i Bashkimit Evropian (Neni 13 TEU).


Shefat e Shteteve ose Qeverive dhe Presidenti i Komisionit Evropian takohen së paku dy herë në gjashtë muaj. Në rastet kur është e nevojshme për çështjet në diskutim e sipër, Anëtarët e Këshillit Evropian mund të vendosin të kërkojnë ndihmën e një Ministri kurse në rast të Presidentit të Komisionit, mund të kërkojnë ndihmën e një Anëtari të Komisionit Evropian t'u ndihmojë në punën e tyre (Neni 15(3) TEU).

Traktati i Lisbonës krijoi zyrën e Presidentit të Këshillit Evropian <sup>(4)</sup>. Presidenti i Këshillit Evropian, për dallim nga Presidenca e deritanishme, ka mandat evropian, e jo nacional, i cili zgjat dy vjet e gjysmë me orar të plotë. Personi i emëruar për President duhet të jetë një personalitet i jashtëzakonshëm, i zgjedhur nga votimi i mazhorancës së kualifikuar i Anëtarëve të Këshillit Evropian. Rizgjedhja është e mundur vetëm një herë. Detyrat e Presidentit përbëhen nga përgatitja dhe zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Evropian dhe përfaqësimi i BE-së në samitet ndërkombëtare, në fushën e punëve të jashtme dhe sigurisë.

<sup>(4)</sup> Herman van Romuij, atëbotë Kryeministër i Belgjikës, u nominua President i parë i Këshillit Evropian dhe filloi punën më 1 dhjetor 2009.

Funksionimi ekzistues i Këshillit Evropian është të formulojë udhëzimet e politikës së përgjithshme për veprim të BE-së. Këtë e bën duke marrë vendimet e politikës themelore dhe duke i dhënë instrukcione dhe udhëzime Këshillit ose Komisionit Evropian. Në këtë mënyrë, Këshilli Evropian udhëhiqte punën lidhur me unionin ekonomik dhe monetar, Sistemi Monetar Evropian, zgjedhjet e drejtpërdrejta Parlamentare dhe një sërë çështjesh të anëtarësimit.

***Këshilli (Neni 16 TEU)***



## Përbërja dhe Presidenca

Këshilli përbëhet nga përfaqësuesit e qeverive të Shteteve Anëtare. Të 27 Shtetet Anëtare zakonisht dërgojnë një përfaqësues, edhe pse nuk është patjetër – ministrin e departamentit ose një ministër që nuk bën pjesë në qeveri – përgjegjës për çështjet në fjalë. Është me rëndësi se këta përfaqësues janë të autorizuar për të vepruar me efekt detyrues ndaj qeverive të tyre. Fakti se qeveritë mund të përfaqësohen në mënyra të ndryshme, nënkupton se nuk ekzistojnë anëtarë të përhershëm të Këshillit; në vend të kësaj, përfaqësuesit që marrin pjesë në seancat e Këshillit takohen në nëntë konfiguracione të ndryshme, varësisht nga çështjet në fjalë. Këto janë: (1) ‘Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme’ – si ‘Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme’, ky Këshill koordinon punën e Këshillit në konfigurimet e veta të ndryshme dhe, së bashku me Presidentin e Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian, përgatit mbledhjet e Këshillit Evropian; si ‘Këshilli i Punëve të Jashtme’, ai merret me aktivitetet e BE-së jashtë kufijve, në pajtim me udhëzimet strategjike të Këshillit Evropian dhe garanton se aktivitetet e BE-së janë të logjikshme dhe koherente. ‘Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme’ përbëhet nga Ministrat e Punëve të Jashtme; takimet e çështjeve të përgjithshme të Këshillit udhëhiqen nga Presidenca aktuale, kurse në mbledhjet e çështjeve të jashtme i udhëheq Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Përbashkët të Punëve të Jashtme dhe Sigurisë. Ekzistojnë edhe tetë formacione të tjera të Këshillit në të cilat marrin pjesë Ministrat e Shteteve Anëtare, përgjegjës për fushat në fjalë: (2) ‘Çështjet Ekonomike dhe Financiare’ (i njohur si Këshilli Ekofin), (3) ‘Bashkëpunimi në fushën e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme’, (4) ‘Punësimi, Politika Sociale dhe Çështjet e Konsumatorëve’, (5) ‘Konkurrenca’, (6) ‘Transporti, Telekomunikacioni dhe Energjia’, (7) ‘Bujqësia dhe Peshkimi’, (8) ‘Ambienti Jetësor’ dhe (9) ‘Arsimi, Rinia dhe Kultura’.

Presidencën e Këshillit — me përjashtim të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme, i cili udhëhiqet nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Siguri — e merr çdo Shtet Anëtar për një periudhë gjashtë mujore. Orari sipas të cilit merret udhëheqja e Presidencës vendoset unanimisht nga Këshilli. Presidenca ndërrohet më 1 janar dhe 1 korrik çdo vjet (2008: Sllovenia dhe Franca; 2009: Republika Çeke dhe Suedia; 2010: Spanja dhe Belgjika; 2011: Hungaria dhe Polonia; 2012: Danimarka dhe Qiproja; 2013: Irlanda dhe Lituania, etj.). Duke marrë parasysh këtë ‘dorëzim’ të shpejtë, çdo Presidencë bazon aktivitetet e veta në program





20 korrik 1979, Strazburg.  
Simone Veil bëhet President i parë i Parlamentit  
Evropian, i zgjedhur me votim universal.

pune të miratuar me dy Presidenat e ardhshme, i cili vlen për një periudhë 18 muajsh (‘Presidenca ekipore’). Presidenca kryesisht përgjigjet për koordinimin e përgjithshëm të punës së Këshillit dhe punës së komiteteve që furnizojnë Këshillin me të dhëna. Në aspekt politik, është gjithashtu me rëndësi që Shteti Anëtar, i cili mban Presidencën e BE-së, gëzon një rol të përmirësuar në skenën botërore, kurse Shteteve të vogla Anëtare u jepet mundësia të shoqërohen me ‘aktorët e mëdhenj’ dhe të lënë gjurmën e tyre në politikën Evropiane.

Selia e Këshillit është në Bruksel.

## Detyrat

Prioriteti kryesor i Këshillit është legjislacioni, të cilin ai e zbaton së bashku me Parlamentin, në procesin e bashkë-vendimit. Këshilli gjithashtu përgjigjet për garantimin e politikave ekonomike të Shteteve Anëtare. Ai gjithashtu formulon buxhetin në bazë të propozimit preliminar të Komisionit, edhe pse këtë duhet ta miratojë Parlamenti. Veç kësaj, Këshilli i jep rekomandim Parlamentit për t’i dhënë Komisionit detyrë lidhur me implementimin e buxhetit, dhe ka përgjegjësinë e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Revizorëve, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve. Këshilli gjithashtu ka detyrë lidhjen e marrëveshjeve midis BE-së dhe vendeve që nuk janë anëtare ose organizatave ndërkombëtare.

## Procedurat e punës

Procedurat e punës të Këshillit, janë të përcaktuara hollësisht në rregullat e tij procedurale. Në praktikë, aktivitetet e Këshillit përbëhen kryesisht nga tre etapa, si vijon.

### *Përgatitja për mbledhjet e Këshillit*

Puna përgatitore për mbledhjet e Këshillit realizohet nga dy organe permanente përbrenda strukturës së tij organizative: Komiteti i Përfaqësuesve Permanentë dhe Sekretariati Gjeneral.

Komiteti i Përfaqësuesve Permanentë, të cilit i referohemi si Coreper – trajtë e shkurtuar e titullit francez *Comité des représentants permanents*, përgatit bazat për punën e Këshillit dhe kryen detyrat e caktuara nga Këshilli. Për të mundur atë të realizojë të gjitha këto detyra, ky Komitet ndahet në Coreper I (i cili përbëhet nga Zëvendësit e Përfaqësuesve Per-

manentë, të cilët kryesisht mbajnë përgjegjësinë për punën përgatitore lidhur me çështje më teknike, të cilat trajtohen nga Këshillit të ndryshme) dhe Coreper II (i cili përbëhet nga vet Përfaqësuesit Permanentë, të cilët, në parim, mbajnë përgjegjësinë për të gjitha çështjet e linjës së veprimit). Bujqësia është një nga fushat që nuk i nënshtrohen kësaj ndarjeje të detyrave; Komiteti Special për Bujqësi (gjithashtu i njohur me shkurtesën e gjuhës franceze CSA — *Comité spécial de l'Agriculture*) u themelua në vitin 1960 dhe pranoi detyrat e Coreper-it lidhur me çështjet bujqësore.

Përgatitjet për mbledhjet e Këshillit nga Coreper-i dhe Komiteti Special për Bujqësi janë dy llojesh. Së pari, bëhen përpjekje për të arritur marrëveshje në nivel të komitetit, në lidhje me çka komitetet mund të shfrytëzojnë ndihmën e rreth 100 palëve permanente në sektorë specifikë përbrenda Këshillit. Ato mund të kërkojnë edhe shërbimet e 'grupeve ad hoc', të cilat janë emëruar të trajtojnë çështje specifike në një periudhë të caktuar. Së dyti, puna përgatitore duhet të garantojë se çështjet që duhen diskutuar dhe të vendosen në mbledhjen e Këshillit, të jenë zgjidhur praktikisht, dhe të informojnë anëtarët e Këshillit. Këto qasje të dyfishta reflektohen në agjendën e mbledhjeve: çështjet për të cilat ka qënë e mundur të arrihet marrëveshje, të referohen si 'çështjet A' dhe ato që janë të pavendosura dhe duhet të diskutohen edhe më tej të referohen si 'çështjet B'.

Sekretariati Gjeneral siguron ndihmë administrative për Këshillin (si dhe për Coreper dhe Komitetin Specifik për Bujqësi). Veçanërisht, merret me anën teknike të përgatitjeve për mbledhjet e Këshillit, ka detyrë të mundësojë mjetet për përkthim (përfaqësuesit e Shteteve Anëtare flasin në gjuhën e tyre), garanton sigurimin e përkthimeve të nevojshme, ofron këshillë juridike për Këshillin dhe komitetet dhe administron buxhetin e Këshillit.

### *Mbledhjet e Këshillit*

Mbledhjet e Këshillit i thërret Presidenti i tij (përfaqësuesi i Shtetit Anëtar që mban Presidencën e Këshillit ose Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë) në iniciativë të tij apo të saj, me kërkesë të njërit nga anëtarët e vet ose me kërkesë të Komisionit Evropian. Presidenti harton një agjendë të përkohshme për çdo mbledhje, e cila përbëhet nga Pjesa A dhe Pjesa B.

Këshilli vetëm diskuton dhe merr vendime lidhur me dokumente dhe propozime që janë në dispozicion në 23 gjuhë zyrtare (gjuhën bullgare, çeke, daneze, hollandeze, angleze, estoneze, finlandeze, franceze, gjermane, greke, hungareze, irlandeze, italiane, letoneze, lituaneze, malteze, polake, portugeze, rumune, sllovaqe, sllovene, spanjolle dhe suedeze). Nëse një çështje është urgjente, ky rregull mund të bëhet i panevojshëm me marrëveshje të njëzëshme. Kjo vlen edhe për propozimet e ndryshimeve të prezantuara dhe të diskutuara gjatë mbledhjes.

Mbledhjet në të cilat Këshilli diskuton ose voton propozimet legislative, janë të hapura për publikun. Në praktikë, kjo nënkupton se mbledhjet transmetohen në dhoma me mundësi transmetimi të gjallë audiovizuel, në godinën e Këshillit.

Interesat individuale të Shteteve Anëtare dhe interesat e Unionit balancohen në Këshill. Edhe pse Shtetet Anëtare kryesisht mbrojnë interesat e veta në Këshill, anëtarët e tij njëkohësisht janë të obliguar të marrin parasysh synimet dhe nevojat e Unionit si tërësi. Këshilli është institucion i Unionit dhe jo Konferencë Ndërqeveritare. Rrjedhimisht, ai nuk është treguesi më i vogël i përbashkët midis Shteteve Anëtare, i cili nevojitet në diskutimet e Këshillit, por më saktë është baraspesha e duhur midis interesave të Unionit dhe Shteteve Anëtare.

### *Procedurat e vendim-marrjes*

Sipas Traktateve të BE-së, votimi i mazhorancës zbatohet në Këshill — si rregull i përgjithshëm, mazhoranca e kualifikuar është e mjaftueshme (Neni 16(3) TEU). Mazhoranca e thjeshtë, ku çdo anëtar i Këshillit ka një votë, zbatohet në raste individuale dhe në fusha më pak të ndjeshme. (Prandaj, mazhoranca e thjeshtë tani arrihet me 14 vota).

Metodat e kalkulimit të mazhorancës së kualifikuar do të ndryshojnë në etapa të ndryshme.

Deri më 1 nëntor 2014, do të përdoret sistemi i matjes së peshës votuese, i inkuadruar me Traktatin e Nicës, i cili u jep Shteteve më të mëdha Anëtare më tepër ndikim. Me këtë sistem, mazhoranca e kualifikuar arrihet kur ekziston shumicë e Shteteve Anëtare me së paku 255, nga gjithsej 345, edhe pse një Shtet Anëtar mund të kërkojë që këto Shtete Anëtare të përfaqësojnë së paku 62% të popullatës të BE-së.

Nga 1 janari 2007, numri i votave që mund të japë çdo Shtet Anëtar ka qënë si vijon.

<b>PESHA E VOTAVE</b>			
GJERMANIA	29	AUSTRIA	10
FRANCA	29	SUEDIA	10
ITALIA	29	DANIMARKA	7
BRITANIA E MADHE	29	IRLANDA	7
SPANJA	27	LITUANIA	7
POLONIA	27	SLLOVAKIA	7
RUMANIA	14	FINLANDA	7
HOLLANDA	13	ESTONIA	4
BELGIKA	12	QIPROJA	4
REPUBLIKA ÇEKE	12	LETONIA	4
GREQIA	12	LUKSEMBURGU	4
HUNGARIA	12	SLLOVENIA	4
PORTUGALIA	12	MALTA	3
BULLGARIA	10		

Më 1 nëntor 2014, hyn në fuqi sistemi i ri i mazhorancës së dyfishtë, sipas të cilit mazhoranca e kualifikuar arrihet kur së paku 55% e Shteteve Anëtare që përfaqësojnë 65% të popullatës së BE-së, votojnë për propozim legjislativ. Për të parandaluar Shtetet Anëtare më pak të populluara të bllokojnë miratimin e një vendimi, pakica bllokuese duhet të përbëhet së paku nga katër Shtete Anëtare, dhe nëse ky numër nuk arrihet, mazhoranca e kualifikuar konsiderohet si e arritur edhe në rast se nuk është plotësuar kriteriumi i popullatës. Sistemi plotësohet me një mekanizëm shumë të ngjashëm me 'kompromisin e Janinës': nëse pakica bllokuese nuk arrihet, procesi i vendim-marrjes mund të suspendohet. Në këtë rast, Këshilli nuk vazhdon me votim por vazhdon me negociatë për një periudhë të arsyeshme, nëse këtë e kërkojnë Anëtarët e Këshillit që përfaqësojnë së paku 75% të popullatës ose së paku 75% të numrit të Shteteve Anëtare të nevojshme për pakicën bllokuese.

Duke filluar nga 1 prilli 2017, do të vlejë mekanizmi i njëjtë mirëpo përqindjet për themelimin e pakicës bllokuese do të ndryshojnë për së paku 55% të popullatës ose së paku 55% i numrit të Shteteve Anëtare. Këshilli mund të ndryshojë këtë sistem de jure me mazhorancë të thjeshtë. Mirëpo, një nga protokolet thotë se negociatat së pari duhet të zhvillohen në Këshillin Evropian, kurse vendimet e mundshme duhet të jenë unanime.

Rëndësia e votimit të mazhorancës nuk kushtëzohet me faktin se parandalon Shtetet e vogla nga bllokimi i vendimeve të rëndësishme, pasi që kjo mundëson të rrëzojnë me vota Shtetet e mëdha Anëtare. Megjithatë, ‘Marrëveshja e Luksemburgut’ mbetet faktor kryesor politik, së paku për sa i përket përvojës votuese. Kjo marrëveshje mundëson veton e ndonjë mase të Komunitetit, në rastet ku një Shtet Anëtar konsideron se interesat e veta vitale nacionale janë në rrezik, dhe u shfrytëzua për zgjidhjen e krizës që u shfaq në vitin 1965, kur Franca, duke pasur frikë se po i kërcënohen interesat e veta nacionale në financimin e politikës së përbashkët të bujqësisë, bllokoj një marrje të vendimit në Këshill për mbi se gjashtë muaj, me ‘politikën e karrikes së zbrazët’.

Në rast të vendimeve që duhet të merren sidomos në fushat e ndjeshme politike, për Traktatet është i nevojshëm unanimitet. Miratimi i një vendimi nuk mund të bllokohet me anë të abstenimit. Unanimiteti është i nevojshëm edhe për vendimet lidhur me çështjet e tatimeve, të drejtat dhe obligimet e të punësuarve, ndryshimet e dispozitave për shtetësi dhe të përcaktojë nëse një Shtet Anëtar ka bërë shkelje të parimeve kushtetuese. Ai është i nevojshëm edhe për të përcaktuar parimet dhe udhëzimet në fushën e politikës së përbashkët të punëve të jashtme dhe sigurisë ose çështjet e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor lidhur me veprat penale.

### **Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Politikë të Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë (Neni 18 TEU)**

Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Punëve të Jashtme dhe Siguri nuk u bë ministri i punëve të jashtme të BE-së, ashtu siç ishte paraparë në projektin kushtetues; mirëpo, qëndrimi i tij në strukturën institucionale është forcuar dhe është zgjeruar konsiderueshëm. Fillimisht, zyra e Përfaqësuesit të Lartë do të bashkohen me atë të Komisionit për Punë të Jashtme. Kjo i jep Përfaqësuesit të Lartë bazë si në Këshill – ku mbahet presidenca e Këshillit për Punë të Jashtme, ashtu edhe në Komision – ku ka rolin e Zëvendës Presidentit, përgjegjës për punë të jashtme. Përfaqësuesin e Lartë e emëron Këshilli Evropian, duke vepruar me mazhorancë të kualifikuar, me pajtimin e Presidentit të Komisionit. Ai ose ajo merr përkrahjen e shërbimit të punëve të jashtme të sapo krijuar, i cili përbëhet nga zyrtarë të Komisionit Evropian <sup>(5)</sup> dhe Sekretariatit Gjeneral të Këshillit, si dhe përfaqësues të deleguar nga shërbimet diplomatike të Shteteve Anëtare.

<sup>(5)</sup> Baronesha Kethrin Eshton, ish Komisionere për Tregti, u emërua në këtë post.

*Komisioni Evropian (Neni 17 TEU)***PËRBËRJA**

**27 Anëtarë**  
**Duke përfshirë Presidentin**  
**Zëvendës Presidenti i parë: Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Politikë të**  
**Jashtme dhe Siguri**  
**6 Zëvendës Presidentë**

U vendos se prej vitit 2014, Komisioni Evropian nuk do të ketë më përfaqësues nga çdo Shtet Anëtar, por do të ketë një numër Anëtarësh që do të korrespondojnë në dy të tretat e numrit të Shteteve Anëtare, d.m.th. për numrin e përgjithshëm aktual të Shteteve Anëtare – 27, numri i Anëtarëve të Komisionit në vitin 2014 do të jetë 18. Për këtë arsye, sistemi i rotacionit do të prezantohet për të garantuar se për çdo Shtet Anëtar do të ketë nga një Komisioner, në dy, nga çdo tre periudha konsekuive të mandatit të Komisionit. Mirëpo, Këshillit Evropian i është dhënë fuqia të ndryshojë këtë përbërje me votë unanime, i cili tani më ka paralajmëruar synimin e vet për të bërë këtë në konkluzat e mbledhjes së vet më 18 dhe 19 qershor 2009 në Bruksel. Në këtë mbledhje, Këshilli Evropian u pajtua të marrë vendim pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës dhe në përputhje me procedurat e nevojshme ligjore, sipas të cilit, Komisioni do të vazhdojë të ketë një shtetas nga çdo Shtet Anëtar. Me këtë plotësohet një nga kërkesat themelore të caktuara nga Irlanda, kur organizoi referendumin e vet të dytë mbi Traktatin e Lisbonës.

**Përbërja**

Komisionin e udhëheq Presidenti, të cilin e ndihmojnë shtatë Zëvendës Presidentë, duke përfshirë këtu edhe Përfaqësuesin e Lartë të Unionit për Politikë të Jashtme dhe Siguri si Zëvendës President të parë. Më në fund, pozita e Presidentit përbrenda Komisionit është përforcuar dukshëm. Ai ose ajo nuk është më ‘i pari midis të barabartëve’ por gëzon pozitë prominente në aspektin se Komisioni duhet të punojë ‘në suaza të udhëzimeve politike’ të Presidentit të vet (Neni 17 TEU). Kështu, Presidenti ka ‘fuqi për të ofruar udhëzime’. Presidenti vendos lidhur me organizimin e brendshëm të Komisionit, për t’u siguruar se vepron në mënyrë konsistente dhe efikase. Ai ose ajo u ndan përgjegjësitë Komisionerëve, dhe mund të riorganizojë

shpërndarjen e këtyre përgjegjësive gjatë mandatit të Komisionerit. Presidenti emëron Zëvendës Presidentët, dhe mund të detyrojë një Anëtar të Komisionit të japë dorëheqje. Pozita e spikatur e Presidentit reflektohet gjithashtu edhe nga anëtarësia e tij ose saj në Këshillin Evropian.

Presidenti dhe Anëtarët e Komisionit emërohen me mandat pesë vjeçar, duke shfrytëzuar procedurën e emërimit: Këshilli Evropian, i cili vepron me mazhorancën e kualifikuar, nominon personin të cilin planifikon ta propozojë, në mënyrë që Parlamenti Evropian ta zgjedhë për President të Komisionit, duke marrë parasysh mazhorancën e votave të Parlamentit Evropian. Parlamenti Evropian pastaj zgjedh Presidentin me mazhorancën e anëtarëve të vet. Nëse kandidati nuk fiton mazhorancën e nevojshme në Parlament, Këshilli Evropian i propozon Parlamentit një kandidat të ri përbrenda një muaji. Shtetet Anëtare atëherë hartojnë një listë të njerëzve të nominuar si Anëtarë të Komisionit. Këtë listë e miraton Këshilli, duke vepruar me mazhorancë të kualifikuar dhe me pajtimin e Presidentit. Pas zgjedhjes së Presidentit të Komisionit nga Parlamenti Evropian, Anëtarët e tjerë të Komisionit i nënshtrohen votës miratuese të Parlamentit. Pas miratimit të Parlamentit, Anëtarët e Komisionit, përveç Presidentit zyrtarisht emërohen nga Këshilli i BE-së, me mazhorancë të kualifikuar.

Anëtarët e Komisionit duhet të zgjidhen ‘në bazë të kompetencave të tyre të përgjithshme’ dhe të jenë ‘plotësisht të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre’ (Neni 17(3) TEU). Ata nuk mund as të kërkojnë dhe as të marrin instruksione nga asnjë qeveri.

Selia e Komisionit Evropian është në Bruksel.

## Detyrat

Detyrat	
Inicimi i legjislacionit të Unionit	Mbikqyrja monitoruese dhe zbatimi i duhur i të drejtës së Unionit
Administrimi dhe Implementimi i legjislacionit të Unionit	Përfaqësimi i BE-së në organizatat ndërkombëtare



Komisioni është mbi të gjitha ‘forca shtytëse’ e politikës së Unionit. Ai është pika fillestare për çdo veprim të Unionit, Pasi që Komisioni është ai që duhet t’i prezantojë Këshillit propozime dhe plane për legjislacionin e Unionit (kjo quhet e drejta e Komisionit për iniciativë). Komisioni nuk ka lirinë të zgjedhë aktivitetet e veta. Ai ka obligim të veprojë nëse këtë e kërkojnë interesat e Unionit. Këshilli (Neni 241 TFEU), Parlamenti Evropian (Neni 225 TFEU) dhe një grup i qytetarëve të BE-së që veprojnë në emër të iniciativës së qytetarëve (Neni 11(4) TEU) gjithashtu mund të kërkojnë që Komisioni të hartojë një propozim. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, në rastet e veçanta që përcaktohen me Traktatet, aktet legjislative mund të miratohen me iniciativën e një grupi të Shteteve Anëtare ose iniciativën e Parlamentit Evropian, me rekomandimin e Bankës Evropiane për Investime ose me kërkesën e Gjykatës së së Drejtës ose Bankës Evropiane të Investimeve.

Komisioni ka fuqi primare për të inicuar legjislacion në fusha të caktuara (siç është buxheti i Unionit, Fondet Strukturore, masat që merren me diskriminimet tatimore, dispozita e financimit dhe klauzolat e mbrojtjes). Mirëpo, shumë më të mëdha janë fuqitë e implementimit të rregullave të Unionit, të cilat i janë transferuar Komisionit nga Këshilli dhe Parlamenti (Neni 290 TFEU).

Komisioni është poashtu edhe ‘gardiani i të drejtës së Unionit’. Ai monitoron aplikacionin e Shteteve Anëtare dhe implementimin e legjislacionit primar dhe sekundar të Unionit, rregullon procedurat e shkeljes në rast të ndonjë shkeljeje të ligjit të Unionit (Neni 258 TFEU) dhe, nëse është nevoja, i referon çështjen Gjykatës të Drejtësisë. Komisioni gjithashtu intervenon nëse bëhet shkelja e ligjit të Unionit nga ndonjë person fizik ose juridik dhe imponon gjopa të rënda. Gjatë disa viteve të fundit, përpjekjet për parandalimin e keqpërdorimit të rregullave të Unionit janë bërë pjesë e rëndësishme e punës së Komisionit.

Lidhur ngushtë me rolin e gardianit është detyra e përfaqësimit të interesave të Unionit. Në parim, Komisioni mund t’u shërbejë vetëm interesave të Unionit. Ai duhet në mënyrë konstante të përpiqet lidhur me negociatat e vështira përbrenda Këshillit, në mënyrë që të interesi i Unionit të mbizotërojë. Dhe të kërkojë kompromise dhe zgjidhje që marrin parasysh këtë interes. Duke bërë këtë, ai gjithashtu luan rolin e mediatorit midis Shteteve Anëtare, një rol për të cilin është i përshtatshëm dhe i kualifikuar duke marrë parasysh virtytin e asnjansisë së tij.

Së fundi, Komisioni është organ ekzekutiv — ndonëse në masë të kufizuar. Kjo vlen sidomos në fushën e ligjit të konkurrencës, ku Komisioni vepron

si autoritet normal administrativ, me atë që kontrollojnë fakte, jep miratime ose ndalon, dhe nëse është nevoja imponon gjyba. Fuqitë e Komisionit në lidhje me Fondet Strukturore dhe buxhetin e BE-së janë gjithashtu të shumta. Mirëpo, në parim, janë Shtetet Anëtare ato që duhet të garantojnë zbatimin e rregullave të unionit në raste individuale. Kjo zgjidhje e selektuar nga Traktatet e Unionit ka përparësi pasi që qytetarët janë më afër asaj që ata e konsiderojnë si realitet të 'huaj' të sistemit Evropian, përmes punimeve dhe formës së njohur të sistemeve të tyre nacionale.

Komisioni prezanton Unionin në organizatat ndërkombëtare dhe përgjigjet për funksionimin e përditshëm të misioneve diplomatike të Unionit, jashtë dhe përbrenda BE-së. Në bazë të fuqive të transferuara nga Këshilli, Komisioni përgjigjet për marrëveshjet negociuese me organizatat ndërkombëtare dhe vendet jo anëtare, përfshirë këtu edhe Traktatet e Anëtarësimit me Shtetet e reja Anëtare. Komisioni përfaqëson Unionin në gjykatat e Shteteve Anëtare dhe — aty ku është e nevojshme së bashku me Këshillin — para Gjykatës të Drejtësisë.

## STRUKTURA ADMINISTRATIVE E KOMISIONIT EVROPIAN

Komisioni  
(27 Anëtarë)  
(Kabinetet)  
Sekretariati Gjeneral  
Shërbimi Ligjor  
Drejtoria Gjenerale për Komunikim  
Byroja e Këshilltarëve për Politikë Evropiane

Drejtoria Gjenerale për Çështje Ekonomike dhe Financiare

Drejtoria Gjenerale për Ndërmarrje dhe Industri

Drejtoria Gjenerale për Konkurrencë

Drejtoria Gjenerale për Punësim, Çështje Sociale dhe Mundësi të Barabarta

Drejtoria Gjenerale për Buqësi dhe Zhvillim Rural

Drejtoria Gjenerale për Energji

Drejtoria Gjenerale për Mobilitet dhe Transport

Drejtoria Gjenerale për Ambientin Jetësor

Drejtoria Gjenerale për Aktivitetet Klimatike

Drejtoria Gjenerale për Hulumtim

Qendra e Përbashkët e Hulumtimit

Drejtoria Gjenerale për Teknologjitë e Informimit dhe Mediat
Drejtoria Gjenerale për Çështje Detare dhe Peshkimi
Drejtoria Gjenerale për Tregun dhe Shërbimet e Brendshme
Drejtoria Gjenerale për Politikë Rajonale
Drejtoria Gjenerale për Unionin Tatimor dhe Doganor
Drejtoria Gjenerale për Arsimit dhe Kulturë
Drejtoria Gjenerale për Shëndetësi dhe Kosumatorë
Drejtoria Gjenerale për Drejtësi, Liri dhe Siguri
Drejtoria Gjenerale për Marrëdhënie të Jashtme
Drejtoria Gjenerale për Tregti
Drejtoria Gjenerale për Zhvillim
Drejtoria Gjenerale për Zgjerim
Zyra e Bashkëpunimit EuropeAid
Drejtoria Gjenerale për Ndihmë Humanitare (EÇO)
Eurostat
Drejtoria Gjenerale për Resurse Njerëzore dhe Siguri
Drejtoria Gjenerale për Informatikë
Drejtoria Gjenerale për Buxhet
Zyra e Revizionit të Brendshëm
Zyra Evropiane kundër Falsifikimit
Drejtoria Gjenerale për Interpretim
Drejtoria Gjenerale për Përkthim
Zyra e Botimeve
Zyra për Infrastrukturë dhe Logjistikë në Bruksel
Zyra për Infrastrukturë dhe Logjistikë në Luksemburg
Zyra për Administrimin dhe Pagesën e të Drejtave Individuale
Zyra Evropiane për Zgjedhje të Personelit

### *Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (Neni 19 TEU)*

Çdo sistem do të mbijetojë, vetëm nëse rregullat e tij mbikqyren nga një autoritet i pavarur. Për më tepër, në një bashkim të shteteve, rregullat e përbashkëta — nëse i nënshtrohen kontrollit të gjykatave nacionale — interpretohen dhe zbatohen ndryshe nga një shtet në tjetrin. Kështu, zbatimi i uniformuar i ligjit të Unionit në të gjitha Shtetet Anëtare mund të rrezikohet. Këto shqyrtime rezultuan me themelimin e Gjykatës të Komunitetit



1 nëntor 1992.

*Kjo fotografi paraqet një valixhe në hartë të Evropës dhe ilustron lëvizjen e lirë të njerëzve, e cila u prezantua nga Traktati i Mاستrihit.*

për Drejtësi, në vitin 1952, menjëherë pas krijimit të Komunitetit të parë (Komuniteti Evropian për Thëngjill dhe Çelik). Në vitin 1957, kjo gjykatë u bë organi ligjor për dy Komunitetet e tjera (E(E)C dhe Euratom). Sot, gjykata është organi ligjor i BE-së.

Puna gjyqësore tani zbatohet në tre nivele nga:

- Gjykata e Drejtësisë, si instancë më e lartë në rendin ligjor të Komunitetit (Neni 253 TFEU);
- Gjykata e Përgjithshme (Neni 254 TFEU);
- Gjykatat e specializuara, të cilat mund t'i emërohen Gjykatës së Përgjithshme të vendosë për rastet në fusha të caktuara (Neni 257 TFEU).

## Gjykata e Drejtësisë

<b>PËRBËRJA E GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN</b>	
27 gjykatës dhe 8 Avokatë të Përgjithshëm të emëruar nga Qeveritë e Shteteve Anëtare me marrëveshje të përbashkët për mandate gjashtë vjeçar	
Llojet e proceseve gjyqësore	
Veprimet për dështim të plotësisht të obligimeve në bazë të Traktateve: Komisioni kundër Shtetit Anëtar (Neni 258 TFEU); Shteti Anëtar kundër Shtetit Anëtar (Neni 259 TFEU)	Veprimet për anulim dhe veprimet në bazë të dështimit të veprimit, të marrë nga një institucion i Unionit ose një Shtet Anëtar lidhur me ndonjë akt ilegal ose dështim për të vepruar (Nenet 263 dhe 265 TFEU)
Rastet e referuara nga gjykatat nacionale për vendime preliminare për të qartësuar interpretimin dhe validitetin e ligjit të Unionit (Neni 267 TFEU)	Ankesat kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme (Neni 256 TFEU)

Gjykata e Drejtësisë aktualisht përbëhet nga 27 gjykatës dhe tetë Avokatë të Përgjithshëm, të cilët emërohen me 'pajtim të përbashkët të Qeverive të Shteteve Anëtare' për periudhë gjashtë vjeçare. Çdo Shtet Anëtar dërgon një gjykatës. Për të garantuar një shkallë kontinuiteti, zëvendësimi i pjesërishëm i gjysmës së Avokatëve të Përgjithshëm bëhet çdo tre vjet në fillim të vitit juridik më 6 tetor. Ata mund të riemërohen.

Gjykatën e ndihmojnë tetë Avokatë të Përgjithshëm, mandati i të cilëve korrespondon me atë të gjykatësve; ata gëzojnë pavarësi gjyqësore. Katër nga tetë Avokatët e Përgjithshëm janë gjithnjë nga Shtetet Anëtare 'të mëdha' (Gjermania, Franca, Italia dhe Britania e Madhe) kurse katër të tjerë janë nga 23 Shtetet e tjera Anëtare sipas sistemit alternues. Zyra e Avokatit të Përgjithshëm bazohet në zyrën e *Commissaire du gouvernement* në Këshillin e Shteteve (Conseil d'État) dhe gjykatave administrative në Francë. Kjo zyrë nuk guxon të ngatërrohet me pozitën e prokurorit publik ose një posti të ngjashëm në shumë vende. Avokatët e Përgjithshëm u prezantuan në Gjykatë për të krijuar një kundër-balancë ndaj natyrës fillestare 'një-nivelëshe' të proceseve gjyqësore, d.m.th. mungesën e procedurave të apelit. Detyra e tyre është të dorëzojnë 'opinionet' në Gjykatë, në formë të propozimeve (jo-detyruese) për një vendim të Gjykatës të bazuar në një anketë plotësisht të pavarur dhe asnjënjë, lidhur me çështje ligjore që shfaqen në rast të caktuar. Opinionet janë një pjesë përbërëse e procedurës gojore dhe publikohen së bashku me vendimin në Raportet e Gjykatës. Avokatët e Përgjithshëm mund të ndikojnë në vendim, vetëm me fuqi të argumenteve në opinionet e tyre; ata nuk janë të përfshirë në asnjë shqyrtim apo votim të vendimit.

### *Zgjedhja e gjykatësve dhe Avokatëve të Përgjithshëm*

Gjykatësit dhe Avokatët e Përgjithshëm janë persona, asnjënjë e të cilëve është e padyshimtë dhe të cilët posedojnë kualifikimet e nevojshme për emërim në zyrat më të larta gjyqësore në shtetet e tyre, ose të cilët janë ekspertë ligjorë me kompetenca të njohura (Neni 253 TFEU). Kjo do të thotë se mund të emërohen gjykatës, zyrtarë publikë, politikanë, avokatë ose ligjërues universitarë nga Shtetet Anëtare. Llojllojshmëria e sfoneve dhe përvojave profesionale janë të dobishme për Gjykatën, me faktin se mund të ndihmojnë në sigurimin e vlerësimit sa më të plotë si në aspektet teorike ashtu edhe në ato praktike të fakteve dhe pjesëve të ligjit që duhen marrë parasysh. Në të gjitha Shtetet Anëtare, zgjedhja për propozimin apo emërimin e qeverisë për gjykatës apo Avokat të Përgjithshëm, dhe procedurave përdorur, janë çështje e

ekzekutivit. Procedurat dallojnë shumë dhe radhiten nga ato më pak transparente deri në ato krejtësisht të padepërtueshme.

Ndihma mundësohet nga paneli i sapokrijuar konsultativ për nominimin e gjykatësve, i cili ka për detyrë të japë opinione lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve të kryejnë detyrat e gjykatësit dhe Avokatit të Përgjithshëm të Gjykatës të Drejtësisë para se të bëhen emërimet nga qeveritë e Shteteve Anëtare (Neni 255 TFEU). Paneli përbëhet nga shtatë persona të zgjedhur nga anëtarë të mëparshëm të Gjykatës të Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, anëtarë të gjykatave supreme nacionale dhe avokatë me kompetencë të pranuar, një prej të cilëve e propozon Parlamenti Evropian.

### *Procedura*

Gjykata mban seancë në formacionet në vijim:

- Gjykata e plotë me 27 gjykatës; vendim i plotë i Gjykatës është i nevojshëm vetëm në procedurat e paditjes dhe proceset disiplinore kundër anëtarëve të organeve të Unionit. Rastet mund t'i referohen Gjykatës së plotë nga vetë Gjykata e Drejtësisë, por vetëm kur bëhet fjalë për procese dhe çështje jashtëzakonisht të rëndësishme të pangjara më parë;
- Oda e Madhe me 13 gjykatës;
- Oda me nga pesë dhe tre gjykatës.

### *Detyrat*

Gjykata e Drejtësisë është autoriteti më i lartë dhe njëkohësisht autoriteti i vetëm gjyqësor në çështje që kanë të bëjnë me të drejtën e Unionit. Në përgjithësi, detyra e saj është të 'garantojë se në interpretimin e Traktit, respektohet ligji'.

Ky përshkrim i përgjithshëm i përgjegjësive përfshin tre fusha kryesore

- mbikqyrja e zbatimit të të drejtës së Unionit, si nga institucionet e BE-së gjatë implementimit të Traktateve, ashtu edhe nga Shtetet Anëtare dhe individët lidhur me obligimet e tyre të parapara me të drejtën e Unionit;
- interpretimi i të drejtës së Unionit;
- formësimi i mëtejshëm i të drejtës së Unionit.

Në kryerjen e këtyre detyrave, puna e Gjykatës përfshin edhe këshillë ligjore edhe deklarim. Këshilla ligjore mundësohet në formë të opinionëve detyruese mbi marrëveshjet që BE-ja dëshiron të nënshkruajë me shtetet që nuk janë anëtare ose me organizatat ndërkombëtare. Funkzioni i gjykatës si organ për administrimin e drejtësisë është shumë më i rëndësishëm. Në ushtrimin e këtij funksioni, ajo funksionon në çështje, të cilat në Shtetet Anëtare do të emërohen në lloje të ndryshme të gjykatave, varësisht nga sistemet e tyre nacionale. Gjykata vepron si gjyq kushtetues në rastet e konflikteve midis institucioneve të Unionit ose në rastet e shqyrtimit të legalitetit të instrumenteve legjislativë; gjykata vepron si gjyq administrativ në rastet e shqyrtimit të akteve administrative të Komisionit ose autoriteteve nacionale që zbatojnë legjislacionin e Unionit; si gjyq pune ose tribunal industrial, atëherë kur merret me lirinë e lëvizjes, sigurimin social dhe mundësitë e barabarta; si gjyq fiskal kur trajton çështje validiteti dhe interpretime të direktivave në fushat e ligjit të tatimeve dhe doganave; si gjykatë penale kur shqyrton vendimet e Komisionit që imponojnë gjoba; dhe si gjyq civil kur bën dëgjimin e denoncimeve për dëme ose interpretimin e dispozitave për vënien në fuqi të vendimeve në çështjet civile dhe komerciale dhe në konfliktet mbi të drejtat Evropiane të pronës intelektuale për të cilat janë dhënë baza juridiksioni nga Gjykata e Drejtësisë (Neni 262 TFEU).

### Gjykata e Përgjithshme

Si të gjitha gjykatat, Gjykata e Drejtësisë është e stërngarkuar. Numri i rasteve që i referohen është rritur gradualisht dhe do të vazhdojë të rritet, duke marrë parasysh potencialin për konflikte që është krijuar nga numri jashtëzakonisht i madh i direktivave të miratuara në kontekst të tregut të vetëm dhe të kaluara në ligjin nacional të Shteteve Anëtare. Ekzistojnë shenja se Traktati për Bashkimin Evropian ka ngritur çështje të tjera, të cilat përfundimisht do të duhet të zgjidhen nga Gjykata. Prandaj, në vitin 1988, u themelua Gjykata e Përgjithshme, për të hequr barrën e Gjykatës së Drejtësisë.



## PËRBËRJA E GJYKATËS SË PËRGJITHSHME

## 27 gjykatës

të emëruar nga Qeveritë e Shteteve Anëtare  
me marrëveshje të përbashkët për mandat gjashtë vjeçar

## Llojet e proceseve gjyqësore

Aktet e anulimit dhe ankesat lidhur me dështimin e veprimit, të cilat i dorëzojnë persona fizik dhe juridik në bazë të ilegalitetit ose mungesës së akteve ligjore të Unionit (Nenet 263 dhe 265 TFEU)

Aktivitetet për dëme, në bazë të problemeve kontraktuale dhe jokontraktuale (Nenet 268 dhe 340(1) dhe (2) TFEU)

Ankesat kundër vendimeve të dhëna nga panelet gjyqësore (Neni 256(2) TFEU)

Gjykata e Përgjithshme nuk është institucion i ri i Unionit, por thënë më mirë, një element përbërës i Gjykatës së Drejtësisë. Mirëpo, është një organ autonom, i ndarë nga Gjykata e Drejtësisë në aspektin organizativ. Ka regjistritin e vet dhe rregulloren e vet. Rastet e shqyrtuara nga Gjykata e Përgjithshme, identifikohen me ndihmën e ‘T’ (= Tribunal) (p.sh. T-1/99), kurse ato që i referohen Gjykatës të Drejtësisë kanë kodin ‘C’ (= Court) (p.sh. C-1/99).

Gjykata e Përgjithshme përbëhet nga 27 ‘anëtarë’ dhe kualifikimet, emërimet dhe statusi i tyre ligjor u nënshtrohen kërkesave dhe kushteve të njëjta si gjykatësve në Gjykatën e Drejtësisë. Edhe pse funksioni i tyre kryesor është të zhvillojnë punimet si ‘gjykatës’, ata mund të emërohen edhe si ‘Avokatë Gjeneralë’ në raste ad hoc, para Gjykatës së plotë, ose në rastet para njëres nga Odat, nëse këtë e kërkojnë faktet e rastit ose ndërlikueshmëria e tij ligjore. Ky mjet është përdorur me shumë kursim deri më tani.

Gjykata e Përgjithshme zhvillon seancat në Dhoma me pesë ose tre gjykatës, ose në raste të caktuara edhe me vetëm një gjykatës. Mund të gjykojë edhe si Dhoma e Madhe (13 gjykatës) ose si Gjykatë e plotë (27 gjykatës) nëse këtë e kërkon ndërlikueshmëria ligjore apo rëndësia e rastit. Mbi 80% e rasteve para Gjykatës dëgjohen nga Dhomat me tre gjykatës.

Edhe pse Gjykata e Përgjithshme fillimisht mbante përgjegjësinë vetëm për një numër të kufizuar të rasteve, tani ka detyrat si vijon.

- Në instancën e parë, d.m.th që i nënshtrohet mbikqyrjes ligjore të Gjykatës së Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme ka kompetenca të vendosë lidhur me aktivitetet për anulim dhe për dështim të veprimit, të prezantuara nga persona fizikë ose juridikë kundër ndonjë organi të Unionit; të vendosë lidhur me klauzolën e arbitrazhit, e cila ndodhet në ndonjë kontratë të nënshkruar nga BE-ja ose në emër të saj dhe në raste të dëmeve kundër BE-së.
- Gjykata e Përgjithshme vepron si gjykaktë apeli për rastet e apelit kundër vendimeve që jepen nga panelet gjyqësore.
- Është paraparë gjithashtu edhe transferimi i juridiksionit në Gjykatën e Përgjithshme për procese gjyqësore me vendime preliminare në fusha të caktuara; megjithatë, ky opcion akoma nuk është përdorur.

### Gjykatat e specializuara

Në vitin 2004, për të shkarkuar barrën e Gjykatës së Drejtësisë dhe për të përmirësuar mbrojtjen ligjore në BE, Këshilli i BE-së i shtoi Gjykatës së Përgjithshme një gjykatë të specializuar për rastet e shërbimit civil.

Kjo gjykatë e specializuar ka marrë juridiksionin nga Gjykata e Përgjithshme për marrjen e vendimeve të instancës së parë, në konfliktet e shërbimit civil në Evropë.

Gjykata e specializuar përbëhet nga shtatë gjykatës, të cilët gëzojnë një status të ngjashëm me atë të anëtarëve të Gjykatës së Përgjithshme dhe emërohen në mandate gjashtë vjeçare. Ata duhet të kenë aftësinë e nevojshme për emërimin në mandate gjyqësore. Gjykata e specializuar zakonisht gjykon si panel me tre gjykatës, mirëpo mund të japë vendim si panel i plotë ose me pesë gjykatës, ose edhe si një gjykatës i vetëm. Vendimet e gjykatës së specializuar u nënshtrohen të drejtës së apelit në Gjykatën e Përgjithshme, vetëm në pikat e ligjit. Avokati i Parë Gjeneral (dhe jo palët e involvuara!) mund të propozojë shqyrtimin e vendimit të Gjykatës së Përgjithshme, nëse rrezikohet entiteti ligjor ose njëtrajtshmëria e jurisprudencës.

### *Banka Qendrore Evropiane (Neni 129 dhe 130 TFEU)*

Banka Qendrore Evropiane, me seli në Frankfurt-am-Main, është në qendër të unionit ekonomik dhe monetar. Detyra e saj është të ruajë stabilitetin e

valutës së Evropës, euron, dhe të kontrollojë vlerën e valutës në qarkullim (Neni 128 TFEU).

Për të realizuar këtë detyrë, pavarësia e Bankës Qendrore Evropiane garantohet me një numër dispozitash ligjore. Gjatë ushtrimit të fuqive të veta ose gjatë realizimit të detyrave, as Banka Qendrore e Evropës dhe as ndonjë bankë nacionale nuk mund të marrë instruksione nga institucionet e Unionit, qeveritë e Shteteve Anëtare ose ndonjë organ tjetër. Institucionet e BE-së dhe qeveritë e Shteteve Anëtare nuk do të mundohen të ndikojnë mbi Bankën Qendrore të Evropës (Neni 130 TFEU).

Banka Qendrore Evropiane ka një Këshill Guvernatorësh dhe një Bord Ekzekutiv. Këshilli i Guvernatorëve përbëhet nga guvernatorët e bankave qendrore të 16 Shteteve Anëtare në zonën euro dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane. Bordi Ekzekutiv, i cili përbëhet nga Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe katër anëtarë të tjerë, është i autorizuar për të drejtuar Bankën Qendrore Evropiane. Presidenti dhe anëtarët emërohen nga persona me pozitë dhe eksperiencë në çështjet monetare ose bankare, me pajtim të përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare dhe në bazë të rekomandimit të Këshillit pas konsultimit me Parlamentin Evropian.

Mandati i tyre është tetë vjet, pa mundësi për ripërtrirje, dhe kjo është në interes të garantimit të pavarësisë të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv (Neni 283 TFEU).

Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (ESCB) përbëhet nga Banka Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore të Shteteve Anëtare (Neni 129 TFEU). Ai ka për detyrë të definojë dhe të implementojë politikën monetare të Unionit, dhe ka të drejtën ekskluzive të autorizojë çështjen e monedhave dhe banknotave në Union. Sistemi i bankave menaxhon edhe rezervat e valutës zyrtare të Shteteve Anëtare dhe garanton funksionimin e pandërprerë të sistemeve të pagesës (Neni 127(2) TFEU).

### ***Gjykata e Revizorëve (Nenet 285 dhe 286 TFEU)***

Gjykata e Revizorëve u themelua më 22 korrik 1975 dhe filloi të punojë në Luksemburg, në tetor 1977. Prej atëherë është ngritur në rang të institucionit të Unionit (Neni 13 TEU). Kjo gjykatë përbëhet nga 27 anëtarë, numër që korrespondon me numrin aktual të Shteteve Anëtare. Ata emërohen për gjashtë vjet nga Këshilli, i cili, me mazhorancë të kualifikuar dhe pas konsultimeve me Parlamentin Evropian, miraton listën e anëtarëve të zgjedhur

në pajtim me propozimet e Shteteve Anëtare (Neni 286(2) TFEU). Anëtarët zgjedhin Presidentin e Gjykatës të Revizorëve nga vet ata, me mandate tre vjeçar; Presidenti mund të rizgjidhet.

Detyra e Gjykatës së Revizorëve është të kontrollojë nëse të gjitha të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet janë pranuar – gjegjësisht janë bërë në mënyrë ligjore dhe të rregullt, si dhe të kontrollojë nëse menaxhimi financiar ka qënë i shëndoshë. Për dallim nga gjykatat e revizorëve ose organet e ngjashme në disa Shtete Anëtare, kjo gjykatë nuk ka juridiksion të vejë në fuqi masat e veta të kontrollit ose të hetojë dyshimet e parregullsisë që vjen nga hetimet e veta. Mirëpo, kjo gjykatë është plotësisht autonome në vendimet e veta, duke marrë parasysh se çka dhe si kontrollojnë ajo. Për shembull, mund të kontrollojë nëse shfrytëzimi i ndihmës financiare të Unionit nga individët, është në pajtim me ligjin e Komunitetit.

Municioni më i fuqishëm i armës së saj është fakti se ajo mund të publikojë vendimet e veta. Rezultatet e hetimeve të saj përmbledhen në një raport vjetor në fund të çdo viti financiar, i cili botohet në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* dhe kështu është i hapur për publikun. Ajo mund të bëjë edhe raporte speciale në çdo kohë, lidhur me fushat specifike të menaxhimit financiar, dhe këto gjithashtu publikohen në *Gazetën Zyrtare*.

## ORGANET KËSHILLDHËNËSE

### *Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social* (Neni 301 TFEU)

Qëllimi i Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (EESC) është të mundësojë përfaqësimin në ndonjë institucion të BE-së për grupet e ndryshme ekonomike dhe sociale (sidomos punëdhënësit dhe punëtorët, bujqit, transportuesit, afaristët, zanatçinjtë, menaxhuesit e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme). Komiteti gjithashtu ofron mundësi për konsumatorët, grupet dhe asociacionet e ambientit jetësor.

Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social përbëhet nga maksimum 350 anëtarë (këshilltarë), nga organizatat më reprezentative në Shtetet Anëtare individuale. Ata emërohen për pesë vjet nga Këshilli, i cili, njëzëshëm miraton listën e anëtarëve të zgjedhur, në pajtim me propozimet e çdo Shteti Anëtar.

Ndarja e këtyre ulëseve është si vijon <sup>(6)</sup>.

GJERMANIA	24
FRANCA	24
ITALIA	24
BRITANIA E MADHE	24
SPANJA	21
POLONIA	21
RUMANIA	15
BELGIKA	12
BULLGARIA	12
REPUBLIKA ÇEKE	12
GREQIA	12
HUNGARIA	12
HOLLANDA	12
AUSTRIA	12
PORTUGALIA	12
SUEDIA	12
DANIMARKA	9
IRLANDA	9
LITUANIA	9
SLLOVAKIA	9
FINLANDA	9
ESTONIA	7
LETONIA	7
SLLOVENIA	7
QIPROJA	6
LUKSEMBURGU	6
MALTA	5

Anëtarët janë të ndarë në tre grupe (punëdhënës, punëtorë dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile). Opinione të duhet të miratohen në seancat plenare, hartohen nga ‘grupet studiuëse’ të cilat përbëhen nga anëtarët e EESC-së

<sup>(6)</sup> Burimi: Ueb faqja e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social; 344 anëtarë në mars 2010.

(kuedhe zëvendësit e tyre mund të marrin pjesë si ekspertë). EESC-ja gjithashtu punon ngushtë me komitetet e Parlamentit Evropian.

EESC-ja, e cila u themelua nën Traktatet e Romës, në rrethana të caktuara duhet të konsultohet me Këshillin, i cili vepron pas propozimit të Komisionit. Ai gjithashtu jep opinione me iniciativën e vet. Këto opinione përfaqësojnë një sintezë të qëndrimeve ndonjëherë shumë divergjente dhe janë jashtëzakonisht të dobishme për Komisionin dhe Këshillin pasi që ato tregojnë se cilat ndryshime duan t'i shohin grupet që janë drejtpërsëdrejti të prekura nga një propozim. Opinione me iniciativë personale të EESC-së, në shumë raste kanë pasur implikime të mëdha politike, dhe një nga këta shembuj është ai më 22 shkurt 1989, mbi të drejtat themelore sociale në BE, të cilat përbënin bazën për “Kartën Sociale” të propozuar nga Komisioni (dhe të miratuar nga 11 Shtete Anëtare).

### ***Komiteti i Rajoneve (Neni 305 TFEU)***

Krahas EESC-së, me Traktatin e Bashkimit Evropian (Traktati i Mastrohrit) u themelua edhe një organ i ri këshilldhënës: Komiteti i Rajoneve (CoR). Ashtu si edhe EESC-ja, Komiteti i Rajoneve nuk është institucion krejtësisht i BE-së, pasi që funksioni i tij është vetëm këshilldhënës dhe nuk ka fuqi të japë vendime detyruese me ligj, në mënyrën e njëjtë si institucionet me të drejta të plota (Parlamenti Evropian, Këshilli, Komisioni Evropian, Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Revizorëve, Banka Qendrore Evropiane).

Ashtu si EESC-ja, Komiteti i Rajoneve përbëhet nga maksimum 350 anëtarë (?). Anëtarët janë përfaqësues të autoriteteve rajonale dhe lokale në Shtetet Anëtare, të cilët duhet doemos të kenë mandat në bazë të zgjedhjeve nga autoritetet që ata i përfaqësojnë, ose duhet që të jenë politikisht të besueshëm për ta. 350 ulëset u janë ndarë Shteteve Anëtare me përdorimin e peshës së njëjtë si për Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social. Anëtarët emërohen për pesë vjet nga Këshilli, i cili, duke vepruar njëzëshëm, miraton listën e anëtarëve, të hartuar në pajtim me propozimet e të gjitha Shteteve Anëtare. Anëtarët e Komitetit zgjedhin, nga vetë numri i tyre, kryesuesin me mandat dy vjeçar.

---

(?) Burimi: Ueb faqja e Komitetit të Rajoneve; 344 anëtarë në mars 2010.

Ekziston një numër i çështjeve për të cilat nevojitet konsultimi me Këshillin e BE-së ose me Komisionin Evropian ('konsultimi obligativ'): arsimi; kultura; shëndeti publik; rrjetet trans-Evropiane; transporti, telekomunikacioni dhe infrastruktura energjetike; kohezioni ekonomik dhe social; politika e punësimit dhe legjislacioni social. Këshilli gjithashtu konsultohet me Komitetin rregullisht, dhe pa ndonjë obligim ligjor, në lidhje me një numër të madh të propozim legjislativëve ('konsultimi jo-obligativ').

### **BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE (NENI 308 TFEU)**

Si agjenci financimi për një 'zhvillim të balancuar dhe stabil' të BE-së, Unioni ka në dispozicion të vet Bankën Evropiane të Investimeve (EIB), me seli në Luksemburg. Banka Evropiane e Investimeve mundëson kredi dhe garanca në të gjithë sektorët ekonomikë, sidomos në inkurajimin e zhvillimit të rajoneve më pak të zhvilluara, modernizimin apo transformimin e ndërmarrjeve ose krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e projekteve me interes të përbashkët për disa Shtete Anëtare.

Banka Evropiane e Investimeve ka strukturë tripjesëshe: udhëhiqet nga Bordi i Guvernorëve, i përbërë nga Ministrat e Financave të Shteteve Anëtare, i cili përcakton drejtimin e politikës kreditore dhe autorizon aktivitetet e Bankës Evropiane të Investimeve jashtë BE-së. Pas Bordit të Guvernorëve pason Bordi i Drejtorëve, i cili ka 28 anëtarë të plotë (një përfaqësues nga çdo Shtet Anëtar dhe një nga Komisioni Evropian) dhe 18 anëtarë zëvendës. Anëtarët zakonisht janë zyrtarë me përvojë më të gjatë, nga ministratë nacionale për çështje financiare ose ekonomike. Bordi i Drejtorëve merr vendime në lidhje me dhënien e kredive dhe garancave, si dhe lidhur me marrjen e kredive. Ai siguron faktin se banka administrohet në pajtim me udhëzimet e Bordit të Guvernorëve. Aktivitetet ditore të kësaj Banke udhëhiqen nga Komiteti Menaxhues, një organ ekzekutiv i përbërë nga nëntë persona që emërohen për mandat gjashtë vjeçar.

# Rendi ligjor i BE-së

Kushtetuta e BE-së e përshkruar më lartë, e sidomos vlerat fundamentale që i përmban, mund të jetësohen dhe mund të fitojnë gjallëri vetëm me të drejtën e Unionit. Kjo e bën BE-në një realitet ligjor në dy kuptime të ndryshme: është krijuar me ligj dhe është një komunitet i bazuar në ligj.

## BE-JA SI KRIJESË E LIGJIT DHE KOMUNITET I BAZUAR NË LIGJ

Kjo është një gjë krejtësisht e re për BE-në dhe gjë që e dallon atë nga përpjekjet e mëparshme për të bashkuar Evropën. Nuk funksionon me forcë ose nënshtrim por thjesht me ndihmën e ligjit. Ligji është i parapare të arrijë atë që ‘gjaku dhe hekuri’ dështuan ta realizojnë me shekuj të tërë. Sepse, vetëm bashkimi i bazuar në vendime të marra lirshëm, mund të jetë afatgjatë: uniteti i themeluar në vlerat fundamentale siç janë liria dhe barazia - të mbrojtura dhe të shndërruara në realitet me anë të ligjit. Ky është vështrimi themelor i Traktateve që krijuan Bashkimin Evropian.

Mirëpo, BE-ja nuk është thjesht një krijesë e ligjit; ajo ndjek objektivat e veta krejtësisht me anë të ligjit. Është një komunitet i bazuar në ligj. Jeta e përbashkët ekonomike dhe sociale e popujve të Shteteve Anëtare nuk qeveriset nga kërcënimi i forcës por nga e drejta e Unionit. Kjo është baza e sistemit institucional. Ky ligj përcakton procedurën e vendim-marrjes nga institucionet e Unionit dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre. Institucioneve u mundëson vegla – në formë të rregullativave, direktivave dhe vendimeve — për vënien në fuqi të instrumenteve ligjore, detyruese për Shtetet Anëtare dhe qytetarët e tyre. Kështu, individët bëhen fokusi kryesor i Unionit. Rendi ligjor i tij ndikon drejtpërsëdrejti në jetën e përditshme të individëve, në masë gjithnjë e më të madhe. U miraton të drejta dhe u imponon obligime, në mënyrë që, si qytetarë të Shtetit të tyre dhe të Unionit njëkohësisht, ata qeverisen nga një hierarki e urdhërave ligjore — një fenomen i njohur nga kushtetutat federale. Ashtu si çdo rend ligjor, ai i BE-së mundëson një sistem të pavarur të mbrojtjes ligjore për qëllime të kërkimit të ndihmës dhe zbatimin e të drejtës së Unionit. E drejta e Unionit gjithashtu definojnë marrëdhënien midis



BE-së dhe Shteteve Anëtare. Shtetet Anëtare duhet t'i marrin të gjitha masat e përshtatshme, që të garantojnë plotësimin e obligimeve që rrjedhin nga Traktatet ose nga ndonjë veprim i institucioneve të Unionit. Ato duhet të lehtësojnë realizimin e detyrave të BE-së dhe të abstenojnë nga masat që mund të rrezikojnë plotësimin e synimeve të Traktateve. Për çdo dëm që mund të shkaktohet me shkeljen e të drejtës së Unionit, Shtetet Anëtare u përgjigjen qytetarëve të BE-së.

## BURIMET LIGJORE TË TË DREJTËS SË UNIONIT

Shprehja 'burim ligjor' ka dy kuptime: në kuptimin origjinal, kjo shprehje i referohet arsyes për urgjencën e dispozitës ligjore, d.m.th. motivimi për krijimin e konstruktit ligjor. Sipas këtij definicioni, 'burimi ligjor' i të drejtës të Unionit është vullneti për ruajtjen e paqes dhe krijimi i një Evrope më të mirë me anë të lidhjeve më të ngushta ekonomike, dy gurthemelet e Komunitetit Evropian. Nga ana tjetër, në terminologjinë ligjore, 'burim ligjor' nënkupton origjinën dhe mishërimin e ligjit.

### BURIMET E TË DREJTËS SË UNIONIT

#### 1. LEGJISLACIONI PRIMAR

Traktatet e Unionit — Parimet e përgjithshme të ligjit

#### 2. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË BE-SË

#### 3. LEGJISLACIONI DYTËSOR

**Aktet legjislative**

Rregullativat — Direktivat — Vendimet

**Aktet jo-legjislative**

Aktet e deleguara — Aktet implementuese

**Aktet e tjera**

Rekomandimet dhe opinionet — Marrëveshjet ndër-institucionale —

Rezolutat, deklaratat dhe programet vepruese

#### 4. PARIMET E PËRGJITHSHME TË LIGJIT

#### 5. KONVENTAT MIDIS SHTETEVE ANËTARE

Vendimet e Coreper-it — Marrëveshjet ndërkombëtare

## **TRAKTATET THEMELUESE TË BE-SË SI BURIM PRIMAR I TË DREJTËS SË UNIONIT**

Burimi i parë i të drejtës së Unionit janë Traktatet themeluese të BE-së, me shtojcat e ndryshme dhe protokollat e bashkangjitura, si dhe plotësimet dhe ndryshimet e mëvonshme. Këto Traktate themeluese dhe instrumentet që i ndryshojnë apo i plotësojnë ato (kryesisht Traktatet e Mاستrihtit, Amsterdimit, Nicës dhe Lisbonës) dhe Traktatet e ndryshme për Anëtarësim përmbajnë dispozitat themelore mbi objektivat e BE-së, organizimin e tij dhe modus operandi (mënyrën e funksionimit), si dhe pjesë të të drejtës ekonomike të BE-së. Këto përbëjnë kornizën themeluese për funksionimin e BE-së, e pastaj reflektohen në interesat e Unionit, me anë të aktivitetetve legjislativ dhe administrative nga institucionet e Unionit. Traktatet, duke qënë instrumente ligjore të krijuara në mënyrë direkte nga Shtetet Anëtare, në qarqet ligjore njihen si e drejtë primare e Unionit.

## **INSTRUMENTET LIGJORE TË BE-SË SI BURIMI SEKONNDAR I TË DREJTËS SË UNIONIT**

Ligji i krijuar nga instrumentet e Unionit, me anë të ushtrimit të fuqive të transferuara në to, quhet legjislacioni dytësor – burimi i dytë me rëndësi i të drejtës së BE-së.

Ky ligj përmban akte legjislativ, akte të deleguara, akte implementuese dhe akte të tjera. ‘Aktet legjislativ’ janë akte ligjore të miratuara me procedurë të rregullt ose procedurë speciale legjislativ (Neni 289 TFEU). ‘Aktet e deleguara’ janë akte jo-legjislativ me zbatim të përgjithshëm dhe detyrues për plotësimin apo ndryshimin e disa elementeve jo-esenciale të një akti legjislativ. Ato i miraton Komisioni; akti legjislativ duhet të hartohet që në mënyrë eksplicite r’i delegojë fuqi Komisionit për këtë qëllim. Objektivat, përmbajtja, fushëveprimi dhe kohëzgjatja e delegimit të fuqive janë qartë të definuara në aktin legjislativ në fjalë. Ky delegim i fuqive mund të anulohet nga Këshilli ose Parlamenti Evropian në çdo kohë. Një akt i deleguar mund të hyjë në fuqi vetëm nëse nuk është kundërshtuar nga Parlamenti Evropian ose Këshilli, në periudhë të paraparë me aktin legjislativ (Neni 290 TFEU). ‘Aktet implementuese’ janë përjashtim i parimit, sipas të cilit të gjitha masat e nevojshme për implementimin e akteve ligjore detyruese të BE-së i marrin Shtetet Anëtare, në pajtim me dispozitat e tyre nacionale. Në rastet ku janë të nevojshme kushte të njëtrajtshme për implementimin e akteve ligjërish detyruese të BE-së, kjo bëhet me anë të akteve të përshtatshme implementuese, të cilat zakonisht i

miraton Komisioni, kurse në raste të veçanta, i miraton Këshilli. Megjithatë, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i hartojnë me kohë rregullat dhe parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me mekanizmat kontrolluese të Shteteve Anëtare të implementimit të fuqive të Këshillit (Neni 291 TFEU). Së fundi ekziston një sërë “aktesh të tjera ligjore” të cilat mund t’i përdorin institucionet e Unionit për të dhënë masa dhe deklarata jo-detyruese, ose të cilat rregullojnë funksionimin e brendshëm të BE-së ose institucioneve të saj, siç janë marrëveshjet ose aranzhimet midis institucioneve ose rregullat e brendshme të funksionimit.

Këto akte ligjore mund të marrin forma nga më të ndryshmet. Më të rëndësishmet nga këto janë të shënuara dhe të definuara në Nenin 288 TFEU. Si akte detyruese ligjore, ato përfshijnë dispozita të përgjithshme dhe abstrakte ligjore nga njëra anë dhe masa specifike dhe individuale në anën tjetër. Ato gjithashtu parashikojnë që institucionet e Unionit të lëshojnë deklarata jo-detyruese. Megjithatë, kjo listë e akteve është e pashtershme. Shumë akte të tjera ligjore nuk përshtaten në kategori të veçanta. Këto përfshijnë rezolutat, deklaratat, programet e veprimit ose Dokumentet e Bardha dhe të Gjelbërta. Ka dallime të konsiderueshme midis akteve të ndryshme në lidhje me procedurën e shfrytëzuar, me efektin e tyre ligjor dhe atyre që u janë adresuar; këto ndryshime do të trajtohen më hollësisht në seksionin mbi ‘mjetet e veprimit’.

Krijimi i legjislacionit sekondar të Unionit është një proces gradual. Shfaqja e tij i jep vitalitetin legjislacionit primar që rrjedh nga Traktatet e Unionit dhe në mënyrë progresive krijon dhe përmirëson rendin ligjor evropian.

### **MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË BE-SË**

Burimi i tretë i të drejtës të Unionit ka të bëjë me rolin e BE-së në nivel ndërkombëtar. Si një nga udhëheqësit botërorë, Evropa nuk mund të kufizohet vetëm me menaxhimin e çështjeve të veta të brendshme; duhet të merret me marrëdhëniet ekonomike, sociale dhe politike me botën e jashtme. Prandaj, në të drejtën ndërkombëtare, BE-ja lidh marrëveshje me shtetet jo-anëtare (shtetet e treta) dhe me organizata të tjera ndërkombëtare; dhe këto janë nga më të ndryshmet – nga traktatet për bashkëpunim të zgjeruar tregtar ose në fushat industriale, teknike dhe sociale, e deri në marrëveshjet mbi tregtinë e prodhimeve të veçanta.

Me rëndësi për t’u përmendur janë tre lloje marrëveshjeje midis BE-së dhe shteteve jo-anëtare.

### ***Marrëveshjet e asocimit***

Asocimi tejkalon rregulloren e thjeshtë të politikës tregtare dhe përfshin bashkëpunimin e ngushtë ekonomik dhe ndihmë të gjerë financiare nga BE-ja për shtetin e caktuar (Neni 217 TFEU). Ekzistojnë tre lloje të ndryshme të marrëveshjes së asocimit.

### **Marrëveshjet që mbajnë lidhje speciale midis disa Shteteve Anëtare dhe shteteve që nuk janë anëtare**

Një arsye e veçantë për krijimin e marrëveshjes për asocim ishte ekzistimi i shteteve dhe territoreve jashtë Evropës, me të cilat Belgjika, Danimarka, Franca, Italia, Holanda dhe Britania e Madhe kishin lidhje jashtëzakonisht të ngushta ekonomike, si trashëgimi e të kaluarës së tyre koloniale. Futja e tarifës së përbashkët të jashtme në BE, seriozisht do të ketë trazuar tregtinë me këto territore, gjë që nënkuptonte nevojën për marrëveshje speciale. Qëllimi i asocimit është të inkurajojë zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve dhe territoreve, dhe të themelojë marrëdhënie të ngushta ekonomike midis tyre dhe Unionit si tërësi (Neni 198 TFEU). Si rezultat i kësaj, ka një varg marrëveshjesh të privileguara, të cilat mundësojnë importin e mallërave nga këto shtete dhe territore, me tatime të zvogëluara ose krejtësisht pa tatime doganore. Ndihma financiare dhe teknike nga BE-ja kanalizohet përmes Fondit Evropian për Zhvillim. Pa dyshim marrëveshja më e rëndësishme në praktikë është Marrëveshja për Partneritet BE-ACP, midis BE-së dhe 70 shteteve nga Afrika, Karaibet dhe Paqësori ('ACP'). Kohëve të fundit, kjo marrëveshje u konvertua në një pako të marrëveshjeve të partneritetit ekonomik, duke u dhënë vendeve të ACP-së gradualisht qasje të lirë në tregun e brendshëm të Evropës.

### **Marrëveshjet si përgatitje për anëtarësim në BE ose themelim të Unionit Doganor**

Marrëveshjet për asocim gjithashtu shfrytëzohen për përgatitjen e shteteve për anëtarësim të mundshëm në Union. Marrëveshja shërben si etapë preliminare drejt anëtarësimit, gjatë së cilës shteti aplikues mund të punojë drejt bashkimit të ekonomisë së vet me atë të BE-së.

### **Marrëveshja për Zonën Ekonomike Evropiane (EEA)**

Marrëveshja për Zonën Ekonomike Evropiane sjell shtetet e (mbetura) në Asociacionin Evropian për Tregti të Lirë (EFTA) (Islanda, Lihtenshtajni dhe







Norvegjia), në tregun e brendshëm, dhe me atë që kërkon nga ato të përfshijnë së paku dy të tretat e legjislacionit të BE-së, shtron bazën e sigurtë për anëtarësim të mëvonshëm..Në bazë të *acquis communautaire* (organi i legjislacionit primar dhe dytësor të Unionit), në Zonën Ekonomike Evropiane duhet të ketë lëvizje të lirë të mallërave, personave, shërbimeve dhe kapitalit, rregulla të njëtrajtshme mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, si dhe bashkëpunim më të ngushtë lidhur me politikat horizontale dhe ato anësore (ambienti jetësor, hulumtimi dhe zhvillimi, arsimit).

### ***Marrëveshjet e bashkëpunimit***

Marrëveshjet e bashkëpunimit nuk janë aq gjithëpërfshirëse si marrëveshjet e asocimit, me atë që synojnë vetëm bashkëpunimin intenziv ekonomik. BE-ja, për shembull, ka marrëveshje të këtilla me Shtetet Magreb (Algeria, Maroko dhe Tunisi), dhe Shtetet Mashrek (Egjipti, Jordania, Libani dhe Siria) dhe me Izraelin.

### ***Marrëveshjet tregtare***

Unioni gjithashtu ka një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve tregtare me shtete individuale që nuk janë anëtare, me grupimin e këtyre vendeve ose me organizatat tregtare ndër-nacionale, lidhur me taksat doganore dhe politikën tregtare. Marrëveshjet më të rëndësishme ndërkombëtare për tregti janë: Marrëveshja themeluese e Organizatës Botërore Ndërkombëtare (Marrëveshja WTO) dhe marrëveshjet multilaterale tregtare që rrjedhin nga ajo, përfshirë këtu sidomos Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Taksat doganore dhe Tregtinë (GATT 1994); Përmbledhjes së ligjeve të Antidampingut dhe Subvencioneve, Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS); Marrëveshja mbi Aspektet Tregtare të të Drejtës të Pronësisë Intelektuale (TRIPS); dhe Kuptimi i Rregullave dhe Procedurave Qeverisëse për Zgjidhjen e Konfliktëve.

## **BURIMET E LIGJIT TË PASHKRUAR**

Burimet e të drejtës së Unionit të sqaruara deri më tani, ndajnë karakteristika të përbashkëta në atë se të gjitha ato bëjnë ligjin e shkruar. Ashtu si të gjitha sistemet e ligjit, rendi ligjor i BE-së nuk mund të përbëhet krejtësisht nga rregullat e shkruara: gjithnjë do të ketë mospërputhje e cila do të duhet të mbyllet me ligjin e pashkruar.

### *Parimet e përgjithshme të ligjit*

Burimet e pashkruara të të drejtës së Unionit janë parimet e përgjithshme të ligjit. Këto janë rregulla që pasqyrojnë konceptet elementare të ligjit dhe drejtësisë, të cilat duhet të respektohen nga çdo sistem ligjor. Ligji i shkruar i Unionit kryesisht merret vetëm me çështjet ekonomike dhe sociale, dhe ka mundësi të kufizuar të përcaktimit të rregullave të këtilla, gjë që nënkupton se parimet e përgjithshme të ligjit formojnë njërin nga burimet më të rëndësishëm të të drejtës në Union. Ato lejojnë mbylljen e zbrazëtirave dhe zgjidhen e çështjeve të interpretimit të ligjit ekzistues, në mënyrën më të drejtë.

Këto parime aktivizohen atëherë kur zbatohet ligji, sidomos në vendimet e Gjykatës së Drejtësisë, e cila ka obligim të garantojë se ‘në interpretimin dhe zbatimin e këtij Traktati, është respektuar ligji’. Pikat kryesore të referencës, që përkufizojnë parimet e përgjithshme të ligjit, janë parimet e përbashkëta në rendet ligjore të Shteteve Anëtare. Ato mundësojnë sfondin e nevojshëm, sipas të cilit mund të hartohen rregullat e BE-së të nevojshme për zgjidhjen e një problemi.

Krahas parimeve të autonomisë, zbatimi i drejtpërdrejtë dhe parësia e të drejtës të Unionit, parimet e tjera ligjore përfshijnë garancën e të drejtave themelore, parimin e proporcionalitetit, mbrojtjen e parashikimeve legjitime, të drejtën për dëgjim të duhur dhe parimin se Shtetet Anëtare përgjigjen për shkelje të ligjit të Unionit.

### *Përvoja ligjore*

Ligji i pashkruar i Unionit përfshin edhe përvojën ligjore. Kjo nënkuptohet si përvojë e ndjekur dhe e pranuar dhe kështu bëhet ligjërish e themeluar, e cila plotëson ose modifikon legjislacionin primar ose dytësor. Në parim, themelimi i mundshëm i përvojës ligjore në të drejtën e Unionit, pranohet. Mirëpo, ekzistojnë një numër kufizimesh lidhur me rrënjosjen e tij në kontekst të të drejtës së Unionit. Pengesa e parë është ekzistimi i një procedure speciale për ndryshimin e Traktateve (Neni 54 TEU). Kjo nuk përjashton urgjencën e mundshme të përvojës ligjore, mirëpo e vështirëson shumë kriteriumin sipas të cilit një përvojë duhet të jetë ndjekur dhe pranuar për një periudhë të caktuar. Një pengesë tjetër për themelimin e përvojës ligjore në institucionet e Unionit është fakti se çdo veprim i ndonjë institucioni mund të marrë validitetin e vet vetëm nga Traktatet, dhe jo nga performanca aktuale e atij institucioni ose synimet e tij për të krijuar marrëdhënie ligjore. Kjo nënkupton se në nivel të Traktateve,

në asnjë rrethanë, përvoja ligjore nuk mund të themelohet nga institucionet e Unionit; kryesisht, këtë mund ta bëjnë vetëm Shtetet Anëtare — dhe atë varësisht nga kushtet e rrepta të përmendura më lartë. Procedurat dhe përvojat e ndjekura dhe të pranuar si pjesë e ligjit nga institucionet e Unionit mund të shfrytëzohen gjatë interpretimit të rregullave ligjore të përcaktuara nga ato, gjë që mund të ndryshojë implikimet ligjore dhe fushëveprimin e aktit të caktuar ligjor. Mirëpo, kushtet dhe kufizimet që dalin nga legjislacioni primar i Unionit duhet gjithashtu të merren parasysh.

### *Marrëveshjet midis Shteteve Anëtare*

Burimi i fundit i të drejtës së BE-së përmban marrëveshjet midis Shteteve Anëtare. Marrëveshjet e këtij lloji mund të bëhen për zgjidhjen e çështjeve të lidhura ngushtë me aktivitetet e BE-së, mirëpo institucioneve të Unionit nuk u është transferuar asnjë fuqi; ekzistojnë edhe marrëveshje të plota ndërkombëtare (traktate dhe konventa) midis Shteteve Anëtare, të cilat kryesisht kanë për qëllim tejkalimin dhe tërheqjen e marrëveshjeve territorialisht të kufizuara dhe krijimin e ligjit të zbatueshëm në mënyrë të njëtrajtshme në mbarë BE-në. Kjo është me rëndësi, pikë së pari në fushën e të drejtës ndërkombëtare private. Këto marrëveshje përfshijnë: Konventën mbi Juridiksionin dhe Vënien në fuqi të vendimeve lidhur me Çështjet Civile dhe Komerciale (1968), e cila është zëvendësuar me një rregullativë të Këshillit në vitin 2001, përveç në rastin e Danimarkës, dhe prandaj tani është pjesë e legjislacionit dytësor të Unionit; Konventa mbi Njohjen Reciproke të Ndërmarrjeve dhe Personave Juridikë (1968); Konventa mbi Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë lidhur me Rregullimin e Transferimit të Profitit midis Ndërmarrjeve të Asocuara (1990) dhe Konventa mbi Ligjin që vlen për Obligimet Kontraktuale (1980).

### **MJETET VEPRUESE TË BE-SË**

Sistemi i akteve ligjore duhet të sajohet sërish pas themelimit të BE-së. Para së gjithash duhet të vendoset forma e legjislacionit të Unionit dhe cilat do të ishin efektet. Institucionet duhet të kishin mundësinë e harmonizimit të kushteve jo të barabarta ekonomike, sociale dhe ato të ambientit jetësor në Shtetet e ndryshme Anëtare, dhe ta bëjnë këtë në mënyrë efektive, d.m.th. duke mos u varur nga vullneti i mirë i Shteteve Anëtare, në mënyrë që të krijohen kushtet më të mira të mundshme të jetesës për të gjithë qytetarët e Unionit. Nga ana tjetër, ata nuk duhet të ndërhyjnë në sistemet vendore të ligjit, më shumë se sa ishte e nevojshme. Prandaj, i gjithë sistemi i BE-së bazohet në parimin se, ndërsa



marrëveshjet e njëjta – madje edhe në detaje – duhet të vlejnë në të gjitha Shtetet Anëtare, marrëveshjet nacionale duhet të zëvendësohen nga legjislacioni i Unionit. Mirëpo, aty ku kjo nuk është e nevojshme duhet të kërkohet përgjegjësia e duhur nga rendet ligjore ekzistuese të Shteteve Anëtare.

Në bazë të këtij sfondi u krijuan një varg instrumentesh, të cilat u mundësuan institucioneve të Unionit të ndikojnë në sistemet ligjore nacionale në shkallë të ndryshme. Hapi më drastik është zëvendësimi i rregullave nacionale me ato të Unionit. Ekzistojnë edhe rregulla të Unionit sipas të cilave institucionet e Unionit veprojnë në sistemet ligjore të Shteteve Anëtare, vetëm se në mënyrë indirekte. Mund të merren edhe masa që ndikojnë vetëm një person të definuar ose të identifikueshëm, për të trajtuar një rast të caktuar. Së fundi, ekziston dispozitë për aktet ligjore që nuk kanë fuqi detyruese, qoftë për Shtetet Anëtare apo për qytetarët e Unionit.

Nëse shohim vargun e instrumenteve ligjore të BE-së, sipas personave, të cilëve u adresohen dhe efektet e tyre praktike në Shtetet Anëtare, ato mund të pasqyrohen si vijon.

	<b>TË ADRESUAR</b>	<b>EFEKTET</b>
<b>RREGULLATIVA</b>	Të gjitha Shtetet Anëtare, personat fizikë dhe juridikë	Plotësisht të zbatueshme dhe detyruese në mënyrë direkte
<b>DIREKTIVA</b>	Të gjitha Shtetet Anëtare ose disa prej tyre	Detyruese sipas rezultatit të paramenduar
<b>VENDIMI</b>	Të gjitha Shtetet Anëtare ose disa prej tyre; persona të veçantë fizikë ose juridikë	Drejtëpërsëdrejti të zbatueshme vetëm në rrethana të veçanta
<b>REKOMANDIMI</b>	Të gjitha Shtetet Anëtare ose disa prej tyre, organe të tjera të BE-së, individuals	Jo detyruese
<b>AVIS</b>	Të gjitha Shtetet Anëtare ose disa prej tyre, organe të tjera të BE-së	Jo detyruese
	Nuk është përcaktuar	Jo detyruese

## RREGULLATIVAT SI ‘LIGJE’ TË UNIONIT

Aktet ligjore që mundësojnë imponimin e skajshëm të institucioneve të Unionit në sistemet ligjore vendore, janë rregullativat. Ato dallohen me dy karakteristika të pazakonshme në të drejtën ndërkombëtare.

- E para është natyra e tyre e përbashkët, që do të thotë se ato përcaktojnë ligjin e njëjtë në mbarë Unionin, pa marrë parasysh kufijtë ndërkombëtarë, dhe kanë zbatim të plotë në të gjitha Shtetet Anëtare. Një Shtet Anëtar nuk ka fuqi të zbatojë një rregullativë vetëm pjesërisht ose të zgjedhë vetëm ato dispozita, të cilat i miraton si mjet që garanton se një instrument të cilin e ka kundërshtuar në kohën e miratimit ose i cili vepron kundër interesave nacionale nuk ka hyrë në fuqi. As nuk mund të kërkojë dispozita ose përvoja të të drejtës nacionale për të parandaluar zbatimin e obligueshëm të rregullativës.
- E dyta është zbatueshmëria direkte, që do të thotë se aktet ligjore nuk duhet të kalojnë në ligj nacional, por duhet të transferojnë të drejtat ose t’i ngarkojnë qytetarët e Unionit me obligime, njëjloj siç bëhet me të drejtën nacionale. Shtetet Anëtare, institucionet e tyre qeverisëse dhe gjykatat detyrohen drejtpërsëdrejti nga e drejta e Unionit dhe duhet të pajtohen me të njëjloj si me të drejtën nacionale.

Ngjashmëritë midis akteve ligjore dhe të drejtës statutare të miratuara në Shtetet e veçanta Anëtare janë të pagabueshme. Nëse ato ratifikohen me involvimin e Parlamentit Evropian (sipas procedurës së vendim-marrjes së përbashkët — shih pjesën e ardhshme), ato përshkruhen si ‘akte legjislativë’. Parlamenti nuk mban përgjegjësi për rregullativat, të cilat ratifikohen vetëm nga Këshilli ose Komisioni Evropian, dhe kështu, së paku nga pikëpamja procedurale, atyre u mungojnë karakteristikat themelore të legjislativës të këtij lloji.

## DIREKTIVAT

Direktiva është instrumenti më i rëndësishëm legjislativ krahas rregullativës. Qëllimi i saj është pajtimi i objektivave të dyfishta të sigurimit uniform, të domosdoshëm për të drejtën e Unionit dhe respektimit të shumëllojshmërisë të traditave dhe strukturave nacionale. Atë që synon direktiva në radhë të parë, nuk është unifikimi i ligjit – gjë që është qëllimi i rregullativës, por harmonizimi i tij. Ideja është të hiqen kontradiktat dhe konfliktet midis ligjeve

dhe rregullativave nacionale ose sheshimi i mospërputhjeve, për aq sa është e mundur, në mënyrë që të ekzistojnë kushtet e njëjta materiale në të gjitha Shtete Anëtare. Direktiva është një nga mjetet primare të pozicionuara për ndërtimin e tregut unik.

Një direktivë është detyruese për Shtetet Anëtare, kur bëhet fjalë për synimin që duhet arritur, mirëpo i len autoritetet nacionale të vendosin se si të inkorporohet një synim i miratuar i komunitetit në sistemet e tyre vendore. Arsyetimi prapa kësaj forme të legjisllacionit është se, lejon intervenimin në mënyrë që strukturat ekonomike dhe ligjore vendore të marrin formë më të butë. Shtetet Anëtare mund të marrin parasysh rrethanat e veçanta vendore kur implementojnë rregullat e Komunitetit. Ajo që ndodh është se direktiva nuk zëvendëson ligjet e Shteteve Anëtare nën obligimin e miratimit të ligjeve të tyre nacionale, në pajtim me dispozitat e Komunitetit. Rezultati është zakonisht një proces i krijimit të ligjeve në dy etapa.

Së pari, në etapën fillestare, direktiva përcakton synimin që duhet arritur në nivel të BE-së, nga cilido ose nga të gjitha Shtetet Anëtare, të cilave u është adresuar në suaza të një kornize të caktuar kohore. Institucionet e Unionit mund të thonë haptaz synimin në kushte të detajuara, për të mos u lënë Shteteve Anëtare hapësirë për të manovruar, dhe kjo është bërë në direktivat mbi standardet teknike dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.

Së dyti, në nivel nacional, objektiva e përcaktuar në nivel të BE-së shndërron në dispozitë aktuale ligjore ose administrative në Shtetet Anëtare. Edhe pse Shtetet Anëtare janë, në parim, të lira të caktojnë formën dhe metodat e shfrytëzuara për zhvendosjen e obligimeve të tyre ndaj BE-së në ligjin vendor, kriteret e BE-së shfrytëzohen për të vlerësuar nëse ato janë bërë në pajtim me ligjin e BE-së. Parimi i përgjithshëm është se duhet të krijohet një situatë ligjore, ku të drejtat dhe obligimet e dalura nga direktiva mund të njihen me qartësi dhe siguri të mjaftueshme për t'i mundësuar qytetarit të Unionit t'i kundërshtojë ose, nëse është e përshtatshme, të sfidojë ato në gjykatat nacionale. Kjo zakonisht përfshin miratimin e dispozitave obligative të ligjit nacional ose të anulojë apo të ndryshojë rregullat ekzistuese. Normat administrative si të tilla, nuk janë të mjaftueshme pasi që, sipas natyrës së tyre, mund të ndryshojnë sipas vullnetit, nga autoritetet e caktuara; dhe nuk kanë as strukturë të mjaftueshme.

Direktivat, zakonisht nuk ua kalojnë të drejtat dhe as nuk ngarkojnë qytetarët e Unionit me obligime. Ato u adresohen vetëm Shteteve Anëtare. Të drejtat dhe obligimet për qytetarët rrjedhin vetëm prej masave të miratuara nga autoritetet e Shteteve Anëtare për implementimin e direktivës. Kjo pikë nuk është e rëndësishme për qytetarët, përderisa Shtetet Anëtare arrijnë të pajtohen me obligimin e vet ndaj Unionit. Mirëpo ekzistojnë dëme për qytetarët e Unionit aty ku një Shtet Anëtar nuk i ndërmer masat e nevojshme për arritjen e një synimi të përcaktuar në direktivë, nga i cili do të përfitonin, ose nëse masat nuk janë adekuate. Gjykata e Drejtësisë ka refuzuar të tolerojë disavantazhet e këtilla, dhe një numër i madh i rasteve kanë vendosur se në raste të këtilla, qytetarët e Unionit mund të ankohen se direktiva ose rekomandimi ka efekt direkt mbi veprimet në gjykatat nacionale, për të siguruar të drejtat e transferuara nga vet ajo. Gjykata definon efektin direkt në këtë mënyrë.

- Dispozitat e direktivës duhet të përcaktojnë të drejtat e qytetarit/ndërmarrjes të BE-së me qartësi dhe precizitet të mjaftueshëm.
- Ushtrimi i të drejtave nuk është i kushtëzuar.
- Autoritetet e legjislativës nacionale mund të mos kenë hapësirë të manovrojnë lidhur me përmbajtjen e rregullave që duhen miratuar.
- Koha e lejuar për implementimin e direktivave ka skaduar.

Vendimet e Gjykatës të Drejtësisë që kanë të bëjnë me efektin direkt, bazohen në qëndrimin e përgjithshëm se Shteti Anëtar vepron në mënyrë të paqartë dhe të paligjshme, nëse zbaton ligjin e vet të vjetër pa e adaptuar atë me kërkesat e direktivës. Ky është keqpërdorim i të drejtave nga Shteti Anëtar dhe njohja e efektit të drejtpërdrejtë të direktivës kërkon të luftojë atë duke garantuar se Shteti Anëtar nuk nxjerr asnjë beneficion nga shkelja e të drejtës së Unionit. Kështu, efekti i drejtpërdrejtë ka efektin e ndëshkimit të Shtetit Anëtar ofendues. Në këtë kontekst, është me rëndësi që Gjykata e Drejtësisë të ketë zbatuar parimin vetëm në raste midis qytetarit dhe Shtetit Anëtar, dhe atë vetëm nëse direktiva është në favor të qytetarit e jo në dëm të tij — me fjalë të tjera, kur qëndrimi i qytetarit në suaza të ligjit, sipas ndryshimit të direktivës, është më i favorshëm në krahasim me qëndrimin sipas ligjit të vjetër (i njohur si ‘efekti direkt vertikal’). Mirëpo, zbatimi i efektit direkt vertikal i një direktive në favor të një individi, mund të jetë në dëm të

individit tjetër (direktiva e efektit të dyfishtë, e cila shpesh gjindet në ligjin për furnizim dhe për ambient jetësor). Ky dëm duhet të konsiderohet si refleks ligjor negativ, i cili pashmangshëm i ka rrënjët nga obligimi i Shtetit Anëtar për të përputhur rendin e tyre ligjor me synimet e direktivës në fund të periudhës së zhvendosjes; nuk ka dëm tjetër që shkaktohet me njohjen e efektit vertikal të direktivave.

Efekti direkt i direktivave në marrëdhëniet midis vetë qytetarëve ('efekti direkt horizontal') nuk është pranuar nga Gjykata e Drejtësisë. Gjykata vendos nga natyra penale e parimit se nuk është i zbatueshëm për marrëdhëniet midis individëve, pasi që nuk mund të përgjigjet për pasojat e dështimit të Shtetit Anëtar për të vepruar. Aty ku qytetari duhet të mbështetet është siguria në ligj dhe mbrojtja e pritjeve legjitime. Qytetari duhet të ketë mundësi të mbështetet në efektin e direktivës që arrihet nga masat implementuese nacionale. Megjithatë, në rastin e fundit të praksës së vet ligjore, Gjykata e Drejtësisë ka zbutur mospranimin e efektit të drejtpërdrejtë të të drejtës së direktivës në çështjet e të drejtës private. Kjo është e kufizuar në situatë ku një palë kontraktuese kërkon të drejtën që rrjedh nga direktiva, kundër të drejtës së palës tjetër që rrjedh nga ligji nacional. Kjo hap rrugën drejt zbatimit horizontal të dispozitave të zbatueshme në mënyrë direkte, në situata siç janë pajtimi me të drejtën nacionale objektive (për shembull, kur një ndërmarrje dëshiron të obligojë një konkurrent të respektojë të drejtën nacionale, e cila shkel ligjin e direktivës) ose implementimin e obligimeve të të drejtës nacionale, të cilat kundërshtojnë zbatimin e direktivës (siç është refuzimi i përmbushjes së një kontrate me kërkesën e dispozitave ndaluese nacionale që shkelin ligjin e direktivës).

Efekti direkt i direktivës nuk nënkupton medoemos se një dispozitë e direktivës ia kalon të drejtat një individi. Në fakt, dispozitat e direktivës kanë efekt të drejtpërdrejtë ashtu si që kanë efektin e ligjit objektiv. Kushtet e njëjta vlejnë për njohjen e këtij efekti si për njohjen e efektit direkt, me përjashtimin e vetëm se, në vend të ligjit të qartë dhe preciz të përcaktuar për qytetarin ose ndërmarrjen e Unionit, hartohet një obligim i qartë dhe preciz për Shtetet Anëtare. Në këto raste, të gjitha institucionet, d.m.th. legjislatori, administrata dhe gjykatat e Shteteve Anëtare, janë të detyruara me direktivë dhe automatikisht duhet të pajtohen me atë dhe të zbatojnë atë si të drejtë të Unionit me përparësi. Konkretisht thënë, ato gjithashtu kanë obligim të interpretojnë të drejtën nacionale, në pajtim me direktivat ose t'i japin dispozitës së direktivës në fjalë prioritet të zbatimit para ligjit

kundërshtues nacional. Veç kësaj, direktivat kanë efekte të caktuara kufizuese ndaj Shteteve Anëtare — madje edhe para përfundimit të periudhës së zhvendosjes. Lidhur me natyrën detyruese të direktivës dhe detyra e saj për realizimin e detyrave të Unionit (Neni 4 TEU), para përfundimit të periudhës së zhvendosjes, Shtetet Anëtare mund të abstenojnë nga të gjitha masat që mund të rrezikojnë arritjen e synimit të direktivës.

Në vendimet e veta në rastin *Francoovich* dhe *Bonifaci* në vitin 1991, Gjykata e Drejtësisë konsideron se Shtetet Anëtare kanë përgjegjësinë për të paguar dëmet kur ato shkaktohen si rezultat i dështimit të zhvendosjes së plotë apo të pjesërishtme të direktivës. Të dyja rastet ishin kundër Italisë, për dështim të zhvendosjes me kohë të Direktivës së Këshillit 80/987/EEC, nga 20 tetori 1980, lidhur me mbrojtjen e të punësuarve në rast të falimentimit të punëdhënësit, sipas të cilës mbrohen të drejtat e të punësuarve për pagesë në periudhën para falimentimit dhe shkarkimit nga puna për shkak të falimentimit. Për këtë qëllim, fondet garantuese duhej të themelohen me mbrojtjen e kreditorëve; ato duhej të financohen nga punëdhënësit, autoritetet publike ose të dyja. Problemi më të cilin përballë Gjykata ishte se, edhe pse synimi i direktivës ishte t'u transferojë punëtorëve të punësuar të drejtën për pagesë të vazhdueshme nga fondet garantuese, kjo e drejtë nuk mund të merrte efektin direkt nga gjykatat nacionale, gjë që nënkuptonte se ato nuk mund ta miratojnë atë kundër autoriteteve nacionale, pasi që në mungesë të masave që zhvendosin direktivën nuk ishte themeluar fondi garantues dhe nuk ishte e mundur të përcaktohet kush ishte borxhliu në lidhje me falimentimin. Gjykata vendosi se, me dështimin e implementimit të direktivës, Italia kishte privuar punëtorët në fjalë nga të drejtat e tyre dhe rrjedhimisht mbante përgjegjësinë e dëmshpërblimit. Edhe pse obligimi i kompensimit nuk është i shkruar në ligjin e Unionit, Gjykata e Drejtësisë e sheh si pjesë përbërëse të rendit ligjor të BE-së, pasi që efekti i plotë i tij nuk do të sigurohet dhe të drejtat e transferuara nga ai obligim nuk do të ishin mbrojtur nëse qytetarët e Unionit nuk e kishin mundësinë e kërimit dhe fitimit të kompensimit për shkeljen e të drejtave të tyre nga Shtete Anëtare, të cilat veprojnë në kundërshtim me të drejtën e BE-së.

## VENDIMET

Kategoria e tretë e akteve ligjore të BE-së është ajo e vendimeve. Në disa raste, institucionet e Unionit mund të mbajnë përgjegjësinë e implementimit të Traktateve dhe rregullativave, dhe kjo do të jetë e mundur vetëm nëse ato



2 dhe 3 dhjetor 1985, Luksemburg.  
Në prapaskenën e Këshillit Evropian, evropianët federalistë demonstrojnë në favor të Bashkimit Evropian dhe për heqjen e kufijve, gjë që nuk do të zbatohet midis disa vendeve edhe për 10 vjet të tjera.

mund të marrin masa detyruese për individë, veprime apo Shtete të caktuara Anëtare. Situata në sistemet e Shteteve Anëtare është pak a shumë e njëjtë; legjislacioni do të zbatohet nga autoritetet në një rast individual, me anë të vendimit administrativ.

Në rendin ligjor të BE-së, këtë funksion e marrin vendimet, të cilat janë zakonisht mjetet në dispozicion për institucionet e Unionit për të urdhëruar që një masë të merret në një rast individual. Institucionet e Unionit mund të kërkojnë që një Shtet Anëtar ose një individ të bëjë një veprim apo t'i shmanget atij, ose mund të kalojë të drejtat apo obligimet mbi ata.

Karakteristika themelore e një vendimi mund të përmblihet si vijon.

- Ai dallon nga rregullativa duke pasur zbatueshmëri individuale: personat të cilëve u adresohet duhet të emërohen në të dhe janë të vetmit që kanë detyrime sipas tij. Kjo kërkesë plotësohet, në kohën kur jepet vendimi, kategoria e të adresuarve mund të identifikohet dhe mund të mos zgjerohet. Përmbajtjes aktuale të vendimit i jepet referencë, në mënyrë që të ketë ndikim direkt dhe individual në situatën e qytetarit. Madje edhe pala e tretë mund të përfshihet në suaza të definicionit nëse, për shkak të kualiteteve ose rrethanave personale që i dallojnë ata nga të tjerët, ata ndikohen individualisht dhe janë të identifikueshëm si të tillë, në mënyrë të njëjtë si të adresuarit.
- Vendimi dallohet nga direktiva për faktin se është krejtësisht detyrues (kurse direktiva thjesht përcakton objektivën që duhet arritur).
- Vendimi është drejtpërdrejt detyrues ndaj atyre të cilëve u adresohet. Një vendim i adresuar një Shteti Anëtar, në fakt mund të ketë efektin e njëjtë të drejtpërdrejtë lidhur me qytetarin si direktivë.

## REKOMANDIMET DHE OPINIONET

Një kategori përfundimtare e masave ligjore detajuara në mënyrë eksplicite në Traktate janë rekomandimet dhe opinionet. Ato u mundësojnë institucioneve të Unionit të japin mendimin e tyre një Shteti Anëtar, dhe në disa raste qytetarëve individualë, gjë që nuk është detyruese dhe nuk ngarkon asnjë obligim ligjor mbi të adresuarin.



Në rekomandime, pala të cilës i adresohen ato thirret por nuk ngarkohet me asnjë obligim ligjor, për të vepruar në mënyrë të caktuar. Për shembull, në rastet ku miratimi ose ndryshimi i një dispozite ligjore ose administrative në një Shtet Anëtar shkakton shfytyrim të konkurrencës në tregun e brendshëm të Evropës, Komisioni mund t'i rekomandojë Shtetit të caktuar masa të përshtatshme për të shmangur këtë shtrembërim (Neni 117(1), fjalia e dytë, TFEU).

Nga ana tjetër, institucionet e Unionit i japin opinionet, në rastet kur duhet dhënë një vlerësim për një situatë të caktuar apo për zhvillimet në Union ose në Shtetet individuale Anëtare. Në disa raste, ato gjithashtu trastrojnë rrugën për aktet e mëvonshme ligjore detyruese, ose janë parakusht për institucionin e proceseve gjyqësore para Gjykatës së Drejtësisë (Neni 258 dhe 259 TFEU).

Rëndësia e vërtetë e rekomandimeve dhe opinionëve është politike dhe morale. Për hartimin e akteve të këtyra ligjore, hartuesit e Traktateve kishin paraparë se, duke marrë parasysh autoritetin e institucioneve të Unionit si dhe pikëpamjen e tyre dhe njohjen e kushteve përtej kornizës së ngushtë nacionale, të involvuarit do të duhej të pajtohen vullnetarisht me rekomandimet e adresuara për ata dhe do të reagonin në mënyrë të duhur në vlerësimin e institucioneve të Unionit për një situatë të veçantë. Mirëpo, rekomandimet dhe opinionet mund të kenë efekt ligjor indirekt ku ato janë preliminare për instrumentet e mëpasme obligative ose aty ku institucioni që i jep ato është përkushtuar, duke dhënë parashikime legjitime që duhen plotësuar.

## REZOLUTAT, DEKLARATAT DHE PROGRAMET E VEPRIMIT

Krahas akteve ligjore të parapara në Traktate, institucionet e Unionit gjithashtu kanë një varg formash të tjera të veprimit për formulimin dhe formësimin e rendit ligjor të BE-së. Më të rëndësishmet nga këto janë rezolutat, deklaratat dhe programet e veprimit.

*Rezolutat:* Këto mund t'i lëshojë Këshilli Evropian, Këshilli dhe Parlamenti Evropian. Ato përcaktojnë qëndrimet e përbashkëta dhe planifikimet që kanë të bëjnë me procesin e përgjithshëm të integritimit dhe detyrat specifike përbrenda dhe jashtë BE-së. Rezolutat që kanë të bëjnë me punën e brendshme të BE-së interesohen, për shembull, lidhur me çështjet elementare lidhur me unionin politik, politikën rajonale, politikën energjetike dhe unionin ekonomik dhe monetar (sidomos Sistemi Evropian Monetar). Rëndësia

primare e këtyre rezolutave është se ato ndihmojnë që punës së ardhshme të Këshillit t'i japin drejtim politik. Si manifestim i vullnetit të përbashkët politik, rezolutat lehtësojnë shumë arritjen e konsenzusit në Këshill, dhe krahas kësaj ato garantojnë së paku një shkallë minimale të korelacionit midis hierarkive të vendim-marrjes në Komunitet dhe në Shtetet Anëtare. Çdo vlerësim i rëndësishëm i tyre ligjore duhet doemos të marrë parasysh këto funksione, d.m.th. ato duhet të mbeten instrument fleksibil dhe nuk duhet të lidhen me shumë kërkesa dhe obligime ligjore.

*Deklaratat:* Ekzistojnë dy llojë të ndryshme të deklaratave. Nëse një deklaratë ka të bëjë me zhvillimin e mëtejshëm të Unionit, si për shembull Deklarata për BE-në, Deklarata për Demokraci dhe Deklarata për të Drejtat dhe Liritë Fundamentale, atëherë ajo është pak a shumë e barasvlefshme me një rezolutë. Deklaratat e këtij lloji, kryesisht kanë për qëllim të përfshijnë një audiencë të madhe ose një grup specifik të të adresuarve. Lloji tjetër i deklaratës jepet në kontekst të procesit të vendim-marrjes në Këshill dhe përcakton qëndrimet e të gjithë anëtarëve ose individëve të Këshillit, lidhur me interpretimin e vendimeve të Këshillit. Deklaratat interpretuese të këtij lloji janë praksë standarde në Këshill dhe janë një mjet esencial i arritjes së kompromiseve. Rëndësia e tyre ligjore duhet të vlerësohet nën parimet elementare të interpretimit, sipas të cilave faktori kryesor në interpretimin e kuptimit të dispozitës ligjore duhet në të gjitha rastet të jetë parashikimi themelor i krijuesit të tij. Ky parim është valid vetëm nëse deklarata fiton vëmendjen e nevojshme publike; kjo është për shkak se, për shembull, legjislationi dytësor i Unionit që u jep të drejta direkte individëve nuk mund të kufizohet me marrëveshje dytësore që nuk janë bërë publike.

*Programet vepruese:* Këto programe i harton Këshilli dhe Komisioni me iniciativën e vet ose me iniciativën e Këshillit Evropian dhe shërbejnë për implementimin e programeve legjislativë dhe synimeve të përgjithshme të parapara në Traktate. Nëse një program është i paraparë në mënyrë të veçantë në Traktate, institucionet e Unionit kanë detyrime ndaj këtyre dispozitave, gjatë planifikimit të programit. Në Union, këto programe publikohen në formë të Dokumenteve të Bardha. Nga ana tjetër, programet e tjera, në praksë konsiderohen thejsh si udhëzime të përgjithshme pa efekt detyrues ligjor. Megjithatë, ato janë tregues i veprimeve të planifikuara të institucioneve të Unionit. Programet e këtilla publikohen në Union si Dokumente të Gjelbërta.

## PUBLIKIMI DHE KOMUNIKIMI

Aktet legjislativë në formë të rregullativave, direktivave të adresuara për të gjitha Shtetet Anëtare dhe vendimet që nuk përcaktojnë se për kë janë të adresuara, publikohen në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* (Seria L = Legjislacion). Ato hyjnë në fuqi, në datën e definuar ose, nëse nuk përmbajnë një datë specifike, hyjnë në fuqi në ditën e 20-të pas publikimit.

Aktet jo-legjislativë të miratuara në formë të rregullativave, direktivave ose vendimeve, në rastet kur nuk janë të përcaktuara se kujt i drejtohen, i nënshkruan Presidenti i institucionit që i ka miratuar ato. Ato botohen në *Gazetën Zyrtare* (Seria C = Komunikim).


Direktivat e tjera dhe vendimet që përcaktojnë se kujt i adresohen, ju bëhen me dije atyre të cilëve u adresohen dhe hyjnë në fuqi menjëherë pas këtij informimi.

Nuk ekziston obligimi për të publikuar apo komunikuar instrumente jodetyruese, mirëpo edhe ato zakonisht publikohen në *Gazetën Zyrtare* si ('Notices').

## PROCESI LEGJISLATIV NË BE

Ndërsa në një shtet, vullneti i njerëzve zakonisht shprehet në parlament, rolin vendimtar për të shprehur vullnetin e BE-së, një kohë të gjatë e kishin përfaqësuesit e qeverive të Shteteve Anëtare në mbledhjet e Këshillit. Kjo ishte thjesht pasi që BE-ja nuk përbëhet nga një 'popull evropian' por ekzistenca dhe forma e BE-së është falë kontributit të Shteteve Anëtare. Këto shtete nuk ia transferuan vetëm një pjesë të sovranitetit të tyre BE-së, por e bashkuan atë me dijeninë se do të mbanin fuqinë e përbashkët për ta ushtruar. Mirëpo, pasi që procesi i integritit të Unionit është zhvilluar dhe është thelluar, kjo ndarje e fuqive në procesin vendim-marrës të BE-së, fillimisht e përshtatur për mbrojtjen e interesave nacionale nga Shtetet Anëtare, ka evoluar diçka shumë më të balancuar, me rritje të vazhdueshme të statusit të Parlamentit Evropian. Procedura origjinale ku Parlamenti vetëm konsultohej, pikësisht u zgjerua për të përfshirë bashkëpunimin me Këshillin, kurse Parlamentit përfundimisht i ishte dhënë fuqia e bashkë-vendosjes në procesin legjislativ të BE-së.

**KOMITETI I MBLEDHUR NGA KËSHILLI/ PARLAMENTI**



Me Traktatin e Lisbonës këto fuqi bashkëvendosëse të Parlamentit u bënë ‘procedura të zakonshme legjislativë’, d.m.th. ‘rregulli i përgjithshëm’, dhe kështu shtuan kredencat demokratike të BE-së. Procedura e bashkëvendosjes, me miratimin e përbashkët të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, përmban një rregullativë, direktivë ose vendim për një propozim të Komisionit. Vetëm në disa raste eksplicite miratimi i një rregullative, direktive ose vendimi nga Parlamenti Evropian me pjesëmarrjen e Këshillit, ose vendim i Këshillit me pjesëmarrjen e Parlamentit Evropian, përmban një procedurë special legjislativë. Veç këtyre procedurave legjislativë, është edhe ‘procedura e miratimit’, e cila i jep Parlamentit Evropian vendimin përfundimtar lidhur me hyrjen në fuqi të instrumentit ligjor, dhe ‘procedura e thjeshtësuar’, e cila përdoret kur jepen instrumente jo-detyruese, vetëm nga një institucion i BE-së.

### ***Rrjedha e procedurës***

#### **Etapa e formulimit**

Në parim, makineria vihet në lëvizje nga Komisioni, i cili harton një propozim që të merret masa e Unionit (e njohur si ‘e drejta e iniciativës’). Propozimi përgatitet nga departamenti i Komisionit që merret me këtë fushë specifike; shpesh herë, në këtë fazë, departamenti do të konsultojë edhe ekspertët nacionalë. Kjo ndonjëherë merr formën e shqyrtimit në komitetet speciale; mundësia tjetër është që ekspertët mund të parashtrajnë pyetje përmes departamenteve relevante të Komisionit. Mirëpo, Komisioni nuk është i obliguar të pranojë këshillën e ekspertëve nacionalë atëherë kur i harton propozimet e veta. Propozimi i hartuar nga Komisioni, i cili përcakton përbërjen dhe formën e masës deri në hollësinë e fundit, shkon para Komisionit si i plotë, ku për miratim i mjafton mazhoranca e thjeshtë. Tani quhet ‘Propozim i komisionit’ dhe njëkohësisht i dërgohet Këshillit dhe Parlamentit Evropian dhe, në rastet ku kërkohet konsultim, i dërgohet Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, me shënime të hollësishme sqaruese.

#### **Leximi i parë në Parlament dhe në Këshill**

Presidenti i Parlamentit Evropian ia kalon propozimin komitetit koordinues Parlamentar për shqyrtim të mëtejshëm. Rezultati i vendimeve të komitetit diskutohet në seancën plenare të Parlamentit, dhe përcaktohet në një opin-

ion që mund të pranojë ose të refuzojë propozimin, apo edhe të propozojë ndryshime. Parlamenti pastaj ia dërgon qëndrimin e vet Këshillit.

Këshilli tani mund të veprojë si vijon në leximin e parë.

- Nëse e miraton qëndrimin e Parlamentit, akti miratohet në formë të këtij qëndrimi; kjo shënon përfundimin e procesit legjislativ.
- Nëse Këshilli nuk miraton qëndrimin e Parlamentit, ai e miraton pozitën nga leximi i parë dhe ia komunikon atë Parlamentit Evropian.

Këshilli informon plotësisht Parlamentin Evropian mbi arsyet që shpjen drejt miratimit të këtij qëndrimi. Komisioni informon plotësisht Parlamentin Evropian mbi qëndrimin e vet.

### **Leximi i dytë në Parlament dhe në Këshill**

Nga momenti i komunikimit të qëndrimit të Këshillit, Parlamenti Evropian ka tre muaj për të bërë një nga këto, si vijon:

- (1) të miratojë qëndrimin e Këshillit ose të mos marrë vendim; akti në fjalë atëherë konsiderohet se është miratuar, me terminologjinë që përputhet me qëndrimin e Këshillit;
- (2) të refuzojë, me mazhorancë të anëtarëve të tij përbërës, qëndrimin e Këshillit; akti i propozuar atëherë konsiderohet se nuk është miratuar dhe procesi legjislativ përfundon;
- (3) me shumicën e deputetëve të vet të bëjë ndryshime në qëndrimin e Këshillit; dhe kështu teksti i ndryshuar i dërgohet Këshillit dhe komisionit, i cili jep një opinion lidhur me ato ndryshime.

Këshilli diskuton qëndrimin e ndryshuar dhe nga data e pranimit të ndryshimeve të Parlamentit, ka tre muaj kohë ta bëjë një nga këto veprime në vijim.

- (1) Mund të miratojë ndryshimet e Parlamentit; akti në fjalë konsiderohet se është pranuar. Mazhoranca e kualifikuar është e mjaftueshme nëse edhe Komisioni pajtohet me ndryshimet; nëse jo, Këshilli mund të miratojë ndryshimet e Parlamentit vetëm njëzëshëm.

- (2) Mund të zgjedhë të mos miratojë të gjitha ndryshimet e Parlamentit ose nuk fiton mazhorancën e nevojshme; nga kjo rrjedh një procedurë pajtimi.

### **Procedura rregullative**

Procedura rregullative inicohet nga Presidenti i Këshillit, në pajtim me Presidentin e Parlamentit Evropian. Në qendër të kësaj procedure është Komiteti Rregullativ, i cili aktualisht përbëhet nga 27 përfaqësues, si nga Këshilli ashtu edhe nga Parlamenti Evropian. Komiteti i Pajtimit ka detyrë që të arrijë marrëveshje me mazhorancë të kualifikuar, lidhur me një tekst të përbashkët, për periudhë gjashtë javëshe pas mbledhjes, në bazë të qëndrimeve të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në leximin e dytë.

Komisioni merr pjesë në procedurat e Komitetit të Pajtimit dhe i merr të gjitha iniciativat me qëllim të përputhjes së pozitive të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Nëse, përbrenda gjashtë javësh nga momenti i mbajtjes së mbledhjes, Komiteti i Pajtimit nuk e miraton tekstin e përbashkët, akti i propozuar konsiderohet se nuk është miratuar.

### **Leximi i tretë në Parlament dhe në Këshill**

Nëse, në periudhë gjashtë javëshe, Komiteti i Pajtimit miraton tekstin e përbashkët, Parlamenti Evropian, duke vepruar me mazhorancën e votave, dhe Këshilli, duke vepruar me mazhorancë të kualifikuar, të gjitha kanë periudhë gjashtë javëshe nga ky miratim, gjatë të cilës duhet të miratojnë aktin në fjalë, në pajtim me tekstin e përbashkët. Nëse ato dështojnë ta bëjnë këtë, akti i propozuar konsiderohet se nuk është miratuar dhe procesi legjislativ përfundon.

### ***Publikimi***

Tekstin përfundimtar (në 23 gjuhët zyrtare aktuale të Unionit: bullgare, çeke, daneze, hollandeze, angleze, estone, finlandeze, frënge, gjermane, greke, hungareze, irlandeze, italiane, letoneze, lituaneze, malteze, polake, portugeze, rumune, sllovaqe, sllovene, spanjolle dhe suedeze) e nënshkruajnë Presidentët e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, i cili pastaj publikohet

në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* ose, nëse i drejtohet ndonjë grupi specifik, njoftohen ata të cilëve u drejtohet.

Procedura e bashkëvendosjes paraqet edhe sfidë edhe mundësi për Parlamentin. Nëse procedura duhet të funksionojë në mënyrë të suksesshme, duhet të ketë një marrëveshje në Komitetin e Pajtitimit. Mirëpo, procedura ndryshon marrëdhënien midis Parlamentit dhe Këshillit në mënyrë radikale. Dy institucionet tani vendosen në nivel të barabartë në procesin legjislativ, kurse Parlamenti dhe Këshilli janë ato që duhet të demonstrojnë kapacitetin e vet për kompromis dhe të orientojnë energjinë e tyre në Komitetin e Pajtitimit drejt arritjes të një marrëveshjeje.

### **PROCEDURA E MIRATIMIT**

Një formë tjetër parësore e involvimit të Parlamentit në procesin legjislativ është procedura e miratimit, me të cilën një instrument ligjor mund të miratohet vetëm me miratimin paraprak të Parlamentit. Mirëpo, kjo procedurë nuk i jep Parlamentit asnjë fushëveprim për të influencuar në mënyrë direkte natyrën e dispozitave ligjore. Për shembull, nuk mund të propozojë ndryshime ose të garantojë pranimin e tyre gjatë procedurës së miratimit; roli i tij është i kufizuar në pranimin apo refuzimin e instrumentit ligjor të dorëzuar para tij.

Kjo procedurë është paraparë në lidhje me anëtarësimin e Shteteve të reja Anëtare, nënshkrimin e marrëveshjeve të asociimit, marrëveshjet me implikime të rëndësishme buxhetore për BE-në dhe marrëveshjet me vendet që nuk janë anëtare, në fushat e politikës ku vlen procedura e rregullt legjislative (Neni 218(6) TFEU).

### **PROCEDURA E THJESHTËSUAR**

Me procedurën e thjeshtësuar, nuk duhet asnjë propozim nga Komisioni për të inicuar procesin legjislativ.

Kjo procedurë vlen për masat në suaza të fuqive të vet Komisionit (siç është miratimi i ndihmës shtetërore).

Procedura e thjeshtësuar gjithashtu përdoret për miratimin e instrumenteve jo-detyruese, sidomos rekomandimet dhe opinionet e dhëna nga Komisioni ose Këshilli. Komisioni nuk është i kufizuar me përmbytjen e paraparë në



mënyrë të shkoqitur në Traktate, mirëpo mund të formulojë rekomandime dhe të japë opinione në rastet kur e vlerëson se është e nevojshme.

Në procedurën e thjeshtësuar, aktet ligjore miratohen me mazhorancë të thjeshtë.

## SISTEMI I BE-SË PËR MBROJTJE LIGJORE

Një Union që ka aspirata për të qënë një komunitet i qeverisur me ligj duhet t'u mundësojë qytetarëve të vet një sistem të plotë dhe efektiv të mbrojtjes ligjore. Sistemi i Bashkimit Evropian për mbrojtje ligjore plotëson këtë kërkesë. Ai njeh të drejtën e individit për mbrojtjen efektive gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga e drejta e BE-së. Kjo mbrojtje është një nga parimet fundamentale ligjore që janë rrjedhojë e traditave kushtetuese, të përbashkëta për Shtetet Anëtare dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Nenet 6 dhe 13) dhe të garantuara me sistemin ligjor të BE-së (Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme dhe gjykatat e specializuara). Për këtë qëllim ekzistojnë një varg procedurash, siç është përshkruar më poshtë.

### PROCESET GJYQËSORE PËR SHKELJEN E TRAKTATEVE (NENI 258 TFEU)

Kjo është procedurë për të kuptuar nëse Shteti Anëtar ka dështuar të plotësojë obligimin e marrë me ligjin e Unionit. Kjo procedurë e zbatuar ekskluzivisht para Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Duke marrë parasysh seriozitetin e akuzave, referimi i Gjykatës së Drejtësisë duhet të paraprihet nga një procedurë preliminare ku Shtetit Anëtar i jepet mundësia të dorëzojë vërejtjet e veta. Nëse konflikti nuk zgjidhet në atë shkallë, qoftë Komisioni (Neni 258 TFEU) apo një Shtet tjetër Anëtar (Neni 259 TFEU) mund të organizojë një aktivitet në Gjykatë. Në praksë, iniciativën zakonisht e merr Komisioni. Gjykata heton ankesat dhe vendos nëse është bërë shkelje e Traktatit. Nëse ndodh kështu, nga Shteti ofendues Anëtar kërkohet të ndër-marrë masat e nevojshme. Nëse një Shtet Anëtar dështon të respektojë vendimin e dhënë kundër tij, Komisioni ka mundësi për një vendim të dytë i cili i urdhëron atij Shteti të pagojë gjobë ose dënim (Neni 260 TFEU). Prandaj, ekzistojnë implikime serioze financiare për një Shtet Anëtar, i cili vazhdon të mos marrë parasysh vendimin e Gjykatës kundër tij për shkelje të Traktatit.

**VEPRIMET E ANULIMIT (NENI 263 TFEU)**

Veprimet për anulim janë masa për kontroll objektiv gjyqësor të veprimit të institucioneve dhe organeve të Unionit (shqyrtimi abstrakt gjyqësor) dhe u mundësojnë qytetarëve qasje në drejtësinë e BE-së, edhepse me disa kufizime (garanca e mbrojtjes ligjore individuale).

Ato mund të paraqiten kundër të gjitha masave të institucioneve dhe organeve të Unionit të cilat japin efekte detyruese ligjore për të prekur interesat e aplikantit, duke ndryshuar seriozisht qëndrimin e tyre ligjor. Krahas Shteteve Anëtare, Parlamenti Evropian, Këshilli, Komisioni, Gjykata e Revizorëve, Banka Qendrore Evropiane dhe Komiteti i Rajoneve mund të paraqesin edhe veprime për anulim, nëse ato shkaktojnë shkelje të të drejtave të transferuara në to.

Qytetarët dhe aktivitetet, nga ana tjetër, mund të veprojnë vetëm kundër vendimeve që u janë adresuar personalisht atyre ose, edhe në rastet kur u adresohen të tjerëve, kanë efekt të drejtpërdrejtë individual në ato. Sipas Gjykatës të Drejtësisë, ky rast ndodh nëse një person preket në mënyrë aq specifike sa që të ekzistojë dallim i qartë midis atij ose asaj dhe individëve ose aktiviteteve të tjera. Ky kriterium i 'urgjencës' ka për qëllim të garantojë se një çështje i referohet Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Përgjithshme nëse evidenca e qëndrimit ligjor të ankuesit, e ndikuar negativisht, themelohet qartë me natyrën e atyre efekteve negative. Kërkesa për 'shqetësime individuale' gjithashtu ka për qëllim të parandalojë dorëzimin e 'pasive individuale'.

Nëse veprimi është i suksesshëm, Gjykata e Drejtësisë ose Gjykata e Përgjithshme mund ta shpallë instrumentin të pavlefshëm me efekt retroaktiv. Në rrethana të caktuara, mund ta shpallë të pavlefshëm vetëm prej datës së vendimit. Mirëpo, në mënyrë që të mbrojtë të drejtat dhe interesat e atyre që marrin veprime ligjore, shpallja e pavlefshmërisë mund të përjashtohet nga kufizimet e këtilla.

**ANKESAT PËR DËSHTIM TË VEPRIMIT (NENI 265 TFEU)**

Ky lloj veprimi plotëson mbrojtjen ekzistuese ligjore kundër Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian, Këshillit, Komisionit dhe Bankës Qendrore Evropiane. Ekziston një procedurë preliminare përmes të cilës, ai që ankohet duhet së pari të informojë institucionin që të plotësojë obligimin e vet. Rreg-

ulli i kërkuar në një veprim nga institucionet është deklarata se organi në fjalë ka bërë shkelje të Traktatit me atë që lë pas dore marrjen e vendimit të nevojshëm nga ai. Aty ku veprimin e sjell një qytetar ose një ndërmarrje, duhet deklaruar se institucioni ka bërë shkeljen e Traktatit duke harruar t'u adresojë një vendim individual atyre. Vendimi shpesh konkludon se harresa ka qënë e paligjshme. Gjykata e Drejtësisë/Gjykata e Përgjithshme nuk ka juridiksion të urdhërojë marrjen e një vendimi: nga pala të cilës i jepet vendimi, thjesht kërkohet të marrë masa për të respektuar vendimin (Neni 266 TFEU).

### **VEPRIMET NË RASTE TË DËMEVE (NENI 268 DHE 340(2) TFEU)**

Qytetarët dhe ndërmarrjet — e gjithashtu edhe Shtetet Anëtare — të cilat përjetojnë dëme për shkak të një gabimi të bërë nga personeli i BE-së, kanë mundësinë të ngrejë padi për dëmshpërblim në Gjykatën e Drejtësisë. Baza për përgjegjësinë e BE-së nuk është përcaktuar plotësisht me Traktatet dhe qeveriset nga parimet e përgjithshme, të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare. Gjykata ka mishëruar këtë, me qëndrimin se kushtet në vijim duhet të plotësohen para se të kompensohet dëmshpërblimi: (1) duhet të ekzistojë një akt joligjor nga një institucion i Unionit ose nga ndonjë anëtar i personelit të tyre në ushtrimin e funksioneve të tij ose të saj. Një akt joligjor ndodh atëherë kur bëhet shkelje serioze e rregullores së ligjit të Unionit, i cili ia transferon të drejtat një individi, ndërmarrjeje ose një Shteti Anëtar, ose është miratuar për t'i mbrojtur ata. Ligjet që njihen se kanë natyrë mbrojtëse, janë veçanërisht të drejtat dhe liritë fundamentale të tregut të brendshëm ose parimet fundamentale të mbrojtjes së parashikimeve dhe proporcionalitetit legjitim. Shkelja është mjaft serioze nëse institucioni në fjalë ka tejkalluar kufijtë e fuqisë së vet diskrete deri në një shkallë të konsiderueshme. Gjykata planifikon të shtijë në funksion konkluzat e veta në kategorinë e personave të prekur nga masa kundërvajtëse dhe nga shkalla e dëmit të përjetuar, e cila duhet të tejkalojë rrezikun komercial i cili mund të jetë i arsyeshëm në sektorin e caktuar afarist; (2) duhet të jetë përjetuar dëm real; (3) duhet të ketë një lidhje shkakësore midis aktit të institucionit të Unionit dhe dëmi i përjetuar; (4) dedikimi ose neglijenca nuk duhen vërtetuar.

### **VEPRIMET E PERSONELIT TË KOMUNITETIT (NENI 270 TFEU)**

Konfliktet midis BE-së dhe personelit të vet ose anëtarëve të tyre të gjallë të familjes, të cilat dalin nga marrëdhënia e punësimit, gjithashtu mund të da-

lin para Gjykatës së Drejtësisë. Juridiksioni për këto veprime i përket gjykatës së specializuar për shërbim civil i bashkangjitur me Gjykatën e Përgjithshme.

### **KONFLIKTET LUDHUR ME PATENTET E UNIONIT (NENET 257 DHE 262 TFEU)**

Baza ligjore për themelimin e Gjykatës së Unionit për Patente u prezantua me Traktatin e Nicës. Gjykata e Unionit për Patente, e cila akoma nuk është themeluar dhe e cila do të vendoset në Gjykatën e Drejtësisë, do të ketë juridiksionin mbi konfliktet lidhur me sistemin e ardhshëm të Unionit për patente. Veçanërisht, do të trajtojë proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me shkeljen dhe validitetin e patenteve të Unionit. Vet krijimi i sistemit të Unionit për patentim, ka për qëllim të lirojë dhe të lehtësojë mbrojtjen e shpikjeve të reja në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, me anë të një procedure të vetme. Në këtë mënyrë do të heqë disavantazhin e zbatuar, nga i cili dëmtohen inovatorët e Evropës dhe të stimulojnë investimet në fushën e kërkimit dhe zhvillimit.

### **PROCEDURAT E ANKESËS (NENI 256(2) TFEU)**

Marrëdhënia midis Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme është përpiluar në atë mënyrë që vendimet e Gjykatës së Përgjithshme i nënshtrohet të drejtës të ankesës para Gjykatës së Drejtësisë vetëm në pikat që kanë të bëjnë me ligjin. Ankesa mund të bazohet në mungesë të kompetencës së Gjykatës së Përgjithshme, një shkelje e procedurës, e cila ndikon negativisht mbi interesat e apeluesit ose shkelje e të drejtës së Unionit nga Gjykata e Drejtësisë. Nëse ankesa është e justifikuar dhe e pranueshme proceduralisht, vendimi i Gjykatës së Përgjithshme shfuqizohet nga Gjykata e Drejtësisë. Nëse kjo çështje është e pjekur për vendim gjyqësor, Gjykata e Drejtësisë mund të japë vendimin e vet; përndryshe, duhet të referojë çështjen përsëri para Gjykatës së Përgjithshme, e cila është e lidhur me vlerësimin ligjor të Gjykatës së Drejtësisë.

Një sistem i ngjashëm tani ekziston midis gjykatave të specializuara dhe Gjykatës së Përgjithshme, ku Gjykata e Përgjithshme kontrollon vendimet e gjykatave të specializuara si një lloj i gjykatës së apelit. Vendimi (i apelit) i Gjykatës së Përgjithshme mund të rishqyrtohet nga Gjykata e Drejtësisë, edhepse vetëm në rrethana të veçanta.

**MBROJTJA E PËRKOHSHME JURIDIKE (NENI 278 DHE 279 TFEU)**

Paditë e ngritura para Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Përgjithshme, ose ankesat e paraqitura kundër vendimeve të tyre, nuk kanë efekt pezullues. Mirëpo, është e mundur që të dorëzohet aplikim para Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme për një urdhër që pezullon zbatimin e aktit të kontestuar (Neni 278 TFEU) ose për një urdhër të përkohshëm të gjykatës (Neni 279 TFEU).

Meritat e çdo lloj zbatimi të masave të përkohshme vlerësohen nga gjykatat, në bazë të tre kriterëve në vijim: (1) perspektiva e suksesit në çështjen kryesore (*fumus boni juris*): kjo vlerësohet nga gjykata në ekzaminimin përmbledhës preliminar të argumenteve të dorëzuara nga apeluesi; (2) urgjenca e urdhërit: kjo vlerësohet varësisht nga ajo nëse kërkesa e apeluesit është e domosdoshme për të mënjeluar dëmin serioz dhe të pandreqshëm; kriteret e shfrytëzuara për të bërë këtë vlerësim përfshijnë natyrën dhe seriozitetin e shkeljes, si dhe efektet e saj specifike dhe të pandreqshme mbi pronën e ankuesit dhe objekteve të tjera për mbrojtje ligjore; humbja financiare konsiderohet të ketë natyrë serioze dhe të pandreqshme, vetëm nëse nuk ia del të pagohet edhe nëse ankuesi arrin sukses në procesin kryesor gjyqësor; (3) peshimi i interesave: efektet negative që mund t'i përjetojë ankuesi nëse aplikimi për një urdhër të përkohshëm refuzohet, peshojnë kundër interesit të BE-së në implementimin e menjëhershëm të masës, dhe kundër efekteve të dëmshme mbi palët e treta nëse duhet të jepet urdhëri i përkohshëm.

**VENDIMET PRELIMINARE (NENI 267 TFEU)**

Kjo është procedura me të cilën gjykatat nacionale mund të kërkojnë udhëzim nga Gjykata e Drejtësisë lidhur me të drejtën e Unionit. Aty ku gjykatat nacionale duhet të zbatojnë dispozitat e të drejtës së Unionit në ndonjë rast para tij, mund të pezullojë procesin dhe të kërkojë nga Gjykata e Drejtësisë sqarim të validitetit të instrumentit të Unionit dhe/ose interpretimit të instrumentit dhe Traktateve. Gjykata e Drejtësisë përgjigjet më tepër në formë të vendimit se sa në formë të opinionit këshillues; kjo thekson natyrën detyruese të vendimit të saj. Procedura preliminare e vendimit, ndryshe nga procedurat e tjera nën konsiderim, nuk është procedurë kundërshtuese por vetëm një fazë në procesin gjyqësor që fillon dhe mbaron në gjykatat nacionale.

Domethënë duhet të sigurohet një interpretim i njëtrajtshëm të ligjit të Unionit dhe nga këtu uniteti i rendit ligjor të BE-së. Krahas funksionit të fundit, procedura është gjithashtu e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave individuale. Gjykatat nacionale mundet vetëm të vlerësojë përputhshmërinë e të drejtës nacionale dhe të drejtën e Unionit dhe, në rast se ekziston mospërputhshmëri, të zbatohet e drejta e Unionit — i cili merr përparësinë dhe është i zbatueshëm drejtpërsëdrejti — nëse përbërja dhe fushëveprimi i dispozitave të Unionit janë qartë të përcaktuara. Kjo qartësi, zakonisht mund të shkaktohet vetëm me një vendim preliminar nga Gjykata e Drejtësisë, që do të thotë se procesi gjyqësor për vendimin e këtyllë u ofron qytetarëve të Unionit mundësinë të sfidojnë veprimet e Shteteve të tyre Anëtare, të cilat janë në kundërshtim me ligjin e BE-së dhe të sigurojnë zbatimin e ligjit të Unionit para gjykatave nacionale. Ky funksion i dyfishtë i procesit gjyqësor për vendim preliminar kompenson deri në një masë kufizimet ndaj individëve që ngrejnë padi para Gjykatës së Drejtësisë dhe kështu është vendimtar për mbrojtjen ligjore të individit. Mirëpo, sukcesi në këto procese gjyqësore përfundimisht varet se sa ‘të apasionuar’ janë gjykatësit dhe gjykatat nacionale t’i referojnë rastet autoriteteve më të larta.

*Çështja:* Gjykata e Drejtësisë merr vendim mbi interpretimin e instrumenteve të ligjit të Unionit dhe shqyrton vlefshmërinë e akteve të insitucioneve të Unionit me rëndësi ligjore. Dispozitat e të drejtës nacionale mund të mos i nënshtrohen vendimit preliminar. Në proceset gjyqësore për vendim preliminar, Gjykata e Drejtësisë nuk është e autorizuar të interpretojë të drejtën nacionale ose të vlerësojë përputhshmërinë e tij me ligjin e Unionit. Këtij fakti shpesh herë nuk i jepet rëndësi në çështjet që i referohen Gjykatës së Drejtësisë, të cilës i drejtohen për shumë çështje që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e dispozitave të ligjit nacional dhe atij të Unionit, ose të vendosë mbi zbatueshmërinë e dispozitës specifike të të drejtës të Unionit në procedurat e pazgjidhura gjyqësore që presin para një gjykate nacionale. Edhe pse këto çështje, në fakt, janë proceduralisht të ndaluara, Gjykata e Drejtësisë nuk i referon ato prapa në gjykatat nacionale; por në vend të kësaj, e interpreton sërish çështjen që i është referuar si kërkesë nga gjykata referuese për kriteret themelore ose vitale për interpretimin e dispozitave të caktuara ligjore, dhe kështu i mundëson gjykatës nacionale të japë vlerësimin e vet të përputhshmërisë midis të drejtës nacionale dhe asaj të Unionit. Procedura e miratuar nga Gjykata e Drejtësisë duhet që nga dokumentacioni i dorëzuar të nxjerrë

— sidomos bazat e referimit — ato elemente të të drejtës të Unionit të cilat duhet të interpretohen për qëllime të konfliktit elementar ligjor.

*Kapaciteti për proces gjyqësor:* Procedura është në dispozicion të të gjitha ‘gjykatave të Shteteve Anëtare’. Kjo shprehje duhet të kuptohet në suaza të kuptimit të ligjit të Unionit dhe nuk fokusohet vetëm në emrin por më saktë në funksionin dhe pozitën e një organi gjyqësor në sistemet e mbrojtjes ligjore në Shtetet Anëtare. Duke u bazuar në këtë, ‘gjykatat’ kuptohen si të gjitha institucionet e pavarura (d.m.th. nuk u nënshtrohen instrukcioneve) të autorizuara për zgjidhjen e konflikteve në një shtet kushtetutar në procesin e duhur ligjor. Sipas këtij definicioni, gjykatat kushtetuese në Shtetet Anëtare dhe autoritetet për zgjidhjen e konflikteve jashtë sistemit gjyqësor të shtetit — mirëpo jo tribunalet private të arbitrazhit — gjithashtu janë të autorizuara të referojnë raste. Vendimi i gjykatës nacionale për atë se a duhet të jepet referencë apo jo do të varet nga rëndësia e pikës në fjalë të të drejtës së Komunitetit, për zgjidhjen e konfliktit të dorëzuar para tij, gjë që duhet ta vlerësojë gjykata nacionale. Palët vetëm mund të lusin, por jo të kërkojnë nga gjykata të referojë një rast. Gjykata e Drejtësisë merr parasysh rëndësinë e kësaj pike vetëm në kontekst të pyetjes nëse çështja e caktuar i nënshtrohet referimit (d.m.th. nëse ka të bëjë me interpretimin e Traktateve të Unionit ose validitetin ligjor të një akti nga një institucion i Unionit) apo nëse bëhet fjalë për ndonjë konflikt të vërtetë (d.m.th. nëse çështjet për të cilat Gjykata e Drejtësisë duhet të japë opinionin e vet ligjor në vendimin preliminar janë thjesht hipotetike ose kanë të bëjnë me një çështje ligjore të zgjidhur). Është përjashtim për Gjykatën të refuzojë shqyrtimin e çështjes për këto arsye, pasi që, duke marrë parasysh rëndësinë speciale të bashkëpunimit midis autoriteteve gjyqësore, Gjykata ushtron kontroll gjatë zbatimit të këtyre kriterëve. Megjithatë, vendimet e fundit të Gjykatës tregojnë se ajo është bërë më e rreptë lidhur me përshtatshmërinë për referim, duke qënë se i kushton vëmendje të posaçme kërkesës së themeluar, në mënyrë që urdhëri për referim të përmbajë sqarim të qartë dhe të detajuar të sfondit faktik dhe juridik të procesit gjyqësor, dhe, nëse kjo informatë nuk sigurohet, ajo deklarohet si e paaftë për të dhënë interpretim të duhur të së drejtës të Unionit dhe refuzon zbatimin e vendimit preliminar si të papranueshëm.

*Obligimi për të referuar:* Një gjykatë ose tribunal nacional, kundër vendimit të të cilit nuk ka mjete gjyqësore në të drejtën nacionale, është e obliguar të referojë. Koncepti i të drejtës së apelit përfshin të gjitha format e dëmshpërblimit ligjor me çka mund të shqyrtohet një vendim gjykate në fakt dhe

në ligj (apel) ose vetëm në ligj (apel në pika të ligjit). Mirëpo, koncepti nuk përfshin mjetet e zakonshme ligjore me efekte të kufizuara dhe specifike (p.sh. procese të reja gjyqësore, përputhshmëria kushtetuese). Një gjykatë që është e obliguar të referojë një rast, mund t'i shmanget këtij referimi vetëm nëse çështja në fjalë nuk ka rëndësi materiale për rezultatin e rastit ose është përgjigjur nga Gjykata e Drejtësisë, ose interpretimi i të drejtës së Unionit nuk përmbush kriteret e dyshimit të themeluar. Megjithatë, obligimi për të referuar është kategorik aty ku bëhet fjalë për vlefshmërinë e një instrumenti të Unionit. Gjykata e Drejtësisë e bën të qartë në këtë kontekst se vetëm ajo ka fuqinë të refuzojnë dispozita ilegale të të drejtës së Unionit. Gjykatat nacionale duhet të zbatojnë dhe të pajtohen me ligjin e Unionit deri sa të shpallet i papranueshëm nga Gjykata e Drejtësisë. Një marrëveshje speciale vlen për gjykatat, në proceset gjyqësore për dhënien e mbrojtjes së kushtëzuar ligjore. Në bazë të vendimeve të fundit të Gjykatës së Drejtësisë, varësisht nga kushte të caktuara, këto gjykata janë të autorizuara të suspendojnë vënien në fuqi të aktit administrativ nacional që rrjedh nga rregullativa e Unionit, ose të japin urdhëra të përkohshme për të caktuar përkohësisht marrëveshjet e marrëdhënieve ligjore duke mos i kushtuar rëndësi një dispozite ekzistuese të ligjit të Unionit.

Dështimi i kryerjes së obligimit për të referuar paraqet shkelje të Traktateve të Unionit, gjë që mund të bëjë Shtetin Anëtar në fjalë të konsiderohet si përgjegjës për shkeljet e proceseve gjyqësore. Mirëpo në praksë, efektet e kësaj rrjedhe të veprimeve janë shumë të kufizuara, duke marrë parasysh se qeveria e Shtetit Anëtar në fjalë nuk mund të përputhet me asnjë urdhër të lëshuar nga Gjykata e Drejtësisë, pasi që pavarsia e gjyqësisë së vet dhe parimi i ndarjes së fuqive do të thotë se ajo qeveri është e paaftë t'u japë instrukcione gjykatave nacionale. Tani që është pranuar parimi i përgjegjësisë së Shteteve Anëtare në suaza të ligjit të Unionit për mospërputhje me këtë të fundit (shih titullin e ardhshëm), mundësia që individët të cilët kërkojnë dëmshpërblim për dëme mundësisht të shkaktuara nga Shtetet Anëtare në fjalë për dështim të përmbushjes së obligimit të vet, ofron perspektivë më të mirë për sukses.

*Efekti:* Vendimi preliminar, i lëshuar në formë të urdhërit të gjykatës, është drejtëpërsëdrejti detyrues për gjykatën referuese dhe për të gjitha gjykatat e tjera që dëgjojnë rastin e njëjtë. Në praksë, ai gjithashtu ka status të lartë, si vendim parësor për rastet e mëvonshme të natyrës së ngjashme.



## PËRGJEGJËSIA E SHTETEVE ANËTARE PËR SHKELJET E LIGJIT TË UNIONIT

Përgjegjësia e Shteteve Anëtare, për dëmet që i përjetojnë individët si rezultat i shkeljes së të drejtës së Unionit, e cila i atribuohet atij shteti, u themelua në parim nga Gjykata e Drejtësisë në vendimin e vet më 5 mars 1996 në Rastet e Përbashkëta C-46/93 *Brasserie du pêcheur* and C-48/93 *Factortame*. Ky ishte vendim që vendoste përparësi ngjashëm me vendimet e përparshme të Gjykatave mbi parësinë e të drejtës së Unionit, zbatueshmërinë direkte të dispozitave të të drejtës së Unionit dhe njohja e të drejtave fundamentale të Unionit. Vendimi madje referohet edhe nga vet Gjykata si ‘rezultati i nevojshëm i efektit direkt të dispozitave të Komunitetit, shkelja e të cilave ka shkaktuar dëmin e përjetuar’, dhe në mënyrë të konsiderueshme shton mundësinë që një individ të detyrojë organet e Shtetit me të tre qendrat e fuqisë (d.m.th. legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore) të pajtohen dhe të implementojnë ligjin e Unionit. Vendimi është zhvillim i mëtejshëm i vendimit të Gjykatës lidhur me rastin *Francovich & Bonifaci*. Ndërsa vendimet e mëparshme kufizonin përgjegjësinë e Shteteve Anëtare, në instanca ku individët përjetuan dëme si rezultat i dështimit të zhvendosjes në kohë të një direktive që u jep atyre të drejta personale por nuk janë të adresuara për ata, vendimi i fundit themeloi parimin e përgjegjësisë së përgjithshme që përfshin çfarëdo shkelje të të drejtës së Unionit, e cila i atribuohet një Shteti Anëtar.

## PËRGJEGJËSIA E SHTETEVE ANËTARE LIDHUR ME AKTET LIGJORE OSE DËSHTIMIN PËR TË VEPRUAR

Kjo formë e përgjegjësisë definohet me tre kritere, të cilat janë shumë të ngjashme me ato që zbatohen në Bashkimin Evropian, në situata të ngjashme.

- (1) Qëllimi i dispozitës së shkelur të Unionit duhet të jetë dhënia e të drejtave për individin.
- (2) Shkelja duhet të jetë shumë serioze, d.m.th. një Shtet Anëtar duhet të ketë tejkaluar kufijtë e fuqisë së vet diskrete deri në një shkallë të konsiderueshme. Kjo duhet të vendoset nga gjykatat nacionale, të cilat kanë përgjegjësinë e vetme të përcaktimit të fakteve dhe vlerësimit të seriozitetit të shkeljes së ligjit të Unionit. Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë u ofron gjykatave nacionale një varg udhëzimesh:



“Faktorët që mund t’i marrë parasysh gjykata kompetente përfshijnë qartësinë dhe saktësinë e rregullit të shkelur, masa e diskrecionit

që ky rregull u ka lënë autoriteteve nacionale apo të Komunitetit, qoftë kjo shkelje dhe ky dëm i shkaktuar me qëllim ose pa dashje, qoftë gabimi i ligjit i justifikueshëm apo jo, fakti se qëndrimi i një institucioni të Komunitetit mund të ketë qënë një ndër shkaktarët e kësaj lënie pas dore, dhe miratimi i masave të mbetura nacionale ose përvojat e kundërta me të drejtën e Komunitetit. Sipas secilit qëndrim, shkelja e të drejtës së Komunitetit duhet të jetë serioze, nëse ka vazhduar pavarësisht nga vendimi që konkludon se shkelja në fjalë duhet të vërtetohet, ose vendimi preliminar apo rast i zgjidhur i praksës gjyqësore të Gjykatës lidhur me këtë çështje, nga i cili është e qartë se selja në fjalë ka shkaktuar një shkelje.’

- (3) Një lidhje direkte kauzale duhet të ekzistojë midis shkeljes së obligimit të Shtetit Anëtar dhe dëmit të përjetuar nga pala e lënduar. Nuk është e nevojshme të demonstronhet gabim (paramendim ose neglijencë) krahas përfundimit se është bërë shkelje serioze e të drejtës së Unionit.

### **PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJEN E TË DREJTËS SË UNIONIT NGA GJYKATAT**

Gjykata e Drejtësisë bën të qartë se parimet e themeluara nga ajo për të vendosur përgjegjësinë poashtu vlejnë për njërën nga tre fuqitë qendrore, gjegjësisht gjyqësinë. Vendimet e saj tani nuk i nënshtrohen vetëm shqyrtimit në etapat e mëvonshme të apelit; nëse ato janë dhënë me mosrespektim ose shkelje të ligjit të Unionit, ato mund t’i nënshtrohen veprimit për dëmshpërblim para gjykatave kompetente në Shtetet Anëtare. Gjatë themelimit të fakteve që janë pjesë e vendimit i cili shkel të drejtën e Unionit, proceset e këtilla gjyqësore duhet të marrin parasysh sërish çështjet që kanë të bëjnë me substancën e të drejtës të Unionit, gjatë të cilave gjykata e caktuar nuk mund të kërkojë efektet detyruese të vendimit të gjykatës së specializuar të cilës i është referuar rasti. Gjykata të cilës, gjykatat kompetente nacionale duhet t’i referojnë çështje për interpretim dhe/ose vlefshmëria e dispozitave të Unionit, si dhe përputhshmëria e regjimeve të përgjegjësisë nacionale me të drejtën e Unionit, është përsëri Gjykata e Drejtësisë, të cilës çështjet mund t’i referohen në suaza të procedurës së vendimit preliminar (Neni 267 TFEU).

Mirëpo, përgjegjësia për shkelje përmes një vendimi do të mbetet përjashtim. Duke marrë parasysh kushtet e rrepta, përgjegjësia mund të konsiderohet vetëm nëse një gjykatë në mënyrë të paramenduar nuk përfill të drejtën e

Unionit, ose, si në rastin *Köbler*, gjykata e instancës së fundit, me shkeljen e të drejtës së Unionit, i jep forcë ligjore një vendimi në dëm të individit, pa e pyetur paraprakisht Gjykatën e Drejtësisë të qartësojë situatën në lidhje me të drejtën e Unionit, i cili është relevant për këtë vendim. Në rastin e fundit, është me rëndësi për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Unionit të cilët thirren në të drejtën e Unionit për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga gjykata e instancës së fundit.

# Pozita e të drejtës së Bashkimit Evropian në raport me rendin ligjor në tërësi

Pas gjithë kësaj që kemi mësuar mbi strukturën e Bashkimit Evropian dhe konstrukcionin e tij ligjor, nuk është e lehtë që të drejtës së Unionit, t'i caktohet vendi i drejtë në rendin ligjor si tërësi dhe të definohen kufijtë midis atij dhe rendeve të tjera ligjore. Dy qasje të mundshme të klasifikimit të tij duhet të refuzohen që nga fillimi. E drejta e Unionit nuk duhet të konceptohet thjesht si një koleksion i marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe as nuk mund të shihet si pjesë apo shtojcë e ndonjë sistemi ligjor nacional.

## AUTONOMIA E RENDIT LIGJOR TË BE-SË

Me themelimin e Unionit, Shtetet Anëtare kanë kufizuar sovranitetin e tyre legjislativ dhe duke bërë këtë, kanë krijuar një organ të pavarur ligjor i cili është detyruar për ato, për qytetarët dhe për gjykatat e tyre.

Një nga rastet më të njohura, që është dëgjuar në Gjykatën e Drejtësisë ishte *Costa v ENEL* në 1964, në të cilin z. Costa ngriti padi kundër nacionalizimit të prodhimit dhe distribuimit të energjisë elektrike, dhe kushtëzimit pasues nga bizneset e kompanive të mëparshme të energjisë elektrike në ENEL – korporatën e re publike

Autonomia e rendit ligjor të BE-së është me rëndësi themelore për natyrën e BE-së, sepse është e vetmja garanci që Unioni të mos humbasë nga forca ose efikasiteti, gjatë bashkëveprimit me të drejtën nacionale dhe se do të zbatohet njëtrajtshëm në mbarë Unionin. Prandaj, konceptet e të drejtës së Unionit interpretohen lidhur me qëllimet e rendit ligjor të BE-së dhe të Unionit në përgjithësi. Ky interpretim specifik për Unionin është i domosdoshëm, pasi që disa të drejta sigurohen me të drejtën e Unionit, dhe pa atë do të ishin të rrezikuara, pasi që çdo Shtet Anëtar – duke interpretuar dispozitat në mënyra të ndryshme – do të mundje të vendosë individualisht

mbi substancën e lirive, të cilat duhet t'i garantojë e drejta e Unionit. Një shembull është koncepti i 'punëtorit', në të cilin bazohet fushëveprimi i lirisë së lëvizjes. Koncepti specifik i Unionit për punëtorin është i aftë për të devijuar nga konceptet që njihen dhe që zbatohen në rendet ligjore të Shteteve Anëtare. Për më tepër, standardi i vetëm me të cilin maten instrumentet ligjore të Unionit është vet e drejta e Unionit, dhe jo legjislacioni nacional apo ligji kushtetues.

Në bazë të sfondit të këtij koncepti të autonomisë të rendit ligjor të BE-së, cila është marrëdhënia midis ligjit të Unionit dhe ligjit nacional?

Edhe pse e drejta e Unionit përbëhet nga një rend ligjor i vetkenaqshëm në relacion me rendet ligjore të Shteteve Anëtare, kjo situatë nuk duhet të konsiderohet si e atillë ku rendi ligjor i BE-së dhe sistemet ligjore të Shteteve Anëtare shtresohen me njëri tjetrin si shtresa të themelit. Fakti që vlejnjë për njerëzit e njëjtë, të cilët njëkohësisht bëhen qytetarë të Shtetit nacional dhe të BE-së, mohon ndarjen kaq të ashpër të këtyre rendeve ligjore. Së dyti, qasja e këtillë nuk përfill faktin se e drejta e Unionit mund të bëhet funksionale vetëm nëse formon pjesë të rendeve ligjore të Shteteve Anëtare. E vërteta është se rendi ligjor i BE-së dhe rendet ligjore nacionale janë të ndërlidhur dhe të ndërvarur.

## INTERAKSIONI MIDIS TË DREJTËS SË UNIONIT DHE TË DREJTËS NACIONALE

Aspekti i marrëdhënies midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale, përfshin ato fusha ku dy sistemet plotësojnë njëri tjetrin. Neni 4(3) i TEU është i qartë:



“Sipas parimit të bashkëpunimit të sinqertë, Unioni dhe Shtetet Anëtare do të ndihmojnë njëri tjetrin me respekt të ndërsjelltë, në realizimin e detyrave që dalin nga Traktatet. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme, të përgjithshme ose të veçanta, të garantojnë plotësimin e obligimeve që dalin nga Traktatet ose që rezultojnë nga aktet e institucioneve të Unionit. Shtetet Anëtare do të lehtësojnë realizimin e detyrave të Unionit dhe do të përmbahen nga masat që mund të rrezikojnë arritjen e synimeve të Unionit.”

Ky parim i përgjithshëm i bashkëpunimit të sinqertë u inspirua nga vetëdija se rendi ligjor i BE-së nuk mund të arrijë t'i plotësojë vetëm synimet e parapara me themelimin e BE-së. Për dallim nga një rend ligjor nacional, rendi ligjor i BE-së nuk është sistem i pavarur, por varet nga mbështetja e sistemeve nacionale për funksionimin e vet. Tre degët e qeverisë — legjislatura, ekzekutivi dhe gjyqësia — duhet të pranojnë se rendi ligjor i BE-së nuk është sistem i 'huaj' dhe se Shtetet Anëtare dhe institucionet e Unionit kanë krijuar lidhje të përhershme midis vete, për të arritur objektivat e tyre të përbashkëta. Bashkimi Evropian nuk është vetëm komunitet i interesave; ai është komunitet i bazuar në solidaritet. Sipas kësaj, autoritetet nacionale jo vetëm që duhet të mbikqyrin Traktatet e Unionit dhe legjislacionin sekondar; ato duhet edhe t'i implementojnë dhe t'i vënë traktatet dhe legjislacionin në funksion. Interakcioni midis dy sistemeve është shumë-shtresor dhe duhen disa shembuj për ta sqaruar.

Ilustrimi i parë se si ndërlidhen dhe plotësohen rendet ligjore të BE-së me ato nacionale është direktiva, e cila është shqyrtuar në kapitullin mbi legjislacionin. E gjithë ajo që direktiva zgjidh në aspektin detyrues është rezultati që duhet arritur nga Shtetet Anëtare; janë autoritetet nacionale ato që do të vendosin, përmes ligjit vendor, për atë se si dhe me çfarë masash arrihet rezultati. Në fushën gjyqësore, dy sistemet ndërlidhen me anë të procedurës së vendimit preliminar, i cili referohet në Nenin 267 të TFEU, sipas të cilit gjykatat nacionale mund, ose ndonjëherë janë të detyruara, t'i referojnë Gjykatës së Drejtësisë pyetje mbi interpretimin dhe vlefshmërinë e të drejtës së Unionit, dhe vendimi i Gjykatës mund të jetë vendimtar në zgjidhjen e konfliktit të paraqitur para tyre. Dy gjëra janë të qarta: së pari, gjykatat në Shtetet Anëtare duhet të mbikqyrin dhe të zbatojnë ligjin e Unionit; dhe së dyti, interpretimi i ligjit të Unionit dhe deklaratat lidhur me vlefshmërinë e tij janë rezervat e vetme të Gjykatës së Drejtësisë. Varshmëria e ndërsjelltë e BE-së dhe të drejtës nacionale ilustrohet me atë se çka ndodh kur duhen plotësuar shprehjet e të drejtës së BE-së: e drejta e Unionit u referohet rregullave ekzistuese të së drejtës nacionale për të kompletuar rregullat që i vendos vet. Parimi vlen për të gjitha obligimet e të drejtës së Unionit, përveç nëse kjo e fundit nuk ka përcaktuar rregulla për zbatimin e vet. Në këto raste, autoritetet nacionale zbatojnë të drejtën e Unionit me dispozitat e sistemeve të veta ligjore. Mirëpo parimi kushtëzohet me një parakusht: zbatimin i njëtrajtshëm i të drejtës së Unionit duhet të vazhdojë, pasi që do të ishte krejtësisht e papranueshme që qytetarët dhe ndërmarrjet të gjykohen me kritere të ndryshme — dhe kështu të trajtohen në mënyrë të padrejtë.





1 mars 2004.

Një femër duke vizituar me shkumës hartën e Evropës, ashtu si do të dukej në vitin 2007.

## KONFLIKTI MIDIS TË DREJTËS SË UNIONIT DHE TË DREJTËS NACIONALE

Mirëpo, marrëdhënia midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale karakterizohet edhe me një 'përplasje' të herëpashershme ose konflikt midis rendit ligjor të Unionit dhe rendeve ligjore nacionale. Një situatë e këtillë gjithnjë shfaqet kur një dispozitë e të drejtës së Unionit ua transferon të drejtat dhe ua ngarkon obligimet drejtpërsëdrejti qytetarëve të Unionit ndërsa përmbajtja e vet përplaslet me rregullin e të drejtës nacionale. Prapa kësaj fushe të thjeshtë problematike janë fshehur dy çështje fundamentale që janë bazë e strukturës së BE-së, përgjigjet e të cilave ishin paraparë të bëhen 'testi acidik' për ekzistencën e rendit ligjor të BE-së, gjegjësisht zbatueshmëria direkte e të drejtës së Unionit dhe supremacia e të drejtës së Unionit mbi të drejtën kontradiktore nacionale.

## ZBATUESHMËRIA DIREKTE E TË DREJTËS SË UNIONIT MBI TË DREJTËN NACIONALE

Së pari, parimi i zbatueshmërisë direkte thjesht do të thotë se e drejta e Unionit ia kalon të drejtat dhe ua imponon obligimet drejtpërsëdrejti, jo vetëm institucioneve të Unionit dhe Shteteve Anëtare por gjithashtu edhe qytetarëve të Unionit.

Një nga arritjet e veçanta të Gjykatës së Drejtësisë është se ka vënë në fuqi zbatueshmërinë direkte të të drejtës së Unionit, përkundër rezistencës fillestare të disa Shteteve të caktuara Anëtare, dhe kështu ka garantuar ekzistimin e rendit ligjor të BE-së. Praksa e vet gjyqësore në këtë rast filloi me një rast të lartpërmendur, gjegjësisht rasti i ndërmarrjes hollandeze të transportit *Van Gend & Loos*. Ndërmarrja ngriti padi në një gjykatë hollandeze kundër autoriteteve doganore të Hollandës, të cilat kishin kërkuar tatime të shtuara doganore për një prodhim kimik të importuar nga Republika Federale të Gjermanisë. Në analizën përfundimtare, rezultati i këtij procesi gjyqësor varej nga pyetja nëse edhe individët mund të thirren në Nenin 12 të Traktatit të EEC-së, i cili në mënyrë specifike ndalon Shtetet Anëtare të prezantojnë tatime të reja doganore ose të shtojnë tatimet ekzistuese në tregun e përbashkët. Përkundër këshillës së një numri të madh të qeverive dhe Avokatit të vet të Përgjithshëm, Gjykata mori vendimin se, duke marrë parasysh natyrën dhe synimin e Unionit, dispozitat e të drejtës së Unionit në të gjitha rastet kanë qënë drejtpërsëdrejti të zbatueshme. Në arsyetimin e vendimit të vet, Gjykata theksoi se:

‘... Komuniteti përbën një rend të ri ligjor ... çështjet e të cilit i përbëjnë jo vetëm Shtetet Anëtare por edhe shtetasit e tyre. Pavarësisht nga legjislati i Shteteve Anëtare, e drejta e Komunitetit nuk ngarkon vetëm obligime për individët por



gjithashtu është paraparë t'u transferojë atyre të drejta. Këto të drejta nuk dalin vetëm aty ku Traktati i jep në mënyrë të shkoqitur nga Traktati, por edhe për shkak të obligimeve që Traktati në mënyrë të definuar qartë ua ngarkon jo vetëm individëve por edhe Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Komunitetit.”

Mirëpo, kjo deklaratë e guximshme nuk na shpjen larg, pasi që edhe më tej mbetet pyetja se cilat dispozita të të drejtës së Unionit janë të zbatueshme drejtpërsëdrejti. Pikësëpari, Gjykata shqyrtoi këtë çështje në lidhje me legjislacionin primar të Unionit dhe deklaroi se individët mund t'i nënshtrohen drejtpërsëdrejti të gjitha dispozitave të Traktateve të Unionit, të cilat (i) përcaktojnë kushte absolute, (ii) janë të plota dhe vetëfunktionuese në kontekstin ligjor dhe prandaj (iii) nuk kanë nevojë për asnjë veprim të mëtejshëm nga Shtetet Anëtare ose institucionet e Unionit, për t'u përputhur ose për të fituar efekt ligjor.

Gjykata mori vendimin se Neni i mëparshëm 12 EEC-së i plotësonte këto kritere, dhe se ndërmarrja Van Gend & Loos mund të nxirrte të drejtat nga ai, të cilin gjykata në Hollandë ishte e obliguar ta mbrojtë, si pasojë e të cilës gjykata hollandeze anuloi tatimet doganore të përcaktuara në kundërshtim me Traktatin. Rrjedhimisht, Gjykata vazhdoi të zbatojë këtë arsyetim, lidhur me dispozitat e tjera të Traktatit EEC, të cilat kanë rëndësi më të madhe për qytetarët e Unionit se sa Neni 12. Vendimet që janë të vlefshme për t'u përmendur këtu, kanë të bëjnë me zbatueshmërinë direkte të dispozitave mbi lirinë e lëvizjes (Neni 45 TFEU), liria e krijimit (Neni 49 TFEU) dhe liria për të ofruar shërbime (Neni 56 TFEU).

Për sa i përket garancave që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes, Gjykata e Drejtësisë mori një vendim ku i shpalli ato drejtpërsëdrejti të zbatueshme në rastin Van Duyn. Faktet e këtij rasti ishin si vijon: zonjës van Duyn, shtetase hollandeze, në maj të vitit 1973 iu refuzua leja për hyrje në Britani të Madhe për t'u punësuar si sekretareshë në Kishën e Sajentologjisë, një organizatë që konsiderohej si 'socialisht e dëmshme' nga Ministria e Punëve të Brendshme. Duke u thirrur në rregulloren e Unionit mbi lirinë e lëvizjes për punëtorët, zonja van Duyn ngriti padi para Gjykatës së Lartë, duke kërkuar vendimin se ajo kishte të drejtë të qëndrojë në Britani të Madhe për punësim dhe t'i jepej leje për hyrje në Britaninë e Madhe. Në përgjigjen e pyetjes së referuar nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Drejtësisë mbante mendimin se Neni 48 i Traktatit EEC (Neni 45 TFEU) ishte drejtpërsëdrejti i zbatueshëm dhe prandaj, mbi individët transferoi të drejta që janë të detyrueshme në gjykatat e Shteteve

Anëtare. Këshilli Shtetëror (*Conseil d'État*) i Belgjikës kërkoi nga Gjykata e Drejtësisë të japë një vendim mbi zbatueshmërinë direkte të dispozitave që garantojnë lirinë e krijimit. Këshilli Shtetëror duhej të vendoste lidhur me një veprim të paraqitur nga një avokat hollandez, J. Reyners, i cili kishte dëshirë të theksojë të drejtat e tij që rrjedhin nga Neni 52 i Traktatit EEC (Neni 49 TFEU). Z. Reyners ndjehej i obliguar të ngrejë padi pasi që i ishte refuzuar pranimi në profesionin ligjor në Belgjikë, për shkak të shtetësisë së tij të huaj, përkundër faktit se ai kishte kaluar testimin e nevojshëm belg. Në vendimin e vet më 21 korrik 1974, Gjykata konsideronte se trajtimi jo i barabartë i shtetasve dhe të huajve në lidhje me krijimtarinë, nuk do të vazhdonte më, ashtu si Neni 52 i Traktatit të EEC-së që ishte drejtpërsëdrejti i zbatueshëm nga fundi i periudhës së tranzicionit dhe kështu autorizonte qytetarët e Unionit të pranojnë dhe të realizojnë punësim profitabil në ndonjë Shtet tjetër Anëtar, në mënyrë të njëjtë si shtetasi i atij Shteti. Si rezultat i këtij vendimi, z. Reyners duhej të pranohej të ushtronte profesionin e tij ligjor në Belgjikë.

Gjykata e Drejtësisë kishte mundësinë në rastin *Van Binsbergen* të hartojë në mënyrë specifike zbatueshmërinë direkte të dispozitave që kanë të bëjnë me lirinë e ofrimit të shërbimeve. Këto procese gjyqësore përfshinin, midis të tjerash, çështjen nëse një dispozitë ligjore hollandeze që parasheh se vetëm personat rezidentë në Hollandë mund të veprojnë si përfaqësues juridikë para një gjykate të apelit, ishte kompatible me rregullat e Unionit lidhur me lirinë e ofrimit të shërbimeve. Gjykata konkludoi se nuk ishte kompatible, duke u bazuar në faktin se të gjitha kufizimet – të cilave u nënshtrohen qytetarët e Unionit për shkak të shtetësisë së tyre apo vendit të banimit, bëjnë shkeljen e nenit 59 të Traktatit të EEC-së (Neni 56 TFEU) dhe prandaj janë të pavlefshme.

Gjithashtu, me rëndësi të madhe në aspektin praktik është njohja e zbatueshmërisë direkte të dispozitave mbi lëvizjen e lirë të mallërave (Neni 41 TFEU), parimi i pagesës së barabartë për meshkujt dhe femrat (Neni 157 TFEU), ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit (Neni 25 TFEU) dhe liria e konkurrencës (Neni 101 TFEU). Sa i përket legjislacionit sekondar, çështja e zbatueshmërisë direkte shfaqet vetëm kur bëhet fjalë për direktivat dhe vendimet e adresuara për Shtetet Anëtare, duke marrë parasysh se rregullativat dhe vendimet e adresuara individëve nxjerrin zbatueshmërinë e vet direkte ga Traktatet e Unionit (Neni 288(2) dhe (4) TFEU). Nga viti 1970, Gjykata ka zgjeruar parimet e veta që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë direkte të dispozitave në direktiva dhe në vendime të adresuara Shteteve Anëtare.

Rëndësia praktike e efektit direkt të të drejtës së Unionit, në formën në të cilën është hartuar dhe është prezantuar për ekzekutim para Gjykatës së Drejtësisë, është vështirë të theksohet në masë të tepruar. Efekti direkt përmirëson pozitën e individit duke i shndërruar liritë e tregut të përbashkët në të drejta që mund të zbatohen në një gjykatë nacionale. Prandaj, efekti direkt i të drejtës së Unionit është një nga shtyllat e rendit ligjor të BE-së.

### **DOMINIMI I TË DREJTËS SË UNIONIT MBI TË DREJTËN NACIONALE**

Zbatueshmëria direkte e të drejtës së Unionit shpie drejt një pyetjeje të dytë, fundamentale: çfarë ndodh nëse një dispozitë e të drejtës së Unionit mundëson të drejtat dhe obligimet direkte për qytetarin e Unionit dhe kështu shkakton konflikte me sundimin e të drejtës nacionale?

Konflikti i këtellë midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale mund të zgjidhet vetëm nëse njëra i jep përparësi tjetrës. Legjislacioni i Unionit nuk përmban dispozitë të qartë lidhur me këtë çështje. Asnjë nga Traktatet e Unionit nuk përmban dispozitë që thotë se, për shembull, e drejta e Unionit dominon apo i nënshtrohet të drejtës nacionale. Megjithatë, mënyra e vetme për zgjidhjen e konflikteve midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale është që, asaj të parës t'i jepet përparësia e ligjit dhe t'i lejohe të zëvendësojë të gjitha dispozitat nacionale që devijojnë nga rregullorja e Unionit dhe të zëvendësojë ato në rendet ligjore nacionale. Në fund të fundit, nga rendi ligjor i BE-së do të mbetej shumë pak nëse do të krahasohej me ligjet nacionale. Rregullat e Unionit mund të lihen mënjanë nga çdo ligj nacional. Kështu nuk do të diskutohej më çështja e zbatimit të njëtrajtshëm dhe të barabartë të të drejtës së Unionit në Shtetet Anëtare. BE-ja nuk do të ketë mundësi të realizojë detyrat e besuara nga Shtetet Anëtare. Mundësia e Unionit për të funksionuar do të ishte rrezikuar, kurse struktura e një Evrope të unifikuar, për të cilën ka shumë shpresa, asnjëherë nuk do të arrihej.

Probleme të këtilla nuk ekzistojnë për sa i përket marrëdhënies midis të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale. Duke marrë parasysh se e drejta ndërkombëtare nuk bëhet pjesë e rendit ligjor të vetë shtetit derisa të absorbohet me ndihmën e një akti të përfshirjes ose zëvendësimit, çështja e parësisë vendoset vetëm në bazë të të drejtës nacionale. Varësisht nga urdhëri i presedencës që i atribuohet të drejtës ndërkombëtare nga sistemi nacional ligjor, ai mund të jetë superior mbi të drejtën kushtetuese, të klasifikohet midis të drejtës kushtetuese dhe të drejtës së rëndomtë statutare, ose të ketë thjesht

statusin e njëjtë si e drejta statutare. Marrëdhënia midis të drejtës së përfshirë ose të zëvendësuar ndërkombëtare dhe të drejtës nacionale përcaktohet me zbatimin e rregullores, sipas të cilës dispozitat e fundit ligjore mbizotërojnë ndaj atyre paraprake (*lex posterior derogat legi priori*). Këto rregulla nacionale mbi konfliktin e ligjeve nuk vlejnjë për marrëdhënien midis të drejtës së Unionit dhe ligjit nacional, pasi që e drejta e Unionit nuk është pjesë e asnjë rendi ligjor nacional. Çfarëdo konflikti midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale mund të zgjidhet në bazë të rendit ligjor të BE-së.

Duke marrë parasysh këto implikime, dhe përkundër kundërshtimit të disa Shteteve Anëtare, edhe një herë i takoi Gjykatës së Drejtësisë të themelohë parimin e mbizotërimit të të drejtës së Unionit, gjë vitale për ekzistimin e rendit ligjor të BE-së.

Në rastin *Costa v ENEL*, Gjykata kishte dy observime të rëndësishme lidhur me marrëdhënien midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale.

- Shtetet Anëtare kanë transferuar definitivisht të drejtat sovrane në Komunitetin e krijuar nga vet ato dhe masat pasuese unilaterale nuk do të ishin në përputhje me konceptin e ligjit të BE-së.
- Është parim i Traktatit që asnjë Shtet Anëtar të mos vejë në dyshim statusin e të drejtës së Unionit si një sistem i zbatueshëm në mënyrë të uniformuar dhe të përgjithshme në mbarë BE-në.

Nga kjo rrjedh se e drejta e Unionit, i cili u zbatua në pajtim me fuqitë e themeluara në Traktate, ka parësi mbi çfarëdo ligji konfliktuoz të Shteteve Anëtare. Jo vetëm që është më e fuqishëm se e drejta e mëparshme nacionale por gjithashtu ka efekt të kufizuar mbi ligjet e miratuara rrjedhimisht.

Së fundi, në vendimin e vet Gjykata nuk vuri në dyshim nacionalizimin e industrisë italiane për energji elektrike, mirëpo prerazi themeloi parësinë e të drejtës së Unionit mbi atë nacionale.

Pasojat ligjore të këtij rregulli të presedencës janë se në rast të konfliktit të ligjeve, e drejta nacionale e cila është në kundërshtim me të drejtën e Unionit, nuk vlen më dhe nuk mund të merret asnjë legjislacion i ri nacional nëse ajo nuk përputhet me të drejtën e Unionit.

Prej atëherë, Gjykata ka përkrahur në mënyrë të vazhdueshme këtë konkluzion dhe në fakt, e ka zhvilluar atë më tej. Ndërsa vendimi *Costa* merrej vetëm me çështjen e parësisë së ligjit të Unionit mbi atë të ligjeve të zakonshme nacionale, Gjykata konfirmoi parimin e parësisë gjithashtu në lidhje me

marrëdhëniet midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës kushtetuese nacionale. Pas hezitimit fillestar, gjykatat nacionale pranuan interpretimin e Gjykatës të Drejtësisë. Në Hollandë nuk mund të shfaqej asnjë vështirësi, pasi që parësia e të drejtës së Traktatit mbi të drejtën statutores nacionale, përcaktohet në mënyrë të shkoqitur në kushtetutë (Nenet 65 deri në 67). Në Shtetet tjera Anëtare, parimi i përparësisë të së drejtës të Unionit mbi të drejtën nacionale është njohur nga gjykatat nacionale. Mirëpo, gjykatat kushtetuese të Gjermanisë dhe Italisë fillimisht refuzuan të pranojnë parësinë e ligjit të Unionit mbi ligjin kushtetues nacional, sidomos kur bëhet fjalë për mbrojtjen e garantuar të të drejtave fundamentale. Ato i tërhoqën kundërshtimet e veta vetëm pasi që mbrojtja e të drejtave fundamentale në rendin ligjor të BE-së kishte arritur standardin që korrespondonte në thelb me atë të kushtetutave nacionale. Mirëpo, Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë vazhdon të trajtojë drujtjet për integrimin e mëtejshëm, ashtu siç e ka bërë të qartë në vendimet e veta të Traktatit të Mastrihtit dhe së fundi në Traktatin e Lisbonës.

### INTERPRETIMI I TË DREJTËS NACIONALE NË PAJTIM ME TË DREJTËN E UNIONIT

Për të parandaluar konfliktin midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale, i cili mund të shfaqet si rezultat i zbatimit të rregullit të përparësisë, të gjitha organet Shtetërore që implementojnë ose ushtrojnë ligjin mund të interpretojnë ligjin nacional, në përputhje me ligjin e Unionit.

Duhej një kohë relativisht e gjatë, në mënyrë që koncepti i interpretimit në pajtim me të drejtën e BE-së të njihet nga Gjykata e Drejtësisë dhe të inkorporohet në rendin ligjor të Unionit. Pasi që Gjykata e Drejtësisë fillimisht pa të arsyeshme të garantojë se ligjet nacionale harmonizohen me një direktivë, vetëm kur kjo kërkohet nga gjykatat nacionale, ajo themeloi një obligim për të interpretuar ligjin nacional në pajtim me direktivat – për herë të parë në vitin 1984 në rastin *Von Colson and Kamann*. Vendimi për këtë rast ishte që vlera e kompenzimit të jepet për diskriminimin ndaj femrave në lidhje me qasjen në punësim. Kurse dispozitat relevante ligjore të Gjermanisë kanë paraparë vetëm kompensimin ‘*Vertrauensschaden*’ (mbështetja e pabazë në parashikimin legjitim), Direktiva 76/207/EEC deklaroi se ligji nacional duhet të planifikojë dënime efektive (PENALTIES) për të garantuar sigurimin e mundësive të barabarta lidhur me qasjen në punësim. Pasi që gjobat relevante nuk ishin të përcaktuara në detaje, direktiva nuk mund të konsiderohej drejtpërdrejtë e zbatueshme për këtë pikë, dhe ekzistonte rreziku që Gjykata e Drejtësisë të duhej të marrë vendimin. Edhe pse e drejta nacionale dështoi të harmonizohet

me të drejtën e Unionit, nuk kishte arsye që Gjykatat nacionale të mos marrin parasysh të drejtën nacionale. Gjykata e Drejtësisë mori vendimin që gjykatat nacionale të obligohen të interpretojnë dhe të zbatojnë legjislacionin nacional në çështjet civile, në mënyrë që të ekzistojnë gjoba efektive për diskriminimin në bazë të gjinisë. Kompenzimi simbolik nuk do të plotësonte kërkesat e një zbatimi efektiv të direktivës.

Bazën ligjore të interpretimit të të drejtës nacionale në pajtim me të drejtën e Unionit, Gjykata e Drejtësisë ia ngarkon parimit të përgjithshëm të bashkëpunimit të sinqertë (Neni 4(3) TEU). Sipas këtij neni, Shtetet Anëtare duhet t'i marrin të gjitha masat e përshtatshme, qofshin ato të përgjithshme apo të veçanta, për të siguruar plotësimin e obligimeve që rrjedhin nga Traktati i BE-së ose nga aktivitetet e ndërmarra nga institucionet e Unionit. Autoritetet nacionale janë të obliguara të harmonizojnë interpretimin dhe zbatimin e të drejtës nacionale, e cila vjen pas të drejtës së Unionit, me formulimin dhe qëllimin e të drejtës të Unionit (obligimi i bashkëpunimit). Për gjykatat nacionale, kjo reflektohet në rolin e tyre si gjykata evropiane, në kuptimin se ato garantojnë zbatimin dhe mbikqyrjen e drejtë të ligjit të Komunitetit.

Një formë e veçantë e interpretimit të të drejtës nacionale në pajtim me të drejtën e Unionit është interpretimi në përputhje me direktivat, sipas të cilave Shtetet Anëtare janë të obliguara të implementojnë direktivat. Ekspertët ligjorë dhe gjykatat duhet t'u ndihmojnë Shtetet e veta Anëtare të plotësojnë këtë obligim në tërësi, duke zbatuar parimin e interpretimit në pajtim me direktivat. Interpretimi i ligjit nacional, në pajtim me direktivat garanton se ekziston një përputhje me direktivat, në nivelin në të cilin zbatohet ligji, dhe kështu garanton se ligji implementues nacional interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha Shtetet Anëtare. Kjo nuk lejon diferencimin në nivel nacional të çështjeve që sapo janë harmonizuar në nivel të Unionit me anë të direktivës.

Kufiri i interpretimit të të drejtës nacionale në pajtim me të drejtën e Komunitetit qëndron në formulimin e qartë të të drejtës nacionale, e cila nuk është e hapur për interpretim. Edhespe ekziston obligimi sipas të drejtës së Komunitetit për interpretimin e të drejtës nacionale në pajtim me të drejtën e Unionit, e drejta nacionale mund të mos interpretohet 'contra legem' (kundër ligjit). Kjo vlen edhe në raste ku legjislatori nacional refuzon në mënyrë eksplicite të kalojë një direktivë në ligj nacional. Konflikti midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale mund të zgjidhet vetëm me anë të proceseve gjyqësore kundër Shtetit të caktuar Anëtar, për pamundësi të plotësimit të obligimeve të parapara në Traktat (Nenet 258 dhe 259 TFEU).



27 shtator 1964, Bruksel.

Një automjet me tabela evropiane regjistrimi, e parkuar para  
godinës 'Joyeuse entrée', selia e ardhshme e Komisionit Evropian,  
e cila ishte në ndërtim e sipër.

# Konkluzat

Çfarë pasqyre e përgjithshme shfaqet nga rendi ligjor i BE-së?

Rendi ligjor i BE-së është baza e vërtetë e Unionit, i cili i jep atij një sistem të ligjit zakonor sipas të cilit duhet të funksionojë. Objektivat themelore të Unionit mund të arrihen vetëm me krijimin e ligjit të ri dhe përkrahjen e tij. Rendi ligjor i BE-së tani më ka shënuar arritje të mëdha në këtë kontekst. Falë këtij rendi të ri ligjor, kufijtë e hapur, tregtia substanciale me mallëra dhe shërbime, lëvizja e punëtorëve dhe numri i madh i lidhjeve jashtëkufitare midis kompanive kanë bërë tregun e përbashkët pjesë të jetës së përditshme për afro 500 milionë njerëz. Një karakteristikë tjetër me rëndësi historike lidhur me rendin ligjor të Unionit është roli i tij paqeruajtës. Me synimin e vet për ruajtjen e paqes dhe lirisë, zëvendëson forcën si mjet për zgjidhjen e konflikteve me sundimin e ligjit që detyron si individët ashtu edhe Shtetet Anëtare në një Komunitet të vetëm. Si rezultat i kësaj, rendi ligjor i Unionit është instrument i rëndësishëm për ruajtjen dhe krijimin e paqes.

Ligji i komunitetit të BE-së dhe rendi i tij ligjor mund të mbijetojnë vetëm nëse përputhshmëria dhe mbrojtja e këtij rendi ligjor garantohehen me dy gur-themele: zbatueshmëria direkte e të drejtës së Unionit dhe përparësia e të drejtës së Unionit mbi të drejtën nacionale. Këto dy parime, ekzistencën dhe mirëmbajtjen e të cilave me vendosmëri e përkrah Gjykata e Drejtësisë, garantojnë zbatimin e uniformuar dhe prioritar të të drejtës së Unionit në të gjitha Shtetet Anëtare.

Me të gjitha mangësitë e veta, rendi ligjor i BE-së shënon kontribut shumë të vlefshëm drejt zgjidhjes së problemeve politike, ekonomike dhe sociale të Shteteve Anëtare të Unionit.





# Shtojcë

## JURISPRUDENCA

### Natyra dhe përparësia e të drejtës së Unionit

Case 26/62 *Van Gend & Loos* [1963]  
ECR 1 (nature of Union law;  
rights and obligations of individuals).

Case 6/64 *Costa v ENEL* [1964]  
ECR 1251 (nature of Union law;  
direct applicability,  
primacy of Union law).

Case 14/83 *Von Colson and Kamann*  
[1984] ECR 1891 (interpretation of  
national law in line with Union law).

Case C-213/89 *Factortame* [1990]  
ECR I-2433 (direct applicability and  
primacy of Union law).

Joined Cases C-6/90 and C-9/90  
*Francovich and others* [1991] ECR  
I-5357 (effect of Union law; liability of  
Member States for failure to discharge  
Union obligations: non-transposal of a  
directive).

Joined Cases C-46/93 and C-48/93  
*Brasserie du pêcheur and Factortame*  
[1996] ECR I-1029 (effect of Union law;  
general liability of Member States for  
failure to discharge Union obligations).

Joined Cases C-10/97 to C-22/97  
*IN.CO.GE '90* [1998] ECR I-6307  
(primacy of Union law).

Case C-416/00 *Morellato* [2003]  
ECR I-9343 (primacy of Union law).

Joined Cases C-397/01 to C-403/01  
*Pfeiffer and others* [2004] ECR I-8835  
(interpretation of national law in line  
with Union law).

### Fuqitë e BE-së

Case 8/55 *Fédération charbonnière de  
Belgique* [1954–1956] ECR 292 (implied  
powers; official fixing of prices).

Case 22/70 *AETR* [1971] ECR 263 (legal  
personality and treaty-making powers  
of the EU).

Case 6/76 *Kramer* [1976] ECR 1279  
(external relations; international  
commitments; authority of the EU).

Opinion 1/91 [1993] ECR I-6079 (EEA  
Agreement I; distribution of powers).

Opinion 2/91 [1993] ECR I-1061  
(distribution of powers between the  
EU and the Member States).

Opinion 1/94 [1994] ECR I-5267 (WTO  
Agreement; distribution of powers).

Opinion 2/94 [1996] ECR I-1759  
(accession by the EC to the ECHR;  
absence of powers).

### **Efektet e akteve ligjore**

Case 2/74 *Reyners* [1974] ECR 631  
(direct applicability; freedom of  
establishment).

Case 33/74 *van Binsbergen* [1974]  
ECR 1299 (direct applicability; provision  
of services).

Case 41/74 *Van Duyn* [1974] ECR 1337  
(direct applicability; freedom of  
movement).

Case 11/77 *Patrick* [1977]  
ECR 1199 (direct applicability; right of  
establishment).

Case 70/83 *Kloppenborg* [1984]  
ECR 1075 (directives; direct  
applicability).

Case 152/84 *Marshall* [1986] ECR 723  
(directives; direct applicability).

Case 103/88 *Costanzo* [1989] ECR  
1861 (directives; direct applicability;  
conditions; consequences).

Case 322/88 *Grimaldi* [1989] ECR 4407  
(recommendations; direct applicability  
or its absence; observance by national  
courts).

Case C-188/89 *Forster* [1990] ECR I-3343  
(directives; horizontal direct effect).

Case C-292/89 *Antonissen* [1991]  
ECR I-773 (statements in Council  
minutes; status for interpretation  
purposes).

Case C-91/92 *Faccini Dori* [1994]  
ECR I-3325 (directives; horizontal direct  
effect).

Case C-431/92 *Commission v Germany*  
(Grosskotzenburg) [1995] ECR I-2189  
(directive; effect of objective law).

Case C-465/93 *Atlanta*  
*Fruchthandelsgesellschaft* [1995]  
ECR I-3761 (examination of validity of a  
regulation; preliminary ruling; ordering  
of interim measures; conditions).

Case C-469/93 *Chiquita Italia* [1995]  
ECR I-4533 (direct effect of provisions  
of the GATT and the Lomé  
Convention).

Case C-368/96 *Generics* [1998]  
ECR I-7967 (statements in minutes;  
status for interpretation purposes).

Case C-144/01 *Mangold* [2005]  
ECR I-9981 (directive; horizontal direct  
effect).

### **Të drejtat fundamentale**

Case 29/69 *Stauder* [1969] ECR 419  
(fundamental rights; general principles  
of law).

Case 11/70 *Internationale*  
*Handelsgesellschaft* [1970] ECR 1125  
(fundamental rights; general principles  
of law).

Cases 146/73 and 166/73 *Rheinmühlen*  
*I, II* [1974] ECR 33 and 139 (extent to  
which national courts are bound by  
rulings of higher courts).

Case 4/73 *Nold* [1974] ECR 491  
(fundamental rights; general principles of law; common constitutional traditions).

Case 175/73 *Amalgamated European Public Service Union* [1974] ECR 917  
(freedom to form associations).

Case 130/75 *Prais* [1976] ECR 1589  
(freedom of religion and belief).

Case 149/77 *Defrenne* [1978] ECR 1381  
(fundamental rights; general principles of law).

Case 44/79 *Hauer* [1979] ECR 3727  
(fundamental rights; right of property).

Case 85/79 *Hoffmann-La Roche* [1979] ECR 461 (fundamental rights; principle of the right to be heard).

Case 293/83 *Gravier* [1985] ECR 593  
(equal treatment; students' fees).

Case 234/85 *Keller* [1986] ECR 2897  
(freedom to pursue a trade or profession).

Joined Cases 46/87 and 227/88 *Hoechst* [1989] ECR 2919 (fundamental rights; principle of the right to be heard; administrative procedure; inviolability of the home; reference to the ECHR).

Case 265/87 *Schröder* [1989] ECR 2263  
(right of ownership; freedom to pursue a trade or profession; restrictions).

Case 5/88 *Wachauf* [1989] ECR 2633  
(restrictions on fundamental rights).

Case C-219/91 *Ter Voort* [1992] ECR I-5485 (freedom of expression).

Case C-97/91 *Borelli* [1992] ECR I-6313  
(fundamental rights; right to take action in the courts).

Case C-357/89 *Raulin* [1992] ECR I-1027 (equal treatment; prohibition of discrimination on grounds of nationality).

Case C-132/91 *Katsikas* [1992] ECR I-6577 (fundamental rights; freedom to pursue a trade or profession).

Case C-2/92 *Bostock* [1994] ECR I-955 (fundamental rights; right of ownership; freedom to pursue a trade or profession; observance when implementing EU law).

Case C-280/93 *Germany v Council* [1994] ECR I-5065 (right of ownership; freedom to pursue a trade or profession; restrictions in the public interest).

Case C-415/93 *Bosman and others* [1995] ECR I-4921 (fundamental rights; freedom to pursue a trade or profession).

Case C-55/94 *Gebhard* [1995] ECR I-4165 (fundamental rights; right of establishment; freedom to pursue a trade or profession).

Opinion 2/94 [1996] ECR I-1759  
(fundamental rights; accession by the EU to the ECHR).

Case C-377/98 *Netherlands v Parliament and Council* [2001] ECR I-7079 (human dignity; right to physical integrity).

Case C-274/99 P, *Connolly* [2001] ECR I-1611 (freedom of opinion).

Case C-60/00 *Carpenter* [2002] ECR I-6279 (protection of the family).

Case C-112/00 *Schmidberger* [2003] ECR I-5659 (bounds of Community fundamental rights; freedom of assembly and freedom of opinion).

Case C-276/01 *Steffensen* [2003] ECR I-3735 (right to effective legal protection).

Case C-25/02 *Rinke* [2003] ECR I-8349 (general principle of equality).

Case C-36/02 *Omega* [2004] ECR I-9609 (bounds of fundamental rights).

## PARIMET E PËRGJITHSHME TË LIGJIT (SELEKTIM)

### Siguria ligjore

Joined Cases 18/65 and 35/65 *Gutmann* [1967] ECR 61.

Case 98/78 *Racke* [1979] ECR 69.

Case 96/78 *Decker* [1979] ECR 101.

Case 61/79 *Denkavit* [1980] ECR 1205.

Cases 66/79, 127/79 and 128/79 *Salumi* [1980] ECR 1237.

Case 70/83 *Kloppenburg* [1984] ECR 1075.

Joined Cases T-551/93 and T-231/94 to T-234/94 *Industrias Pesqueras Campos and Others* [1996] ECR II-247.

Joined Cases T-116/01 and T-118/01 *P & O European Ferries (Vizcaya) v Commission* [2003] ECR II-2957.

### Proporcionaliteti

Case 116/76 *Granaria* [1977] ECR 1247.

Case 265/87 *Schröder* [1989] ECR 2237.

Case C-161/96 *Südzucker* [1998] ECR I-281.

Case C-171/03 *Toeters* [2004] ECR I-10945.

### Mbrojtja e parashikimeve legjitime

Case 74/74 *CNTA* [1975] ECR 533.

Case 120/86 *Mulder* [1988] ECR 2321.

Case 170/86 *Von Deetzen* [1988] ECR 2355.

Case C-368/89 *Crispoltoni I* [1991] ECR I-3695.

Case T-119/95 *Hauer* [1998] ECR II-2713.

### Parimi i subvencionimit

Case T-29/92 *SPO* [1995] ECR II-289.

Case C-84/94 *United Kingdom v Council* [1996] ECR I-5755.

Joined Cases C-36/97 and C-37/97  
*Kellinhusen and Ketelsen* [1998] ECR  
I-6337.

Case C-491/01 *British American Tobacco  
(Investments) and Imperial Tobacco*  
[2002] ECR I-11453.

## Shtetësia e Unionit

Case C-85/96 *Martínez Sala* [1998]  
ECR I-2691.

Case C-184/99 *Grzelczyk* [2001]  
ECR I-6193.

Case C-224/98 *d'Hoop* [2002] ECR I-6191.

Case C-413/99 *Baumbast* [2002]  
ECR I-7091.

Case C-403/03 *Schempp* [2005]  
ECR I-6421.



Komisioni Evropian  
**ABC-ja e të Drejtës së Bashkimit Evropian**  
nga Profesor Klaus-Diter Borçard

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2010

2010 — 133 fq. — 153 × 235 mm

ISBN 978-92-9238-041-0

doi:10.2871/36508



## Kontakti me BE-në



### ONLAJN

Informata në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian mund të gjeni në ueb faqen Europa: **europa.eu**



### PERSONALISHT

Në mbarë Evropën ka qindra qendra lokale informative të BE-së.

Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni në ueb faqen Europe Direct: **europedirect.europa.eu**



### PËRMES TELEFONIT OSE POSTËS

Europe Direct është shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja lidhur me Bashkimin Evropian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni në telefonin pa pagesë **00 800 6 7 8 9 10 11**, telefonin me pagesë nëse merrni nga vendet jashtë BE-së **+32 2 299 96 96** ose me anë të postës elektronike të ueb faqes Europe Direct: **europedirect.europa.eu**



### LEXONI MBI EVROPËN

Për të lëxuar botimet mbi BE-në, vetëm duhet të klikoni një herë në ueb faqen e librarisë të BE-së:

**bookshop.europa.eu**

**Delegacioni i Bashkimit Evropian**

M.H. Jasmin 52v  
1000 Shkup  
Tel. 02/3248 500  
Faks. 02/3248 501  
Internet: www.delmkd.ec.europa.eu  
E-mail: Delegation-FYRMacedonia@ec.europa.eu

**Qendra Informative e Bashkimit Evropian**

M.H. Jasmin 52v  
1000 Shkup  
Tel/faks. 02/3296-363  
Internet: www.euic.mk  
E-mail: euinfo@euic.mk

**Qendra Informative e BE-së, Manastir**

Bul. "1 Maji" 61  
7000 Manastir  
Tel. 047 298 336  
E-mail: bitola@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Veles**

Rr. "Panko Brashnar" 1  
1400 Veles  
Tel. 043 232 406  
E-mail: veles@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Gostivar**

Bul. "Braça Ginovski" 61  
1230 Gostivar  
Tel. 042 218 167  
E-mail: gostivar@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Kavadarci**

Rr. "Marshal Tito" bb  
1430 Kavadarci  
Tel. 043 400 217  
E-mail: kavadarci@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Koçani**

Rr. "Rade Kratovçe" 1  
2300 Koçani  
Tel. 033 274 001  
E-mail: kocani@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Kumanovë**

Sheshi "Jugosllavia e re" bb  
1300 Kumanovë  
Tel. 031 438 663  
E-mail: kumanovo@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Tetovë**

Rr. "Dervish Cara" bb  
1200 Tetovë  
Tel. 044 343 646  
E-mail: tetovo@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Gjevgjeli**

Rr. "Dimitar Vllahov" 4  
1480 Gjevgjeli  
Tel. 034 213 843  
E-mail: gevgelija@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Ohër**

Rr. "Dimitar Vllahov" 57  
6000 Ohër  
Tel. 046 230 175  
E-mail: ohrid@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Dibër**

Rr. "8 Shtatori" bb  
1250 Dibër  
Tel. 046 831 196  
E-mail: debar@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Strumicë**

Rr. "Bllagoj Muçeto" 26  
2400 Strumicë  
Tel. 034 349 040  
E-mail: strumica@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së, Kriva Pallankë**

Rr. "Shën Joakim Osogovski" 175  
1330 Kriva Pallankë  
Tel. 031 375 035  
E-mail: krivapalanka@euinfopoint.mk

**Qendra Informative e BE-së në Bibliotekën****Kombëtare dhe Universitare****"Shën Kliment Ohridski"**

Bul. "Goce Delçev" 6  
1000 Shkup  
Tel. 02 3115 177  
E-mail: nul@euinfopoint.mk

**EUJ – Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi";****Fakulteti Ekonomik, Shkup**

Bul. "Krste Misirkov" bb  
1000 Shkup  
Tel. 02 3286 835  
E-mail: eui-sk@eccf.ukim.edu.mk

**EUJ – Universiteti "Shën Kliment Ohridski";****Fakulteti për Menaxhim dhe Administrim të Sistemeve Informative, Manastir**

Rr. "Partizanska" bb  
7000 Manastir  
Tel. 047 259 923  
E-mail: eui-bt@famis.edu.mk

**EUJ – Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë**

Rr. "Ilindenska" bb  
1200 Tetovë  
Tel. 044 356 316  
E-mail: eui-te@seeu.edu.mk

Në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian ka përfaqësi të Komisionit dhe zyra e përfaqësi të Parlamentit Evropian. Komisioni Evropian ka gjithashtu edhe delegacione në vende të tjera të botës.



**Zyra e Botimeve të**

**Bashkimit Evropian** është shtëpi botuese e institucioneve, agjencive dhe organeve të tjera të Bashkimit Evropian. Kjo zyrë mundëson qasje të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë në të drejtën e Evropës dhe publikimet e Bashkimit Evropian.

**ABC-ja e të drejtës së Bashkimit Evropian**

*nga Profesor Klaus-Diter Borçard*

Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009, pasi që u ratifikua nga të gjitha 27 Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, dhe futi ndryshime në të drejtën dhe institucionet e Evropës.

*ABC-ja e të Drejtës së Bashkimit Evropian* nga Klaus-Diter Borçard egzaminon rrënjët e projektit të Evropës dhe zhvillimin e saj si rend ligjor, dhe është një punim referencë lidhur me këtë temë.

Autori ofron njohuri për mënyrën se si është ndërtuar Bashkimi Evropian, parimet e tij të përgjithshme dhe rendi ligjor që e themelon atë, duke krahasuar këtë me ligjet nacionale të Shteteve Anëtare.

Ky libër është paraparë për njerëz që nuk kanë njohuri ligjore të specializuar, të cilët kanë dëshirë të kuptojnë implikimet e të drejtës së Evropës në jetën e tyre të përditshme.

**Shërbimet onlajn**

- [bookshop.europa.eu](http://bookshop.europa.eu): EU publications
- [cordis.europa.eu](http://cordis.europa.eu): Research and development
- [eur-lex.europa.eu](http://eur-lex.europa.eu): EU law
- [ted.europa.eu](http://ted.europa.eu): Public procurement

2, rue Mercier  
2985 Luxembourg  
LUXEMBOURG



Publications Office

